



1999

2000

2001

2002

2003

2004

2005

2006

2007

2008

2009

2010

2011

RAPORT VJETOR

BOTUES: Banking and Payments Authority of Kosovo
Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës
Bankarski i Platni Autoritet Kosova
33 Garibaldi, Prishtinë

Telefoni: ++381 38 222 055














































Faksi: ++381 38 243 763


WEB <http://www.bpk-kos.org>

BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

RAPORT VJETOR 2004

PËRMBAJTJA

 Letër nga Shefi ekzekutiv dhe Drejtori i Përgjithshëm i BPK-s.....	6
 Bordi Drejtues i BPK-s.....	9
 Komiteti ekzekutiv i BPK-së.....	9
 Përmbledhje ekzekutive.....	10
 1. Zhvillimet Makroekonomike.....	14
 1.1 Vështrim mbi Ekonominë Ndërkombëtare.....	16
 1.1.1. Ekonomia Botërore.....	16
 1.1.2. Bashkimi Evropian.....	18
 1.1.3. Ballkani Perëndimor.....	20
 1.2. Karakteristika të përgjithshme të Ekonomisë së Kosovës.....	23
 1.2.1. Sektori Real.....	24
 1.2.1.1. PBB.....	24
 1.2.1.2. Indeksi i Cmimit të Konsumit.....	26
 1.2.1.3. Papunësia e Regjistruar.....	27
 1.2.2. Sektori Fiskal.....	28
 1.2.3. Sektori Financiar.....	30
 1.2.3.1. Zhvillimet në Sektorin Bankar.....	34
 1.2.3.2. Struktura e Mjeteve të Sektorit Bankar në Kosovë.....	36
 1.2.3.3. Struktura e Detyrimeve të Sektorit Bankar në Kosovë.....	39
 1.2.3.4. Struktura e Kapitalit të Sektorit Bankar në Kosovë.....	41
 1.2.3.5. Performanca e Sektorit Bankar.....	42
 1.2.4. Sektori i Jashtëm.....	46
 2. Funkcionet e BPK-së.....	52
 2.1. BPK – Autoriteti Financiar i Kosovës.....	56
 2.1.1. Aktiviteti i Rregulloreve të Sektorit Financiar të BPK-s.....	57
 2.1.2. Aktiviteti Mbikqyrës dhe Përforsues.....	59
 2.1.2.1. Liçensimi dhe Struktura.....	59
 2.1.2.2. Kontrolltet Financiare.....	61
 2.1.2.3. Autoritetet Formale të Mbikqyrësve (Masat Detyruese).....	63
 2.1.3. Bashkëpunimi Ndërkombëtar.....	64
 2.1.4. Zhvillimet Kryesore të Sektorit Financiar.....	64
 2.2. Operacionet Bankare.....	68
 2.2.1. Furnizimi me Kartmonedha dhe Monedha Euro.....	68
 2.2.2. Sistemi i Pagesave.....	71
 2.2.3. Bankier për IPVQ-të dhe Agjensitë në fjalë.....	74
 2.2.4. Menaxhimi i Mjeteve.....	75
 2.2.5. Këshilltar për Vendim-Marrësit Publik.....	77
 2.2.6. Aktivitete të Tjera të Interesit të Përgjithshëm.....	78
 3. Aktivitetet e Brendshme.....	82
 3.1. Konferenca Ndërkombëtare e Pesë-Vjetorit të BPK-s.....	84
 3.2. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.....	84
 3.3. Qeverisja e BPK-s dhe Kontrolli i Brendshëm.....	86
 4. Pasqyrat Financiare te Autoritetit Bankar dhe te Pagesave te Kosoves.....	92
 5. Shtojca.....	118
 5.1. Tabelat Statistikore.....	120



Prill, 2005

I Nderuari Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

Gjatë pesë viteve të fundit, Kosova ka arritur përparim të dukshëm në rrugën e saj drejt një ekonomie tregu. Këto hapa të mëdhenj për të ecur përpara janë mbështetur fuqishëm nga komuniteti ndërkombëtar, i cili ka siguruar paqe, stabilitet, si edhe një asistencë teknike të vazhdueshme dhe frytdhënëse. Pa këtë mbështetje, dhe përfshirjen e faktorëve nga vetë Kosova, ndikimet përçarëse të konflikteve nuk do të mund të kapërceheshin.

Një kornizë rregullatore, përcaktuar sipas standarteve më të mira ndërkombëtare, është vendosur nga UNMIK-u dhe BPK-ja, me qëllim përkrahjen e zhvillimit të një mjedisi financiar të frytshëm, të qëndrueshëm dhe të shëndoshë. Baza të tilla rregullatore i japin BPK-s, si një autoritet mbikqyrës, mjetet e duhura për të inkurajuar zhvillimin e një sektori financiar modern, dhe për të forcuar masat e kërkuara për të siguruar stabilitetin e tij. Në sajë të këtij mjedisi të parashikuar me statut, dhe mbi të gjitha në sajë të të gjitha nismave nga të gjithë pjesëmarrësit, nga Kosova, nga vendet fqinje dhe përgjithësisht nga vendet ndërkombëtare, sektori financiar ka zhvilluar shumë kapacitete. Ato u japin konsumatorëve shërbime financiare bazë, me një nivel sigurie i cili mund të vlerësohet si i lartë, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të vendit në një kontekst të pasluftës.

Megjithatë, mbetet ende një rrugë e gjatë për të arritur një sistem financiar modern dhe të qëndrueshëm, i cili do të sigurojë të gjitha shërbimet e nevojshme për zhvillimin e një ekonomie tregu të frytshme.

Cilat janë pengesat? Ato nuk janë as kufizimet rregullatore, as ngurrimet e ndërmjetësuesve për të siguruar fondet dhe shërbimet e nevojshme. Aktualisht, pasiguria e statusit të ardhshëm të Kosovës nuk i inkurajon investimet e huaja dhe integrimin e vendit në rrjetet financiare ndërkombëtare. Në këtë aspekt, duke mos qenë anëtar i skemës së sigurimeve të Kartës së Gjelbërt, ose të sistemeve të pagesave ndërkombëtare, në mungesë të një kodi të pranuar Swift, rrisin marxhinalizimin e Kosovës. Veç kësaj, integrimi ekonomik i Kosovës në një "tërësi" rajonale është ende në gjendje të pavendosur. Për më tepër, dhe më konkretisht, dobësitë në disa prej nevojave bazë të një sistemi financiar, si p.sh. pasqyra të besueshme të llogarive, status të sigurt të pronësive, aftësi për të mbuluar borxhet përmes masave efektive komerciale dhe juridike, rrisin koston e pasigurisë për siguresit e shërbimeve financiare. Pasiguria mund të sjellë një rritje të koston, ose një kufizim të dhënies të shërbimeve. Së fundmi, pesha e prirjeve të mëparshme në vendim-marrje në disa pjesë të shoqërisë, dhe rritja modeste e konsumit familjar iu shkakton

kufizime nismave sipërmarrëse dhe, për pasojë, nuk e inkurajon sektorin financiar në ndërmarrjen e rrezikut.

Konsolidimi i stabilitetit të sektorit financiar ka qenë një prej synimeve kryesore të BPK-s. Ky synim është zbatuar, nëse marrim parasysh standartet kryesore të arsyeshme. Kjo nuk është për të thënë që këto arritje nuk duhet të përforcohen dhe të mbështeten. Kjo do të thotë që zvogëlimi i përdorimit të parave të gatshme në transaksione, rritja e depozitave dhe kursimeve dhe zgjerimi i fondeve vetjake të ndërmjetësuesve financiarë duhet të inkurajohen.

Nëse përmendim përdorimin e parave të gatshme, BPK-ja mbështet në mënyrë aktive zvogëlimin e tij, për shembull duke nxitur përdorimin e "accept giro". Disa masa shtesë, si p.sh. përdorimi në rritje i transfertave bankare në aktivitetet komerciale, mund të zhvillohen nga autoritetet kompetente. Ndër faktorët e tjerë, masat e rregullave të arsyeshme inkurajojnë gjithashtu mbledhjen e depozitave dhe kursimeve; duke mos përmendur këtu kërkesat e kapitalit për bankat dhe kompanitë e sigurimeve të cilat janë rritur ndjeshëm.

Duke qenë se stabiliteti i mjedisit ekonomik është ende një proces në vazhdim, çdo sugjerim apo projekt i cili mund të ndikojë në sektorin financiar duhet të analizohet duke patur parasysh ndikimet e tij – pozitive ose negative – në sjelljen e të dyve, investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe më përgjithësisht, aftësia e tij për të forcuar besimin në sistemin financiar të Kosovës. Rritja e besimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin financiar është themelor. Në këtë aspekt, BPK-ja është duke i mbështetur të gjitha përpjekjet të cilat mund të ndihmojnë në dhënien e shërbimeve financiare. Bashkimi i interesave të kursimtarëve dhe investitorëve nga njëra anë, dhe interesave të një vendi nga ana tjetër, në pamje të parë nuk duket gjithmonë një detyrë e lehtë. Përvojat e huaja tregojnë se mënyra më e mirë për të tërhequr kursimtarët dhe investitorët dhe, në të njëjtën kohë, për të rritur zhvillimin ekonomik, është nxitja e investitorëve të brendshëm dhe të huaj drejt një ekonomie tërheqëse. Kjo është mënyra e vetme për t'i siguruar Kosovës punësim dhe mirëqënie. Investimet e detyruara sjellin rendimente të pakta, shpërdorim fondesh dhe humbje të besimit në ekonomi.

Pavarësia dhe profesionalizmi i BPK-s janë gjithashtu faktorë kyç në rritjen e besimit të depozituesve dhe investitorëve, si edhe stabiliteti dhe siguria e gjithë sektorit financiar. Nuk ka dyshim që një zhvillim në statusin e BPK-s, së bashku me lëvizjen drejt një statusi të ri për vendin, do të përforcojë dhe rrisë këtë mjet kryesor të sistemit financiar të Kosovës.

Duke vepruar ngushtë me UNMIK-un, dhe duke rritur marrëdhëniet e saj të punës me IPVQ-të, BPK-ja ka bërë përpjekjet e saj më të mira për të zhvilluar marrëdhëniet me mbikqyrësit e tjerë financiarë në zonën e Ballkanit, të cilat çojnë në ndërtimin e urave dhe zvogëlimin e izolimit të Kosovës. Janë nënshkruar disa Memorandume Mirëkuptimi, të cilat lejojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet mbikqyrësve për qëllime të arsyeshme. Përveç kësaj, menaxherët e BPK-s

kanë marrë pjesë në takime pune me të gjitha autoritetet mbikqyrëse në vendet fqinje. Për më tepër, Konferenca Ndërkombëtare, organizuar në Nëntorin e kaluar për pesë vjetorin e BPK-s, iu dhanë mbikqyrësve financiarë mundësinë unike për t'u takuar në Prishtinë. Më së fundmi, në fillim të vitit 2005 u nënshkrua një marrëveshje me Bankën Qëndrore Evropiane me qëllim formalizimin e përdorimit të kartmonedhave Euro në territorin e Kosovës.

BPK-ja ka bërë hapa të mëdhenj në përshtatjen e strukturave të saj dhe rritjen e pjesëmarrjes së Drejtuesve vendorë. Janë vendosur struktura moderne të menaxhimit, kryesisht përmes komiteteve dhe politikave të frytshme. Skema e re organizative është në veprim. Ajo iu jep Kosovarëve tri pozita të larta: Zyrtari Kryesor i Operacioneve, Zyrtari Kryesor i Mbikqyrjes dhe Inspektori Gjeneral. Prania ndërkombëtare është shumë e më shumë e përkushtuar ndaj mbështetjes së procesit të ndërtimit të kapaciteteve. Për rrjedhojë, është zhvilluar një politikë e përgjithshme trajnimi, në sajë të mbështetjes së dhënë nga organizatat ndërkombëtare, siç janë FMN-ja, Banka Botërore, BE dhe USAID-i.

Ajo çfarë kemi arritur nga pikëpamja e zhvillimit nuk ishte një synim në vetvete. Ishte thjesht një hap ndërmjetës. BPK-ja ka nevojë të ecë më tej në zhvillimin e një sektori financiar të fortë dhe të frytshëm, me mbështetjen e plotë e të djave faktorëve financiarë dhe Autoriteteve përkatëse. Do të bëhen përpjekjet më të mira për një njohje më të mirë ndërkombëtare të BPK-s, dhe integritet të plotë të faktorëve financiarë të Kosovës brenda rajonit.

Kam kënaqësinë t'iu paraqes Raportin Vjetor të BPK-s për vitin 2004.

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm

Më 31 Dhjetor 2004 Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi Drejtues i BPK-s

- Z. Ajri Begu, Kryetar i Bordit Drejtues
- Z. Donat Branger, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-s¹
- Z. David Weatherman, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikqyrjen e Sektorit Financiar
- Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave
- Z. Nikolaus Graf Lambsdorff, ZPSSP, BE – Shtylla IV²
- Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
- Z. Petraq Milo, Ushtrues i Detyrës së Kryetarit të Zyrës për Çështje Fiskale – BE shtylla IV, UNMIK³

Komiteti i Auditimit të Bordit Drejtues të BPK-s:

- Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
- Z. Petraq Milo, Ushtrues i Detyrës së Kryetarit të Zyrës për Çështje Fiskale – BE shtylla IV, UNMIK³

Komiteti Ekzekutiv i BPK-s

- Z. Donat Branger, Drejtori i Përgjithshëm i BPK-s¹
- Z. David Weatherman, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikqyrjen e Sektorit Financiar
- Z. Hashim Rexhepi, Zyrtar Kryesor i Mbikqyrjes
- Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave
- Z. Gani Gërguri, Zyrtar Kryesor i Operacioneve
- Z. Agron Dida, Inspektor Gjeneral

¹ Zëvendësuar nga Michel Svetchine duke filluar nga Janari 2005

² Zëvendësuar nga Joachim Rücker duke filluar nga Janari 2005

³ Zëvendësuar nga Chiara Bronchi duke filluar nga Shkurti 2005

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë gjithë vitit 2004, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka mbështetur zhvillimin dhe promovimin e një sistemi financiar të sigurtë dhe frytdhënës. Në përkushtimin tonë për promovimin e mirëqënies ekonomike dhe financiare të Kosovës, ne kemi punuar me institucionet financiare, agjensitë qeveritare dhe pjesëmarrësit në sektorin financiar, me synim rritjen e sigurisë dhe efikasitetit në sektorin financiar.

Ekonomia botërore mbeti në gjendje të mirë gjatë vitit 2004, krahasuar me ngadalësimin e vazhdueshëm gjatë viteve të mëparshme. Rritja globale e PBB-s në ekonominë botërore arriti në mesatarisht 4.2 përqind, e cila është më e lartë sesa tendenca historike prej 4.0 përqind. Janë rritur nivelet e inflacionit, duke pasuar rënien e niveleve të ulëta të pazakonta në mesin e vitit 2003. Rritja ekonomike në zonën euro ka ruajtur vullin e saj, me rritje reale të PBB-s e cila arriti në 1.8 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2004 nga 1.2 përqind që ishte në fillim të vitit 2004. Shtetet e reja anëtare, të cilat hynë në BE në Maj 2004, përjetuan aktivitete të fuqishme ekonomike.

Vlerësuar në 3.2 përqind, rritja e PBB-s në ekonominë e Kosovës në vitin 2004 përjetoi një ngadalësim krahasuar me atë të vitit 2003, vlerësuar në 4.7 përqind. Norma e inflacionit u ul në 1.5 përqind në vitin 2004, pas inflacionit dy-shifror në vitin 2001. Papunësia në Kosovë ende mbetet një prej shqetësimeve më të mëdha, ndërkohë që FMN-ja e vlerësoi rreth 33 përqind në vitin 2004. Bilanci i përgjithshëm tregtar, duke përfshirë lëvizjet tregtare dhe jo-tregtare të importeve dhe eksporteve, shënuan një bilanc negativ i cili arrinte në shumën 45.2 përqind të PBB-s nominale. Në vitin 2004 tendencat e vlerësuar fiskale dëshmuan për herë të parë një deficit i cili arrinte në 44.6 milionë euro ose 2.4 përqind të PBB-s nominale.

Sektorin financiar në Kosovë, veçanërisht sektori bankar ka vijuar me zhvillimin e shpejtë të tij. Numri i bankave komerciale ka mbetur i njëjtë me atë të vitit të mëparshëm, por numri gjithsej i degëve (degë, nën-degë, pikë klientele dhe qendër kontrolli teknike), u rrit gjatë vitit 2004 dhe produktet dhe shërbimet e reja bankare (MasterCard, Maestro Card, dhe Visa Card) hynë në përdorim gjithashtu. Në fund të vitit, dy banka operonin gjithsej 43 bankomate. Veç kësaj, një bankë instaloi një numër terminalësh të Pikave të Shitjeve (PTSH) gjatë vitit 2004. Produktet e reja të kreditimit të prezantuara nga bankat gjatë këtij viti përfshinin kredi afatgjatë të biznesit; kredi konsumatori dhe blerjen e të mirave familjare; dhe shërbime bankare elektronike. Rritja e kredive dhe depozitave ishte e madhe dhe siguria në sektorin bankar dhe roli i ndërmjetësimit të bankave në ekonominë e Kosovës u përmirësua në mënyrë të dukshme. Zhvendosja në rritje e depozitave me 35.4 përqind krahasuar me vitin e mëparshëm është një reflektim i mirë i kësaj rritjeje. Përgjithësisht, sistemi bankar mbeti i fortë, i kapitalizuar të mirë, likuid dhe i përmirësuar përsa i përket fitimshmërisë.

Industria e sigurimeve pasoi me të njëjtën tendencë si vitin e kaluar; kishte 8 kompani të licensuara të sigurimeve të cilat operonin në Kosovë. Zbatimi i një sistemi komunikimi on-line dhe pagesat e premiumit përmes bankave ishte arritja e industrisë së sigurimeve gjatë vitit 2004. Platforma e sistemit të komunikimit on-line dhe software-i klient-server i IRIS-it u vunë në funksionim duke filluar nga Qershori 2004. Kjo platformë përfshin të gjitha kompanitë e sigurimeve, degët dhe agjentët e tyre, SHSK, qendrat e regjistrimit të automjeteve dhe BPK-n.

Sistemi Ndërbankar i Pagesave ka qenë tërësisht funksional dhe ka patur për qëllim minimizimin e rrezikut të përgjithshëm të këtij sistemi. Me qëllim përmirësimit të mjeteve moderne të pagesave dhe rritjen e mëtejshme të funksionit të SNP-s, BPK-ja ka prezantuar një projekt të pagesave jo në para të gatshme "Kos-giro", i cili është mbështetur edhe nga FMN-ja.

BPK-ja vazhdon të përforcojë mekanizmat për qeverisje dhe përgjegjësi. Struktura e re e qeverisjes në BPK bëri që të ketë përmirësime të dukshme në cilësinë e kontrollit të brendshëm. Përmirësimet në këtë fushë lidhen ngushtë me rekomandimet e FMN-s. Po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar efikasitetin tonë operativ, përforcuar planifikimin dhe menaxhimin tonë të rrezikut, dhe promovuar cilësinë e hulumtimit. Të gjitha këto na ndihmojnë që puna jonë të jetë e frytshme, transparente, dhe e përgjegjshme për publikun e gjerë.


Në vitin 2004, cilësia e portofolit të investimeve të BPK-s, u përmirësua në mënyrë të ndjeshme, siç u dëshmuua nga cilësia e lartë e kreditimit nga palët investuese. Gjatë këtij viti, u sigurua një portofol i letrave afatshkurtra me vlerë nga qeveritë e BE-s, i cili jo vetëm përmirësoi strukturën e rrezikut të kreditimit të portofolit gjithsej të investimeve por gjithashtu ndihmoi në përmirësimin e likuiditetit, përhapjen gjeografike dhe fitimshmërinë.

Në luftën kundër falsifikimit, BPK-ja punoi ngushtë me partnerët e saj në forcimin e ligjit, institucionet financiare, dhe sektorët e tregtisë me qëllim mbrojtjen e ekonomisë së Kosovës. Kjo përfshin zvogëlimin e barrierave për funksionin efikas të sektorit financiar si edhe përmirësimin e rregulloreve sipas të cilave operojnë institucionet financiare.

Gjatë vitit 2004, BPK-ja ka luajtur një rol aktiv në themelimin e Shoqatës së Bankierëve të Kosovës si një organ i të gjitha bankave në Kosovë. Kohët e fundit BPK-ja ka krijuar Regjistrin e Kreditimit në Kosovë. Me kërkesën e bankave komerciale, RKK-ja do të funksionojë nën mbikqyrjen e BPK-s. BPK-ja ka qenë një anëtar i Bordit të Kosovës mbi Standartet për Raportimin Financiar (BKSRF), dhe merr pjesë në përmirësimin e standarteve të llogarive në sektorin financiar. Përveç kësaj, gjatë vitit 2004 BPK-ja vazhdoi të përfitojë nga asistenca teknike dhënë në mënyrë të pandërprerë nga FMN-ja, Bearing Point-USAID dhe BE.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës po kontribuon në zhvillimin e sektorit financiar duke zvogëluar rrezikun për sigurinë dhe stabilitetin dhe duke tërhequr vëmendjen për fusha ku nevojiten përmirësime në politikat. Dhe, në gjithë atë që bëjmë ne, si një vend pune dhe si një

institucion publik në qendër të ekonomisë së Kosovës, ne do të vazhdojmë ta përkushtojmë vëmendjen tonë për mirëqënien e ekonomisë së Kosovës në tërësi.



ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

1.1. Vështrim mbi Ekonominë Ndërkombëtare⁴

1.1.1 Ekonomia Botërore

Rritja në ekonominë botërore mbetet e fortë, veçanërisht ndërmjet mesit të vitit 2003 dhe mesit të vitit 2004, me rritje globale të PBB-s e cila arrinte mesatarisht në 4.2%, e cila është më e lartë se tendenca historike prej 4.0%. Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja kontribuuan me rritje të kombinuar prej 4.0% në rritjen reale të PBB-s, ndërsa Kina shënoi një rritje prej 9.0% të PBB-s së saj duke patur një rënie nga 9.7% në fillim të vitit 2004. Në veçanti, prodhimi në rritje i naftës dhe rritja që shoqëroi çmimet e naftës ndihmuan në rritjen e PBB-s në Azinë Perëndimore me 5.5% ndërsa rritja në ekonominë rajonale në Azinë Jugore vlerësohet në 6.3%, ose 0.4 përqind më pak sesa gjatë vitit 2003. Rritja reale e PBB-s në Japoni ishte vetëm 0.1%, ndërsa në Amerikën Latine ishte 6.2%. PBB-ja në zonën euro u rrit me 0.3% nga 0.5% në tremujorin e dytë, ndërsa PBB-ja në Afrikë u rrit me 4.5%.

Rritja në PBB-n globale u nxit nga rritja e ndjeshme e PBB-s në Kinë dhe në një masë më të vogël nga përmirësimi i përshpejtuar në SHBA. Faktorët të cilët kontribuan në rritjen globale gjatë kësaj periudhe përfshinin politikat e përshtatura të pandërprera makroekonomike, fitimshmëria në rritje e korporatave, ndikimet e rritjes ekonomike nga tregjet e kapitalit dhe çmimet e strehimit, rritja e punësimit, dhe rritja e ndjeshme në Kinë.

Teksa rritja në tremujorin e parë të vitit 2004 ishte rritja më e madhe gjatë tre dekadave të fundit, tremujori i dytë përjetoi rritje më të ngadalshme, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, Japoni, dhe Kinë, kryesisht për shkak të rritjes së madhe në çmimet e naftës. Në vitin 2004, rritja e theksuar në çmimet e naftës u nxit nga ndërthurja e çështjeve të kërkesës dhe ofertës në disa prej vendeve me më tepër eksport të naftës. Në veçanti, rritja e çmimeve të naftës vinte kryesisht si rezultat i kërkesës më të fortë në krahasim me ofertën si edhe besimi i konsumatorëve, i cili pas një rënieje të ndjeshme në fillim të vitit 2004, u përmirësua dukshëm. Me gjithë paqëndrueshmërinë e dukshme, në Gusht, çmimet e naftës shënuan USD 51.5 për fuçi. Megjithatë, që prej mesit të Shtatorit, ato janë rritur duke tejkaluar edhe një herë mesataren e tyre në tri tremujorët e parë të vitit. Rritja e vërejtur është 42.0% më e lartë sesa në vitin e mëparshëm.

⁴Zhvillimet në Ekonominë Botërore, Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor, kryesisht janë marrë nga: BQE "Buletini Mujor" 01/2005; Kombet e Bashkuara - Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Shoqërore "Gjendja e ekonomisë botërore" 2005; Komisioni Evropian - Direktorati - Gjeneral për Çështjet Ekonomike dhe Financiare "Ballkani Perëndimor në Tranzicion", 12/2004.

Kërkesa gjithsej në qarkullim shkaktoi rritje të ndjeshme në çmimet e produkteve gjithashtu, të cilat që prej fundit të Dhjetorit të vitit 2003 u rritën me 27.0%. Çmimet e produkteve jo-lëndë djegëse u rritën dukshëm në fillim të vitit 2004, por më pas ato pësuan ulje, pjesërisht si rezultat i rritjes së ngadalshme në Kinë, një vend i cili përfaqëson një pjesë thelbësore të konsumimit gjithsej të disa produkteve. Në veçanti, ndryshimet më të mëdha, u shënuan në çmimet e industrisë së lëndës së parë të cilat në mesin e Nëntorit ishin 22.0% më shumë, në krahasim me gjithë vitin.

Me gjithë rënien e rritjes globale gjatë tremujorit të dytë, ende kishte një mundësi për rritje të mëtejshme, kryesisht si rezultat i Shteteve të Bashkuara, me mbështetjen e vendeve Aziatike. Nga ana tjetër, pavarësisht nga fakti që ajo përjetoi një përmirësim të përgjithshëm, rritja në zonën e euros ende mbetet e dobët dhe e varur nga kërkesa e jashtme.

Përsa u përket niveleve të inflacionit në mbarë botën, pas rënies në nivele jashtëzakonisht të ulëta në mesin e vitit 2003, nivelet e inflacionit u rritën, duke shkaktuar shqetësime për rritjen e sërishme të tyre. Lidhur me tregjet e këmbimit të huaj, deficioni aktual i llogarive të SHBA-s ishte faktori kryesor i cili bëri që të ulej besimi ndërkombëtar në dollarin Amerikan. Për rrjedhojë, euro u forcua edhe më shumë kundrejt dollarit ku norma e këmbimit euro-dollar Amerikan luhatej në USD 1.2 dhe USD 1.24 kundrejt euros. Në mesin e Nëntorit norma e këmbimit të dollarit Amerikan pësoi uljen më të madhe në gjitha kohërat kundrejt valutave të tjera kryesore, duke rënë në USD 1.3 kundrejt euros. Disa ndryshime u shënuan edhe për jenin Japonez gjithashtu, i cili pësoi një zhvlerësim të lehtë, ndërsa paundi pësoi një vlerësim disi të lehtë kundrejt dollarit Amerikan.

Shtetet e Bashkuara shënuan një përmirësim përse i përket aktivitetit ekonomik. Në fund të vitit 2004, PBB-ja reale u rrit me 3.9% në baza tre-mujore, duke pasuar me rritje prej 3.3% në tremujorin e dytë të vitit 2004. Kjo rritje u shkaktua kryesisht nga rritja e shpenzimeve të konsumimit vetjak për artikujt e qëndrueshëm. Gjithashtu, përveç faktit që eksportet u rritën më shpejt në krahasim me importet, kontributi i eksporteve neto ndaj rritjes së PBB-s ishte negativ.

Deficioni i llogarisë vijuese të SHBA-s vazhdoi të keqësohet gjatë gjithë vitit 2004, duke u vlerësuar në USD 166.2 miliardë, dhe duke përfaqësuar 5.7% të PBB-s në tremujorin e dytë. Pavarësisht nga zhvlerësimi i mëparshëm i dollarit Amerikan, deficioni i llogarisë vijuese mendohet të vazhdojë të mbetet në mbi 4.0% të PBB-s gjatë mesit të periudhës. Me gjithë këtë situatë, pati përkeqësime në deficionin e buxhetit gjithashtu, i cili u përlllogarit në USD 412.6 miliardë ose 9.4% më shumë sesa në vitin e mëparshëm.

Përsa i përket inflacionit të IÇK-s, në Tetor 2004, rritja vjetore e IÇK-s shënoi 3.2% nga 2.5% në Shtator. Kjo u shkaktua kryesisht nga rritja e çmimeve të energjisë (+10.4%).

Duke pasuar rritjen e ulët të vërejtur në fillim të vitit 2004, rritja e aktivitetit ekonomik në **Japoni** u ngadalësua në tremujorin e dytë, ndërkohë që pati një dobësim në tremujorin e tretë. Ky

ngadalësim në rritjen e aktivitetit ekonomik të Japonisë vinte kryesisht për shkak të përkeqësimit në përbërësit e konsumit si p.sh. eksportet dhe investimet jo-rezidente si edhe kontributet negative të tregtisë së jashtme dhe pagesave. Megjithatë, gjatë vitit 2004, PBB-ja reale u rrit me 0.1% në baza tre-mujore.

Gjendja e ekonomisë Japoneze u ndikua pjesërisht nga çmimet e larta të naftës, të cilat u reflektuan në rritjen e çmimeve të prodhuesit të brendshëm. Për më tepër, aktiviteti ekonomik u ndikua gjithashtu nga zvogëlimi në kërkesën e jashtme dhe fatkeqësitë natyrore të kohëve të fundit. Duke pasuar ndryshimet përkatëse në çmimet e ushqimeve, të cilat pësuan një zbritje prej 0.1%, në Tetor, IÇK-ja u rrit me 0.5% në baza vjetore.

Rritja në ekonominë **Kineze** u ngadalësua në vitin 2004, megjithatë ajo vazhdoi t'i tejkalojë vendet e tjera të botës. PBB-ja reale vjetore në Kinë u rrit me 9.1% në tremujorin e tretë të këtij viti, duke pasuar rritjen prej 9.7% në gjysmën e parë të vitit. Ky ngadalësim vinte si rrjedhojë e zvogëlimit të rritjes së investimeve deri në 27.7% krahasuar me tremujorin e parë kur ato u rritën me 43.0%. Në Tetor, inflacioni vjetor i IÇK-s u zvogëluar në 4.3% nga 5.2% në Shtator, kryesisht për shkak të luhatjeve të çmimeve të ushqimeve.

Rritja në çmimet e naftës mbështeti rritjen ekonomike në **Rusi**. Ndikuar nga konsumi dhe shpenzimet në investime dhe, veçanërisht nga kontributi negativ i eksporteve neto, në tremujorin e dytë, rritja e PBB-s pësoi një ulje të lehtë krahasuar me tremujorin e parë, duke arritur në 7.3% në baza vjetore. Përsa i përket zhvillimeve të çmimeve, inflacioni i çmimit të konsumit ishte në një nivel të lartë dhe vazhdon të rritet edhe më tej.

1.1.2. Bashkimi Evropian

Rritja në **zonën euro**, sipas vlerësimeve të Eurostatit, u ngadalësua me 0.3% në tremujorin e tretë nga 0.5% në tremujorin e dytë dhe 0.7% në tremujorin e parë të vitit 2004. Megjithatë, rritja ekonomike në zonën euro e ka ruajtur vullin e saj, me rritjen reale të PBB-s e cila arrinte në 1.8% në tremujorin e tretë të vitit 2004 nga 1.2% në fillim të vitit 2004. Shprehur më hollësisht, përforcimi i përmirësimit ndryshon ndërmjet vendeve dhe në disa prej tyre ai është ndikuar në mënyrë të ndjeshme nga kërkesa e jashtme. Faktorët të cilët kanë kontribuar në këtë rritje përfshijnë eksportet, të cilat në tremujorin e dytë u rritën me 7.6% krahasuar me tremujorin e parë, ndërsa në tremujorin e tretë rritja e tyre u ngadalësua në 6.1%. Nga ana tjetër, importet në zonën euro vazhduan të rriten në tremujorin e tretë me 8.7% nga 6.7% në tremujorin e dytë të vitit 2004.

Në tremujorin e tretë të vitit 2004, çmimet e konsumit u rritën me 0.5 % krahasuar me tremujorin e dytë, duke treguar kështu një stabilizim të çmimeve nga tremujori i dytë kur ato u

nxitën kryesisht nga rritja e taksave. Në të kundërt, çmimet e ushqimeve të papërpunuara ishin relativisht më të ulëta për shkak të kushteve të favorshme të motit. Për shkak të rritjes së çmimit të naftës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) u rrit në 2.4% në Tetor ndërsa inflacioni thelbësor mbeti i pandryshuar në masën 2.0%.

Përsa i përket rritjes ekonomike të vendeve individuale, në **Gjermani**, PBB-ja reale u rrit me 1.3% në tremujorin e tretë 2004, duke shënuar zbritje prej 1.4% në tremujorin e dytë, ndërsa në fillim të vitit 2004 pati një rritje të ndjeshme prej 0.8%. **Franca** gjithashtu shënoi një ngadalësim në rritjen e PBB-s reale në 2.0% në tremujorin e tretë krahasuar me tremujorin e dytë kur ajo u rrit me 2.9%. **Italia** ka shënuar një rritje disi të qëndrueshme me rritje mesatare të PBB-s reale prej 1.3%, ndërsa **Belgjika** përjetoi një përmirësim me rritje reale të PBB-s prej 3.0% në tremujorin e tretë të vitit 2004 nga 2.9% në tremujorin e dytë. Në zonën euro **Finlanda** dhe **Greqia** shënuan rritjen më të lartë në PBB-n e tyre reale prej, përkatësisht, 3.7% dhe 3.8%.

Treguesit afatshkurtër tregojnë se prodhimi i **Suedisë** vazhdoi të rritej, edhe pse pati një rritje mesatare në tremujorin e tretë të vitit 2004. Eksportet neto përfaqësojnë pjesën kryesore të kësaj rritjeje, e cila u shoqërua me rritjen e investimeve, duke kontribuar me rritje prej 1.0% të PBB-s në tremujorin e dytë. Rritja e çmimit të naftës shkaktoi rritjen e shpenzimeve të transportit dhe kështu që kjo ndikoi në rritjen e inflacionit vjetor të IHÇK-s në 1.4% në Tetor nga 1.2%, mesatarisht, më parë atë vit.

Të njëjtët tregues në **Danimarkë** tregojnë një ngritje në rritjen e PBB-s reale në tremujorin e tretë të vitit 2004. Në tremujorin e dytë, PBB-ja reale në Danimarkë u rrit me një rritje tremujore prej 0.2%, rritje kjo shkaktuar nga formacioni i pandryshuar i kapitalit real bruto dhe konsumimi vetjak. Inflacioni i IHÇK-s, në baza vjetore, u rrit në 1.6% në Tetor nga 0.9% që ishte në Shtator.

Në gjysmën e parë të vitit 2004, Mbretëria e Bashkuar përjetoi një prodhim të fortë shoqëruar nga një ngadalësim në tremujorin e tretë, me rritje të PBB-s reale me 0.4% në baza tremujore, duke pasuar një rritje prej 0.9% në tremujorin e dytë. Kjo ishte kryesisht për shkak të rënies prej 0.1% në kapitalin e pandryshuar bruto e cila çoi në rënien e investimeve. Eksportet dhe importet u rritën me 1.9% dhe 1.6%, përkatësisht në baza tremujore.

Duke pasuar indeksin e harmonizuar të inflacionit të BE-s prej 2.0%, në vitin 2004, inflacioni i IHÇK-s të MB-s në baza vjetore qëndroi nën objektivin e parashikuar, i cili në Shtator arriti 1.1%, ndërkohë që në Tetor pati një rritje të lehtë në 1.2%.

Shtetet Anëtare të cilat hynë në BE në Maj 2004 përjetuan gjithashtu një aktivitet të fuqishëm ekonomik. Treguesit afatshkurtër tregojnë një ngadalësim të PBB-s reale në **Poloni**, në tremujorin e tretë të vitit 2004, e cila u rrit në baza vjetore me 6.1% duke pasuar rritjen prej 6.9% më herët në vitin 2004. Ato që kontribuan më shumë në këtë rritje ishin aktiviteti i madh në eksport dhe

përmirësimi në kërkesën e brendshme. Çmimi i ulët i ushqimeve dhe vlerësimi i kohëve të fundit të zlotës Polake ndikuan ndjeshëm në rritjen e inflacionit vjetor të IHÇK-s gjatë gjysmës së parë të vitit 2004, ndërsa në Tetor pati një rënie të lehtë në 4.6% nga 4.9% në Gusht kur ai arriti pikën e tij më të lartë.

Në mënyrë të ngjashme, **Republika Çeke** përjetoi një aktivitet të fortë ekonomik në tremujorin e tretë të vitit 2004. Rritja reale e PBB-s mbeti në masën 3.5% në fillim të vitit 2004 dhe pati një rritje të mëtejshme në tremujorin e dytë duke kontribuar në rritjen vjetore të PBB-s reale prej 4.1%. Shkaktari kryesor i kësaj rritjeje është kapitali fiks bruto, i cili pati ndikim kryesisht nga zhvillimet në ekonominë e ofertës ndërsa ndikimi i eksporteve neto në rritjen e PBB-s ishte negativ. Inflacioni vjetor i IHÇK-s në Tetor të vitit 2004 ishte 3.1% krahasuar me 2.8% në Shtator.

Në **Hungari** u vërejt një ngadalësim i rritjes vjetore të PBB-s reale, e cila në tremujorin e tretë të vitit ishte 3.7% në krahasim me 4.0% në tremujorin e dytë, shkaktuar tërësisht nga ndikimi i kërkesës së brendshme. Inflacioni vjetor i IHÇK-s arriti shumën 6.7% në Shtator ndërkohë që pati një rënie në 6.4% në Tetor, kryesisht për shkak të zhvillimeve në çmimet e mallrave të qëndrueshme të konsumit.

1.1.3. Ballkani Perëndimor

Viti 2004 shënoi një përshejtim të ekonomisë në Ballkanin Perëndimor, me rritje të vlerësuar të PBB-s prej 4.7% e cila është më e lartë sesa në vitin 2003 kur u rrit me 3.6%. Kjo rritje u shkaktua kryesisht nga rritja e PBB-s reale në Bosnje dhe Hercegovinë (BH) dhe Serbi dhe Mali i Zi (SMZ), e cila në vitin 2004 u rrit me 5.0% krahasuar me 3.5% dhe 3.0% në vitin 2003. Nga ana tjetër, rritja e PBB-s në Shqipëri u rrit me një ritëm të pandërprerë prej 6.0% ndërsa në Kosovë kjo rritje u ngadalësua duke arritur rritje reale të PBB-s prej 3.2%. Maqedonia gjithashtu shënoi një ngadalësim në rritjen reale të PBB-s e cila ra në 2.0% në vitin 2004 nga 3.2% në vitin 2003, ndërsa Kroacia përjetoi një zbritje të rritjes reale të PBB-s nga 4.3% në 2003 në 3.8% në vitin 2004. Të dyja Bullgaria dhe Rumania shënuan një rritje thelbësore në rritjen e tyre reale të PBB-s, përkatësisht 1.4% dhe 2.3%, më shumë se në vitin 2003. Edhe pse pati një ritëm të njëjtë në rritjen e PBB-s në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë viteve 2002-2003, vlerësimet shfaqin një rritje të pabarabartë në vitin 2004.

Tabela 1. Treguesit Kryesorë të Ekonomisë

<i>Ballkani Perëndimor⁵</i>		2001	2002	2003	2004
Rritja reale e PBB-s	%	5.1	3.7	3.6	4.7
Inflacioni (mesatarisht)	%	44.1	12.0	6.6	5.6
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	% të PBB-s	-2.8	-3.4	-2.6	-2.7
Të ardhurat gjithsej	% të PBB-s	35.8	38.1	37.2	37.8
Shpenzime gjithsej	% të PBB-s	39.0	41.8	39.9	40.1
Bilanci tregtar me botën	Miliardë EUR	-8.2	-9.7	-9.7	n/a
Bilanci tregtar me BE-15	Miliardë EUR	-3.2	-4.1	-3.9	n/a
Bilanci il logarive rrjedhëse	% të PBB-s	-7.1	-10.7	-10.3	-11.6
Eksportet	Miliardë EUR	4.6	4.7	5.0	n/a
Importet	Miliardë EUR	12.8	14.5	14.6	n/a
Investimi i huaj i drejtpërdrejtë	Milionë EUR	1058	1042	1729	1367

Burimi: Komisioni Evropian- Direktorati - Gjeneral për Çështjet Ekonomike dhe Financiare "Ballkani Perëndimor në Tranzicion", 12/2004.

Në bazë të vlerësimeve dhe rezultateve, norma e inflacionit në gjithë rajonin në vitin 2004 ra në 5.6% nga 7.0% në vitin 2003. Kjo rënie në normat e inflacionit në pjesën më të madhe mund të jetë shkaktuar nga normat e ulëta në BH (0.9%), Maqedoni (0.5%), Kosovë (1.5%) and Shqipëri (3.4%). Rënie e normave të inflacionit u shënuar gjithashtu në Rumani, e cila ra nga 15.3% në vitin 2003 në 12.0% në vitin 2004. Gjatë vitit 2004, Kroacia dhe Bullgaria përjetuan një rritje në normat e tyre të inflacionit, me përkatësisht 0.4% dhe 3.7%. Edhe pse normat e inflacionit ranë në numra një-shifror, në Serbi dhe Mali i Zi nxitjet e inflacionit mbetën ende të larta (9.4%) në vitin 2004 të cilat u shkaktuan kryesisht nga rritja e çmimit të naftës si edhe nga rritja e normave të tërthorta të taksave. Megjithatë, krahasuar me vitin 2001 dhe 2002, normat e inflacionit në Ballkanin Perëndimor kanë rënë ndjeshëm nga 44.1% dhe 12.0% në vitin 2001 dhe 2002, në 5.6% në vitin 2004.

Viti 2003 u karakterizua nga një deficiet i lartë tregtar në Ballkanin Perëndimor, i cili arriti në 26.5% të PBB-s. Eksportet gjithsej u rritën me një ritëm më të shpejtë krahasuar me importet, duke u rritur me 5.4% krahasuar me rritjen prej 1.2% të impoerteve. Edhe pse eksportet u rritën më shpejt sesa importet, vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan nivele të ulëta të eksporteve. Defiçiti tregtar i këtyre vendeve me BE-n arriti shumën 4.0 miliardë euro, e cila është 12.0% e PBB-s mesatare të rajonit.

Trendet fiskale në vitin 2004 kanë treguar profile të ndryshme krahasuar me vitin 2003 kur deficietet publike u ulën në 2.6% të PBB-s. Në vitin 2004, deficieti fiskal i Ballkanit Perëndimor u rrit në 2.7% të PBB-s i cili u shkaktua kryesisht nga mungesa e fondeve të jashtme për projekte

⁵ Të dhënat në këtë tabelë nuk përfshijnë Bullgarinë, Kroacinë dhe Rumaninë, pasi ato janë çështje memorandumi dhe ato janë vende kandidatë të Evropës Qëndrore dhe Juglindore.

investimi shoqëruar nga shpenzime të mëdhaja kapitale të cilat kontribuan në një rritje të theksuar në deficitin fiskal në Shqipëri nga 4.0% të PBB-s në vitin 2003 në 6.5% në vitin 2004. Nga ana tjetër, Bosnia dhe Hercegovina, e pakësoi pjesëmarrjen e saj të shpenzimeve publike në PBB në pothuajse 4.0% në vitin 2004 dhe për rrjedhojë çoi në një bilanc të lehtë pozitiv të bilancit qeveritar. Pas një deficiti prej 4.0% në vitin 2003, në Serbi dhe Mali i Zi vlerësimet tregojnë se bilanci i përgjithshëm i qeverisë është zvogëluar me rreth 2.7% të PBB-s në vitin 2004, ndërsa në Kosovë për herë të parë këtë vit pritet një deficit pas bilanceve të vazhdueshme positive në vitet e mëparshme. Kështu, deficiti pritet të financohet nga tepricat e akumuluar në të kaluarën.

Të hyrat e kapitalit nga investimet e drejtpërdrejta të huaja (IDH) janë rritur në mënyrë të ndjeshme në vitin 2003 kryesisht për shkak të procesit të privatizimit në Serbi dhe Mali i Zi. Megjithatë, rritja e të hyrave të kapitalit në Ballkanin Perëndimor në vitin 2004 pati një ngadalësim të lehtë duke u llogaritur në 2.9% të PBB-s ndërkohë që në vitin 2003 mbeti në 4.4% të PBB-s, e cila është e barasvlershme me 71.6 Euro shprehur për frymë. Në përgjithësi, borxhi i jashtëm i Ballkanit Perëndimor mbeti në masën 49.0% të PBB-s në vitin 2003 dhe në fund të vitit 2004 u ul në 42.0% të PBB-s.

1.2. Karakteristika të Përgjithshme të Ekonomisë së Kosovës⁶

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2004, krahasuar me vitin 2003 shënoi një rritje reale prej 3.2%. Pas inflacionit dy-shifror prej 11.7% në vitin 2001, periudhat pas këtij viti treguan një lëvizje të qëndrueshme të normave të inflacionit, 3.6%, 1.0%, dhe 1.5% përkatësisht në vitet 2002, 2003, dhe 2004. Papunësia në Kosovë ende mbetet një prej shqetësimeve më të mëdha, ndërkohë që FMN-ja e vlerësoi në rreth 33% në vitin 2004. Bilanci i përgjithshëm tregtar, duke përfshirë lëvizjet tregtare dhe jo-tregtare të importeve dhe eksporteve, shënoi një bilanc negativ prej 845 milionë Euro ose 44.5% të PBB-s nominale.

Tendencat fiskale në vitin 2004 për herë të parë pas vitit 2000, dëshmuar një deficit prej 44.6 milionë euro ose 2.4% të PBB-s nominale. Ky deficit u shkaktua kryesisht nga rritja neto në shpenzime me 16.6%. Të hyrat ende varen nga taksat kufitare, të cilat në vitin 2004 u llogaritën rreth 69% të të hyrave gjithsej krahasuar me 89% në vitin 2000.

Ulja në kërkesat ndaj jorezidentëve me 5.4% krahasuar me vitin 2003, të cilat ishin 687 milion euro në vitin 2004, shkaktuan ulje në Mjetet e Huaja Neto (MHN) gjithsej të Korporatave Depozituese (KD) me 11.4%, duke u llogaritur në 617 milionë euro. Kërkesat e brendshme në vitin 2004 shfaqin një tablo krejtësisht ndryshe krahasuar me vitin e mëparshëm. Ndryshimi kryesor është që ato u kthyen në positive duke u llogaritur në 162 milionë euro në vitin 2004 nga -3, -44, -172, dhe -110 milionë euro në vitet 2000, 2001, 2002, dhe 2003.

Detyrimet e parasë së gjerë u shënuar në shumën 720 milionë euro. Në ndryshim nga viti i mëparshëm ku depozitat e transferueshme ende llogariten për një pjesë më të madhe krahasuar me depozitat e tjera (kohore dhe të kursimit), në vitin 2004 raporti i depozitave të tjera ndaj depozitave gjithsej përfshirë në paranë e gjerë, ishte 42.3% duke treguar një ulje të ndjeshme krahasuar me raportin prej 92.8% të depozitave të transferueshme në vitin 2000. Bazuar në vlerësimet e valutës në qarkullim, Kosova pati përmirësime përsa i përket ekonomisë së parave të gatshme, ku raporti i valutës jashtë korporatave depozituese (valuta në qarkullim) ndaj detyrimeve të parasë së gjerë në fund të vitit 2004 shënoi rreth 60% duke përfaqësuar raportin më të ulët që prej vitit 2000.

⁶ Shifrat e vitit 2004 bazohen në vlerësimet sipas stafit të FMN-s. Për shkak të ndryshimeve në shpenzimet e Qeverisë në fund të vitit 2004, këto vlerësime do të rishikohen.

1.2.1. Sektori Real

1.2.1.1. PBB

Rritja reale e ekonomisë së Kosovës në vitin 2004 arriti në shumën prej 3.2% me çmimet e pandryshueshme të vitit 2002. Kërkesa e brendshme dha kontribut negativ prej 2.1%, ndërsa bilanci tregtar kontribuoi me 5.3%. Kërkesa më e dobët e brendshme, e cila u ul me 1.5% krahasuar me vitin 2003, vjen si pasojë e uljes në të dyja, konsum dhe investime, përkatësisht me 1.4% dhe 2.3%. Bilanci tregtar i vitit 2004, duke përfshirë importet dhe eksportet tregtare dhe jo-tregtare është negativ, ku raporti i eksporteve me importet arrin 12.9%, i cili është rritur me 1.1 përqind krahasuar me vitin 2003; ndërkohë që duke përfshirë vetëm tregtinë komerciale, në fund të vitit 2004 raporti llogaritet në 3.4%. Paratë e dërguara nga punonjësit jashtë arritën në shumën 238 milionë euro në vitin 2004 ose 12.8% të PBB-s.

Tabela 2. Prodhimi i Brendshëm Bruto, me çmimet e pandryshuara të vitit 2002

(Në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)

	2000	2001	2002	2003	2004
Konsumi	2,654	2,749	2,630	2,616	2,579
Publik	1,015	1,044	948	905	851
Qeveria qendrore 1/	171	187	253	315	342
UNMIK & Donatorë të tjerë 2/	844	857	695	591	509
Privat	1,638	1,705	1,682	1,711	1,727
Investimi	586	682	598	524	512
Publik	298	273	222	220	206
Qeveria qendrore 1/	20	21	42	95	112
Investimi i donatorëve 2/	279	252	180	124	94
Privat (duke përfshirë NP-t & NSH-t)	288	409	376	304	306
Kërkesa e brendshme gjithsej	3,240	3,432	3,228	3,139	3,091
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve	293	279	217	184	185
Importet e mallrave dhe shërbimeve	2,169	1,995	1,710	1,535	1,430
Prodhimi i Brendshëm Bruto	1,364	1,715	1,735	1,789	1,845
Rritja reale e PBB-s	-	25.7%	1.2%	3.1%	3.2%
Të hyrat e faktorit neto nga jashtë	450	414	390	359	340
prej të cilave: paratë e dërguara nga punonjësit jashtë	257	225	241	239	238
Të Hyrat e Disponueshme Kombëtare Bruto	1,814	2,129	2,125	2,148	2,186

Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-s.

1/ Të dhënat nga qeveria qendrore mund të pësojnë ndryshime.

2/ Sektori donator përfshin UNMIK-un, KFOR-in, dhe donatorë të tjerë të cilët shpenzojnë nën ombrellën e "programit të investimit publik", dhe shpenzime të financuara nga grantet e caktuara donatore (GCD-t). Ky prezantim përjashton pagat e personelit të KFOR-it si edhe konsumimin e mallrave të importuara drejtpërdrejtë nga KFOR-i.

Në vitin 2004 konsumi llogaritej 139.8% të PBB-s nga 146.2% në vitin 2003, ndërkohë që ai gjithashtu shfaq ulje në krahasim me konsumin e vitit 2003 me 1.4%. Konsumi privat në vitin 2004 llogaritej 66.9% të konsumit gjithsej, duke treguar një rritje nga viti në vit prej 0.9% ose duke kontribuar në konsumin gjithsej me 0.6% krahasuar me vitin 2003. Konsumi publik bëhet nga sektori qeveritar dhe institucionet nën Programin e Investimit Publik (PIP) të cilat së bashku janë duke treguar një tendencë në rënie prej -5.9% duke kontribuar në konsumin gjithsej me 0.8%.

Investimet në Kosovë mbeten në nivele të ulëta, të cilat në fund të vitit 2004 arritën në 512 milionë euro ose 27.7% të PBB-s në vitin 2004. Kjo tendencë vijon që prej vitit 2001 kur ato ishin në kulmin e tyre duke arritur në 682 milionë euro ose 39.7% të PBB-s, ndërsa në vitin 2002 ato arrinin në 34.5%, dhe 29.3% në vitin 2003. Investimet publike dhe private kanë shfaqur një rënie prej 6.4% dhe 0.7%; në të njëjtën kohë kontributet e tyre në investimet gjithsej ishin përkatësisht -2.6% and 0.3%.


Konsumi dhe investimet e sektorit privat gjatë vitit 2004 mbetën të pandryshuara, duke u ulur me 0.8% krahasuar me vitin 2003. Përsa i përket strukturës sektorale, sektori privat llogaritet në 65.7% të kërkesës së brendshme gjithsej ose 93.9% të PBB-s në vitin 2004. Kërkesa e brendshme përbëhet kryesisht nga konsumi i cili në vitin 2004 llogaritej në 2.6 miliardë euro ose 83.7% e kërkesës së brendshme, e cila ishte e qëndrueshme që prej vitit 2001 ku llogaritej në 2.7 miliardë euro.

Siç tregohet në Tabelën 2, kërkesa e brendshme gjithsej ka pësuar një tendencë në rënie nga viti në vit që prej 2001 kur arriti nivelin më të lartë të rritjes prej 5.9%, ngadalësuar me një rritje nga viti në vit prej 1.5% në 2004 krahasuar me vitin 2003. Për shkak të bilancit negativ tregtar që prej vitit 2000, kërkesa e brendshme ishte më e lartë sesa PBB-ja, ndërsa në vitin 2004 ajo llogaritej në 167% të PBB-s.

Ndihma e huaj dhe paratë e dërguara nga punonjësit jashtë janë shumë domethënëse në tablonë e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë dhe në vitin 2004 ato llogariteshin në 628 milionë euro ose 34.1% të PBB-s. Përkatësisht, në vitin 2000 ndihma e huaj dhe paratë e dërguara arritën nivelin 1.3 miliardë euro, duke qenë kështu burimi i pothuajse të gjithë PBB-s, dhe llogaritur në 93.2% të PBB-s të vitit 2000. Në vitin 2004, burimi kryesor i ndihmës së huaj ishte UNMIK-u, i cili llogaritej 50.5% të ndihmës së huaj gjithsej, ndërsa KFOR-i dhe donatorët e tjerë dhanë ndihmë financiare por të cilat përbënin një pjesë të vogël të tyre. Paratë e dërguara si të hyrat e faktorit neto nga jashtë mbetën të qëndrueshme gjatë periudhës 2000-2004. Ato lëviznin nga 257 milionë euro në 2000 në 238 milionë euro në vitin 2004, ose 12.9% të PBB-s. Kryesisht për shkak të lëvizjes së përmendur të parave të dërguara, hendeku gjithashtu ndërmjet PBB-s dhe ABBK-s u ngushtua edhe më tepër nga 133.0% në vitin 2000 në 118.5% në vitin 2004.

Që prej vitit 2000 ekonomia është përballuar me mos-kursime të cilat në vitin 2004 llogariteshin në 21.3% të PBB-s. Kjo kategori ka një tendencë në ulje krahasuar me 61.5%, 36.1%, 29.0%, dhe 26.1%, përkatësisht në 2000, 2001, 2002, dhe 2003. Duke qenë se ekonomia e Kosovës mbështetet kryesisht në importet, çdo rritje në importe vjen si rrjedhojë e konsumit të sektorit privat dhe publik (Figura 1). Rritja e PBB-s për frymë, që prej vitit 2001 tregon se Kosova është ende në nivel shumë të ulët, ndonëse në vitin 2004 ishte 939 euro për frymë.

Figura 1: Lëvizja e Konsumit dhe Importeve
(Ndryshim i përqindjes vjetore)



Përbërësi kryesor në bilancin tregtar të Kosovës janë importet, të cilat në vitin 2004 llogariteshin në 1.5⁷ miliardë euro. Ulja e kërkesës së brendshme u pasua me uljen e importeve. Ato u ulën me 10.2% krahasuar me vitin e mëparshëm ose me 29.2% krahasuar me nivelin më të lartë të importeve në vitin 2000. Në krahasim me importet, eksportet kanë qenë të vogla. Në vitin 2004 ato llogariteshin në 185 milionë euro ose 12.9% të importeve, duke theksuar kështu raportin ndërmjet eksporteve dhe importeve.

1.2.1.2 . Indeksi i Çmimit të Konsumit


Gjatë vitit 2004 nuk ka patur ndryshime të theksuara të inflacionit sipas IÇK-s, duke dëshmuar në këtë mënyrë një lëvizje të qëndrueshme (Figura 2). Megjithatë, zhvillimet e IÇK-s nga muaji në muaj tregojnë që duke filluar nga Janari 2004, IÇK-ja ra nga 0.2% në -1.4% në Qershor 2004, pasuar nga një rritje prej 0.4 përqind në Korrik 2004, dhe ka patur një rritje të lehtë duke arritur 1.8% në Tetor 2004. Së fundmi, IÇK-ja nga muaji në muaj në Dhjetor 2004 ishte 0.5%.

Gjatë 12 muajve (e njëjta periudhë me vitin e mëparshëm) IÇK-ja tregon lëvizje më të paqëndrueshme, veçanërisht gjatë periudhës Janar-Shkurt pati luhatje prej 0.6% pasuar nga -1.2 përqind dhe duke qëndruar në 0.2% në Mars 2004. Nga ajo periudhë, Mars 2004 ka patur rritje

⁷ Për shkak të ndryshimeve në raportimin e përmbljedhjeve të importeve dhe eksporteve ndërmjet "Prodhimit të Brendshëm Bruto" dhe "Bilancit të Pagesave", të dhënat për bilancin e tregtisë tregojnë shifra të ndryshme.

të vazhdueshme duke arritur në Korrik në 3.0%. Periudha e Shtatorit tregon rënie të theksuar në -1.3% dhe -2.5% në Dhjetor krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Figura 2: Indeksi i Çmimit të Konsumit



Bazuar në përlogaritjet dhe vlerësimet e stafit të FMN-s, inflacioni në Kosovë për vitin 2004 ishte rreth 1.5%, një rritje kjo prej 0.5 përqind krahasuar me vitin 2003. Në periudhat e mëparshme, normat e inflacionit në vitet 2001 dhe 2002 ishin më të larta. Në vitin 2001 norma e inflacionit llogaritej në 11.7%, por, vit pas viti normat e inflacionit ranë në 3.6% dhe që prej asaj kohe ka patur një lëvizje të qëndrueshme vit pas viti nga 0.5% në 3.6%. Për rrjedhojë, stabiliteti i çmimeve në afate më të gjata vazhdon të jetë tipari pozitiv i ekonomisë së Kosovës duke mbështetur në këtë mënyrë stabilitetin e përgjithshëm të ekonomisë.

1.2.1.3. Papunësia e Regjistruar

Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2004 ka patur një rritje prej 6.9% të aplikuesve për punë. Gjatë vitit 2004, struktura e papunësisë sipas arsimit dhe gjinisë mbetet e njëjtë krahasuar me atë të vitit 2003 por me një ndryshim të lehtë në krahasim me vitet e mëparshme. Shprehur më qartë, në vitin 2000, raporti i femrave të papunësuar ndryshonte nga 43%, 44% në vitin 2001, ndërkohë që në vitin 2002 raporti u rrit thelbësisht në 63% për t'u rritur sërish në vitin 2003 në 45%, dhe së fundmi 46% në vitin 2004.

Tabela 3. Papunësia e Regjistruar

	2000	2001	2002	2003	2004
Papunësia e regjistruar gjithsej	208.074	237.958	282.305	282.305	301.982
Prej të cilave: femra	43.2	44.1	63.0	45.4	45.7
Klasifikimi sipas arsimit (në %)					
Fillor	58.1	60.4	61.5	63.0	63.4
I Mesëm	38.8	37.0	36.2	35.3	35.1
Universitar	3.1	2.6	2.2	1.8	1.5

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Shënim: Përqindjet janë të shprehura sipas numrit gjithsej të të papunësuarve.

Në papunësia gjithsej sipas arsimit për vitin 2004, përqindja e të papunësuarve me diplomë universitare ishte 1.5% krahasuar 3.1%, 2.6%, 2.2%, dhe 1.8%, përkatësisht në vitet 2000, 2001, 2002, dhe 2003. Përqindja e të papunësuarve me arsim të mesëm ishte 35.1% ose më pak se 3.7 përqind krahasuar me kulmin e saj në vitin 2000. Të papunësuarit me arsim fillor është 63.4%.

Megjithatë, në tabelën e mësipërme gjenden vetëm të papunësuarit e regjistruar. Por, në të vërtetë, në zyrën përkatëse të papunësisë ka persona të papunë dhe të cilët nuk janë të regjistruar. Përgjithësisht, sipas vlerësimeve të stafit të FMN-s, papunësia në Kosovë është rreth 33%. Bazuar në skenarin e stafit të FMN-s lidhur me papunësinë, një rritje vjetore punësimi prej 3% gjatë dhjetë viteve të ardhshme do të krijonte rreth 145.000 vende pune të reja shtesë, ndërkohë që norma e papunësisë do të ulej në 25%. Gjithashtu, vlerësimet e këtij stafi shprehin se punësimi informal në vitin 2004 ishte rreth 150.000.

1.2.2. Sektori Fiskal

Për herë të parë që prej vitit 2000, buxheti i konsoliduar i Kosovës regjistroi një deficit buxheti 44.6 milionë euro ose 2.4% të PBB-s nominale. Ky deficit kryesisht vjen si shkak i rritjes së shpenzimeve me 19.1% krahasuar me vitin e mëparshëm duke arritur në shumën 649.2 milion Euro. Ndërkohë që krahasuar me luhatjen e shpenzimeve, të ardhurat mbeten të qëndrueshme, duke shënuar një rritje prej 2.5% ose rritje neto në shpenzime me 16.6%.

Tabela 4. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
 (Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)

	2000	2001	2002	2003	2004
Të ardhurat	128.5	321.3	499.6	589.6	604.6
Qeveria qendrore	128.5	306.3	479.8	566.1	574.8
Taksat e drejtpërdrejta	6.4	28.8	48.3	63.5	72.2
Taksat jo të drejtpërdrejta	113.9	256.0	389.9	462.4	464.9
Të ardhurat jo nga taksat	8.3	21.5	41.6	40.2	37.8
Të ardhurat vetë-burimore të komunave	0.0	15.0	19.9	23.6	29.8
Shpenzimet	203.8	245.7	402.3	545.1	649.2
Shpenzimet rrjedhëse	186.8	225.1	360.4	448.7	534.2
Pagat	92.3	109.5	131.4	145.7	170.1
Mallrat dhe shërbimet	44.1	55.4	121.3	173.7	181.9
Transfertat dhe subvencionet	50.4	60.2	107.7	127.0	167.2
Të tjera [rezervat]	0.0	0.0	0.0	2.3	15.0
Shpenzimi kapital	17.0	20.6	41.9	96.4	115.0
Bilanci i përgjithshëm (përpara mbështetjes buxhetore)	-75.3	75.6	97.3	44.6	-44.6
Mbështetja buxhetore	120.6	41.1	9.6	0.0	0.0
Bilanci i përgjithshëm (pas mbështetjes buxhetore)	45.2	116.7	106.9	44.6	-44.6

Burimi: Qeveria qendrore dhe vlerësimet e FMN-s.

Shënim: Shifrat për vitin 2004 do të ndryshojnë për shkak të shpenzimeve në tremujorin e fundit të vitit 2004.


Krahasuar me vitin e mëparshëm të ardhurat e buxhetit u rritën me 2.5%, dhe me përqindje të PBB-s arritën 31.9% në vitin 2004 nga 32.8% në vitin 2003. Siç paraqitet në Figurën 3, burimet kryesore të të ardhurave janë ato që mblidhen nga kufiri, rreth 69% të të ardhurave në vitin 2004. Ndërkohë që në krahasim me vitin e mëparshëm, pjesa e taksave të kufirit në të ardhurat gjithsej u ul nga 71.6% në vitin 2003 dhe 88.6% në vitin 2000. Taksat kryesore në taksat e kufirit janë taksat e aksisë dhe TVSH me një pjesë prej 74.7% të taksave gjithsej të kufirit. Në raport me PBB-n nominale në fund të vitit 2004 taksa ishte 29.9% krahasuar me 30.3%, 27.0%, dhe 26.8% në përkatësisht 2003, 2002, dhe 2001.

Të ardhurat e mbledhura në emër të qeverisë qendrore mbeten në një nivel shumë të lartë krahasuar me ato të mbledhura nga qeveria lokale (komunat). Në vitin 2000 nuk kishte mbledhje të të ardhurave në nivel të qeverisë lokale, kështu që, të gjitha të ardhurat mblidheshin nga qeveria lokale. Por, një vit më pas kjo strukturë filloi të ndryshojë; në vitin 2001 qeveria lokale mblodhi 4.6% të të ardhurave gjithsej, 3.9% në 2002, 4.0% në 2003 dhe në vitin 2004 raporti ishte 4.9%.

Rritja e shpenzimeve me 38.6% kryesisht vjen nga rritja në shpenzimet rrjedhëse me 27.6% dhe shpenzimet e kapitalit me 89.6%, ndërsa kontributet e tyre në shpenzimet gjithsej ishin përkatësisht 22.8% dhe 15.8%. Pagat kontribuan në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse me 8.3% ndërsa mallrat dhe shërbimet me 6.8%, transfertat dhe subvencionet me 12.5%. Mallrat dhe shërbimet janë përbërësi kryesor me një pjesë prej 35.5% të shpenzimeve rrjedhëse gjithsej për

vitin 2004. Shpenzimet kapitale u rritën me 89.6% krahasuar me vitin e mëparshëm dhe si pjesë e PBB-s nga 5.4% në 9.6%.

Figura 3: Përbërja e taksave të kufirit
(Shprehur në miliona Euro)



Që prej vitit 2000, kërkesa e brendshme në Kosovë është më e lartë sesa prodhimi i brendshëm, që nënkupton se pothuajse çdo ndryshim në kërkesën e brendshme pasohet nga i njëjti ritëm i importeve. Kjo do të shkaktonte përkeqësimin e mëtejshëm të bilancit të tregtisë dhe llogarisë rrjedhëse. Problemi i defiçitit të dyfishtë është mjaft shqetësues dhe politikat të cilat mund të ndikojnë në të janë të kufizuara.

1.2.3. Sektori Financiar

Edhe pse gjatë periudhës nga viti 2000 në 2003, mjetet e huaja neto (MHN) të korporatave depozituese (KD), tregojnë rritje, ku në vitin 2001 kishte 386.3% rritje, në 2002 u rrit me 10.7%, në 2003 me 7.4%, në vitin 2004 paraqitet një tablo e ndryshme. Për shkak të rënies së depozitave të qeverisë qendrore në KD me rreth 130.4 milionë euro nga njëra anë, dhe rritjes së kërkesave ndaj sektorit privat (korporatat private jo-financiare dhe ekonomitë familjare) me 140.9 milionë euro, kërkesat e brendshme filluan të tregojnë vlera positive duke arritur shumën 161.3 milionë euro në vitin 2004 nga -109.9 milionë euro në vitin 2003. Detyrimet e parasë së gjerë gjithashtu shfaqin një rritje nga 502 milionë Euro në vitin 2003 në 720.2 milionë euro në vitin 2004, rritja e cila është kontribuar 0.4% nga depozitat e transferueshme dhe 43.3% nga depozitat e tjera [të afatizuara].

Tabela 5. Pasqyrë e Korporatave Depozituese
(Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)

	2000	2001	2002	2003	2004
Mjetet e huaja neto	120,524	586,207	649,007	696,982	617,298
Kërkesat ndaj jo-rezidentëve	142,743	607,717	673,613	726,383	687,027
Detyrimet ndaj jo-rezidentëve	22,219	21,509	24,606	29,401	69,729
Kërkesat e brendshme	-2,509	-43,895	-172,094	-109,967	161,270
Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	-5,657	-69,811	-258,592	-342,740	-212,398
Kërkesat ndaj sektorëve të tjerë	3,148	25,916	86,498	232,773	373,668
Detyrimet e parasë së gjerë	106,185	486,765	413,558	501,185	720,198
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë*	106,185	486,765	413,558	501,185	720,198
Depozita të transferueshme	98,572	361,976	285,278	303,721	305,621
Depozita të tjera	7,613	124,788	128,280	197,464	414,577
Depozitat jashtë parasë së gjerë	2,984	13,438	25,113	32,758	3,987
Kapitali aksionar dhe të tjera	11,077	25,162	43,805	61,075	55,561
Zëra të tjerë (neto)	-2,231	16,948	-5,562	-8,003	-1,177

1/ Deri në Maj-'04 përfshin të gjitha korporatat jo-financiare (vetëm për KTD-t);


2/ Deri në Maj-'04 të dhënat për ekonomitë familjare përfshin OJSHEF;

3/ Përfshin fonde të kontribuara nga zotëruesit residentë;

* Ndërsa deri në Maj '04 sektori i mbajtjes së parave përbëhej nga korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare, duke filluar nga Qershori '04 sektori i mbajtjes së parave është shtrirë me pushtetin e përgjithshëm duke përfshijtur pushtetin qendror dhe sektori financiar duke përfshijtur korporatat depozituese. Depozitat që i përkasin parasë së gjerë janë depozita të transferueshme dhe depozita me maturitet fillestar prej 2 ose më pak vitesh, ndërsa më pare nuk aplikoheshin kufiri i maturitetit. Të dyja ndryshimet në përkufizimin e parasë krijojnë një pauzë përkufizuese në seritë kohore.


Kërkesat e KD-ve ndaj jo-rezidentëve, siç paraqitet në tabelën 5, janë shumë më të larta sesa detyrimet ndaj jo-rezidentëve. Kërkesat patën një rënie prej 5.6%, duke kontribuar kështu në uljen e MHN-ve (11.4%) në ndryshim me detyrimet ndaj jo-rezidentëve të cilat u rritën me 137.2% edhe pse nga nivele të ulëta, duke patur kontribut negativ deri në rënien e MHN-ve me 5.8%. Ashtu si në depozitat e viteve të mëparshme, dhe duke filluar nga viti 2003 investimet në letra me vlerë krahas aksioneve, kanë pjesëmarrjen më të lartë në kërkesat ndaj jo-rezidentëve, 91.9% në vitin 2004 ose rritje në krahasim me 89.9% në vitin 2003. Raporti i BPK-s në depozita dhe investime në letra me vlerë krahas aksioneve në vitin 2004 ishte 53.9% dhe 52.7% ndërsa pjesa e mbetur i përket Korporatave të Tjera Depozituese (KTD).

Figura 4: Korporatat Depozituese MHN dhe kërkesat e brendshme
 (Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)




Depozitat e sektorit fiskal ose të qeverisë qendrore në KD nga viti 2000 deri në vitin 2003 patën një rritje të ndjeshme nga viti në vit, duke filluar nga 5.6, 69.8, 258.6, dhe 342.7 milionë euro përkatësisht në vitet 2000, 2001, 2002, dhe 2003. Viti 2004 shfaq lëvizje të ndryshme krahasuar me vitet e mëparshme. Në vitin 2004 depozitat e sektorit fiskal u ulën me 130 milionë euro ose 38% në krahasim me vitin 2003.

Figura 5: Kërkesat e brendshme të korporatave depozituese sipas sektorëve
 (Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)



Ulja në vitin 2004 të depozitave të sektorit fiskal në KD (figura 5) dhe si një rritje 'plotësuese' në kërkesat ndaj sektorëve të tjerë të brendshëm (kreditë ndaj korporatave jo-financiare dhe ekonomive familjare) e zhvendosën sektorin financiar nga pozicioni i detyrimit neto në pozicionin e kërkesës neto. Kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorëve të tjerë të brendshëm u rritën në mënyrë të ndjeshme që prej vitit 2000 ndërkohë që në fund të vitit 2004 ato u llogaritën në 373.6 milionë euro. Përsa i përket strukturës së kredive, ato iu jepen korporatave jo-financiare dhe ekonomive familjare. Kështu, në fund të vitit 2004, korporatat e tjera jo-financiare u llogaritën në 290 milionë euro ose 77.6% krahasuar me 83.3%, 91.8% në përkatësisht 2003, dhe 2002. Nga kjo luhajte, ne mund të vërejmë se kreditë e dhëna ndaj ekonomive familjare paraqesin një tendencë të konsiderueshme në rritje. E gjithë shuma prej 373.6 milionë euro paraqet huatë e dhëna nga KTD-t. (bankat komerciale).⁸

Figura 6: Agregatët monetarë dhe koeficienti i parasë
(Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)



Agregati monetar M2 (M1+depozita të tjera) siç tregohet në figurën 6, tregon një rritje prej 12.1% krahasuar me vitin 2003 dhe në vitin 2004 ai qëndronte në 1.155 miliardë euro. Gjatë vitit 2004 u shënuar një rritje e depozitave të tjera (të afatizuara dhe të kursimit) me 109%, duke kontribuar në rritjen e M2 me 21.1%. Nga ana tjetër, agregati monetar M1 pësoi një rënie nga 832.7 milionë euro në vitin 2003 në 740.6 milionë euro në vitin 2004, duke kontribuar me -8.9% në M2 e përgjithshme. Valuta jashtë korporatave depozituese (sipas vlerësimeve të stafit të FMN-s) si një nga përbërësit e M1 paraqet rënie nga 529 milionë euro në vitin 2003 në 435 milionë euro në vitin 2004 duke kontribuar me -11.3% në M1. Pjesa e depozitave të

⁸ Për më tepër të dhëna shiko "Zhvillimet në sektorin bankar".

transferueshme në M1 ishte 41.3% ose një rritje nga 36.4% në vitin 2003 duke vërtetuar që ka një zhvendosje në M1 valuta jashtë bankave në depozitat e transferueshme.

Raporti i valutës jashtë korporatave depozituese ndaj detyrimeve të parasë së gjerë në fund të vitit 2004 pati një rënie në 60.4%. Raporti paraqet një rënie të ndjeshme krahasuar me vitet 2000, 2001, 2002, dhe 2003 me nga përkatësisht 599.9%, 137.2%, 142.4%, dhe 105.5%. Kjo tendencë vjen nga rënia e valutës jashtë korporatave depozituese 637 milionë euro në vitin 2000 në 435 milionë euro në vitin 2004, dhe rritja në detyrimet e parasë së gjerë nga 106 milionë euro në vitin 2000 në 720 milionë euro në vitin 2004. Luhajtjet e paraqitura më lart theksojnë që ekonomia e Kosovës është në një proces transformimi nga ekonomia e parave të gatshme në ekonomi me para jo të gatshme. Nëse në vitin 2000 në banka kishte një euro, gjashtë euro ishin jashtë sistemit bankar, në të kundërtën në vitin 2004 nëse në banka kishte një euro, vetëm 0,6 euro gjendeshin jashtë bankave. Për shkak të besimit të rritur në KTD-t (bankat komerciale) operacionet në Kosovë pasuan një rritje të ndjeshme në depozitat në bankat komerciale, gjatë periudhës 2000-2004 kishte një rënie të vazhdueshme në paranë e gjerë ndaj raportit të PBB-s, ndërkohë që në fund të vitit 2004 ajo qëndronte në 62.6%.

1.2.3.1. Zhvillimet në sektorin bankar

Në fund të vitit 2004, sektori bankar në Kosovë përbëhej nga shtatë banka komerciale: ProCredit Bank (PCB), Raiffeisen Bank e Kosovës (RBKO), Banka e Re e Kosovës (BRK), Banka për Biznes Privat (BPB), Banka Ekonomike (BE), Kasa Bank (KSB) dhe Banka Kreditore e Prishtinës (BKP). Edhe pse gjatë periudhës 2002-2004 asnjë bankë të re nuk iu dha licensë nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), bankat në Kosovë kanë zgjeruar rrjetin e tyre të punës përmes degëve të tyre, shoqëruar me një shtrirje të madhe të shërbimeve. Në mënyrë të ngjashme, struktura e pronësisë së bankave nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të ndjeshëm, ku që prej fundit të vitit 2001 vetëm dy banka kanë patur pjesën më të madhe të pronësisë së huaj dhe pesë banka me pjesën më të madhe pronësi të brendshme.

Në fund të vitit 2004 ka patur 217 njësi bankare që operojnë në Kosovë, të cilat krahasuar me vitin 2003 u rritën në numër me 60 njësi. Rritja në numrin e njësive bankare që operojnë në Kosovë u shoqërua me rritje në punësim nga ana e bankave komerciale, të cilat në fund të vitit 2004 u llogaritën në 2,068 punonjës me kohë të plotë.


Gjatë vitit 2004, bankat në Kosovë kanë përmirësuar rrjetin e tyre bankar të punës duke vënë në përdorim teknologjinë më të re. Vendosja e teknologjisë së re ka mundësuar bankat që të rrisin sigurinë në dhënien e shërbimeve, zgjerojnë gamën e produkteve që ato japin dhe shkurtojnë shpenzimet e përgjithshme. Për më tepër, teknologjia e re i ka mundësuar klientët që t'i përdorin shërbimet bankare drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24 orëve. Deri në Dhjetor

2004, numri i bankomateve në sektorin bankar arriti në 43. Duke ndjekur tendencën e zhvillimit botëror bankar, si edhe tendencën ndryshe të popullsisë në Kosovë drejt përdorimit të shërbimeve bankare, bankat iu kanë dhënë klientëve të tyre shërbime të reja si p.sh. kartat e kreditit dhe të borxhit, siç janë Visa dhe MasterCard.

Mjetet gjithsej të sektorit bankar të zotëruara nga një punonjës arritën në shumën 385,789 euro, e cila është një rritje prej 10.9 % krahasuar me fundin e vitit 2003. Duke llogaritur produktivitetin sipas numrit të punonjësve për njësi bankare, ne marrim tendencat e njëjta ndaj ndryshimeve në produktivitet të llogaritura sipas mjeteve të përdorura nga një punonjës. Për rrjedhojë, numri i punonjësve për degë tregon rënie në numrin e punonjësve për njësi operative me 12.5 % në vitin 2004 krahasuar me vitin 2003.

Sipas grafikut dhënë nga Indeksi i Herfindahl-Hirschman (IHH), përqëndrimi i sektorit bankar në Kosovë në vitin 2004 ka pësuar rënie. Vlera e IHH-s ka rënë në fund të vitit 2004 në 2,536 pikë nga 2,803 pikë në fund të vitit 2003, ndërkohë që ka pësuar rënie me 1,255 pikë krahasuar me vitin 2002. Përveç kësaj, në tregun e depozitave u vërejt edhe rënia në indeks dhe rritja e konkurrencës. Vlera e IHH-s në vitin 2004 u ul me 621 pikë krahasuar me fundin e vitit 2003 dhe mbeti në 2,625 pikë. Kjo tendencë në zhvillimin e nivelit të përqëndrimit në sektorin bankar mund të jetë rezultati i rritjes së konkurrencës në mbledhjen e depozitave duke i detyruar bankat që të operojnë në një mjedis më konkurrent. Gjithashtu, ndikimi i depozituesve të mëdhenj, të cilët përqëndrohen vetëm në pak banka, mund të jetë arsyeja për një vlerë më të lartë të IHH-s në depozita. Ndërkohë, siç paraqet edhe Figura 7, përqëndrimi i kredive pësuan një rritje të lehtë gjatë vitit 2004 në 2,053 pikë nga 1,877 pikë në fund të vitit 2003. Këto zhvillime në nivelet e përqëndrimit tregojnë se sektori bankar është më konkurrent në dhënie të kredive sesa në marrjen e depozitave.

Figure 7: Indeksi Herfindahl-Hirschman (të gjitha bankat)




Duke llogaritur nivelin e konkurrencës së sektorit bankar në Kosovë sipas pjesës në treg të tri bankave më të mëdhaja (C3), marrim të njëjtat tendenca me zhvillimet e përqendrimit llogaritur sipas IHH-s. Për rrjedhojë, përsa u përket mjeteve dhe depozitave, C3 brenda tregut të brendshëm bankar është duke rënë gradualisht. Në fund të vitit 2004, përqendrimi i pjesës më të madhe të bankave llogaritur si një pjesëmarrje e kombinuar e tri bankave në mjetet gjithsej të sektorit bankar pësuan një ulje. Në veçanti, në fund të vitit 2004 mjetet e tri bankave më të mëdha në mjetet gjithsej ranë me 0.5 përqind dhe arritën në 74.0% të mjeteve gjithsej të sektorit bankar, ndërsa depozitat bankave më të mëdha ndaj depozitave gjithsej pësuan një rënie prej 0.4 përqind krahasuar me vitin 2003 (75.0%) dhe u llogaritën në 74.4% të depozitave gjithsej të sektorit bankar. Përsa u përket kredive, në fund të vitit 2004 tri bankat më të mëdha rritën pjesëmarrjen e tyre në kreditë gjithsej të sektorit bankar duke u llogaritur në 71.0% të kredive gjithsej ose më shumë se 4.0 përqind krahasuar me vitin 2003.

1.2.3.2. Struktura e Mjeteve të Sektorit Bankar në Kosovë

Mjetet gjithsej të sektorit bankar në fund të vitit 2004 ishin 797.0 milionë euro, një rritje prej 215.5 milionë euro krahasuar me fundin e vitit 2003. Siç paraqitet në Figurën 8, mjetet gjithsej që prej vitit 2001 kanë pësuar një tendencë në rritje . Në vitin 2002, mjetet gjithsej të sektorit bankar duken të jenë ngadalësuar përsa i përket rritjes përkatëse prej 9.2% krahasuar me vitin 2001. Megjithatë, ato u rritën sërish në vitin 2003 duke u rritur me 23.4% krahasuar me vitin 2002. Në mënyrë të ngjashme, mjetet gjithsej u rritën me 37.1% në vitin 2004 krahasuar me fundin e vitit 2003. Mjetet e sektorit bankar kanë patur gjithashtu një rritje të qëndrueshme përsa i përket pjesës së tyre ndaj PBB-s. Sipas vlerësimeve të PBB-s dhënë nga FMN-ja, në fund të vitit 2003, mjetet gjithsej të sektorit bankar arrinin në 39.0% të PBB-s ndërsa në fund të vitit ato u rritën në 42.0%.

Figura 8 : Struktura e mjeteve të sektorit bankar në Kosovë, në '000 Euro




Për shkak të pjesës së konsiderueshme në mjetet gjithsej të sektorit bankar (37.3 %), plasmanet jashtë dhe investimet në letrat me vlerë u rritën me 31.8% në vitin 2004 krahasuar me vitin 2003. Megjithatë, gjatë periudhës 2001-2004 ato pësuan një tendencë të parregullt, duke shënuar një rritje relative prej 32.9% në vitin 2002 krahasuar me vitin 2001, ndërsa në vitin 2003 ato ranë me 22.8% krahasuar me vitin 2002 kur ato ishin 292.7 milionë euro. Duke përbërë 14.0% të mjeteve gjithsej, letrat me vlerë jashtë kanë rënë me 6.6% në vitin 2004 krahasuar me vitin 2003, llogaritur në 111.8 milionë euro, ndërsa plasmanet jashtë pësuan një rritje relative prej 75.0% në vitin 2004 dhe u llogaritën në 23.3% të bilancit të gjendjes gjithsej.

Kreditë, si një pjesë themelore e mjeteve gjithsej të sektorit bankar, duken të jenë rritur gjatë periudhës nën shqyrtim. Duke përfaqësuar 18.4% të mjeteve gjithsej në vitin 2002, kreditë bruto u rritën me 169.1% në vitin 2003 duke u rritur pjesëmarrjen gjithsej në 40.0%. Për më tepër, në vitin 2004 rritja relative e kredive ka qenë paksa e ngadalshme duke u rritur me 60.5% krahasuar me vitin 2003. Megjithatë, në vitin 2004 kreditë u llogaritën 46.8% të mjeteve gjithsej me 373.7 milionë euro më shumë nga 232.7 milionë euro në vitin 2003. Kreditë gjithashtu kanë pësuar rritje përsa i përket pjesës së tyre në PBB, duke qenë se në fund të vitit 2004 kreditë u rritën me 19.7% të PBB-s nga 12.9% në vitin 2003.

Përsa u përket normave të interesit të kreditive, normat e kredive dhënë korporatave jo-financiare shfaqen më të larta sesa normat e interesit të kredive ndaj ekonomive familjare. Në veçanti, normat e kredive të investimit të biznesit afatgjatë dhënë korporatave jo-financiare ishin 14.3%, ndërsa kreditë e tjera me afat më të gjatë mbetën 15.9%. Nga ana tjetër, normat e interesit të kredive konsumatore në fund të Dhjetorit 2004 ishin 12.3%.

Struktura e industrisë së kredive është në përpjesëtim me strukturën e industrisë së ekonomisë së Kosovës, ku industria e tregtisë ka një pozitë mbizotëruese. Kreditë dhënë tregtisë përfaqësojnë pjesën më domethënëse të kredive të dhëna gjithsej. Në vitin 2002, ato u llogaritën në 59.3% të kredive gjithsej, e cila është 3.9 përqind rritje krahasuar me vitin 2001. Kreditë e dhëna tregtisë ranë në 49.3% të kredive gjithsej kur ato llogariteshin në 114.7 milionë euro ndërsa rritja e tyre relative u ngadalësua lehtë pasi në vitin 2004 ranë në 48,2 % të kredive gjithsej.


Figura 9: Struktura e industrisë së kredive të sektorit bankar në Kosovë, në %



Duke ndjekur këtë rritje, siç paraqitet në Figurën 9, kreditë u ndanë në sektorin e industrisë përpunuese duke përfaqësuar 8.1% të kredive gjithsej në vitin 2003 ndërsa në fund të vitit 2004 ato u llogaritën në 9.6% të kredive të dhëna gjithsej. Zhvendosje e theksuar e kredive u vërejt gjithashtu në kreditë dhënë sektorit bujqësor, i cili në fund të vitit 2004 arriti në 2.1% të kredive gjithsej edhe pse ato ende mbeten të papërfillshme krahasuar me kreditë dhënë sektorëve të tjerë.

Përsa i përket strukturës kohore të kredive, Figura 10 paraqet një zhvendosje të theksuar drejt kredive më afatgjata. Gjatë vitit 2004, bankat pësuan një ngadalësim në rritjen relative të kredive me maturitet deri në një vit e cila u rrit me 25.1% dhe në fund të vitit 2004 përfaqësuan 45.3% të kredive gjithsej, ose 12.7 përqind më pak krahasuar me fundin e vitit 2003.

Figura 10: Struktura e maturitetit të kredive të sektorit bankar në Kosovë, në %




Për më tepër, u shënua një ndryshim i madh relativ për kreditë me maturitet më shumë se një vit, të cilat në fund të vitit 2004 u rritën me 110.7% krahasuar me vitin 2003 dhe llogariteshin 54.7% të kredive gjithsej. Përveç kësaj, kreditë me maturitet më shumë se një vit kanë pësuar rritje në kreditë gjithsej me 13.0 përqind, ndërkohë që në fund të vitit 2003 ato llogariteshin në 41.4% të kredive gjithsej. Krahas rritjes së rolit të ndërmjetësimit të bankave, struktura e maturitetit të kredive dhënë ekonomisë është përmirësuar gjithashtu.

1.2.3.3. Struktura e Detyrimeve të Sektorit Bankar në Kosovë

Rritja e përshpejtuar e kredive u shoqërua me rritje të depozitave të cilat në fund të vitit 2004 llogariteshin në 692.3 milionë euro ose 34.7% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2003 (Figura 11). Gjatë periudhës 2001-2004 depozitat pësuan ndryshime të mëdha në rritjen e tyre relative. Në vitin 2002 ato ranë me 13.2% ndërsa në vitin 2003 ato patën një përmirësim duke u rritur me 20.3% dhe llogariteshin në 515.8 milionë euro.

Figura 11: Struktura e detyrimeve dhe kapitali i aksionarëve të sektorit bankar në Kosovë, në %




Përsa i përket normave të interesit mbi depozita, normat mbi depozitat me afat maturiteti më të shkurtër – dmth depozita me më pak se 250,000 Euro në më pak se një muaj, nga një deri në tri muaj, dhe nga tri muaj deri në një vit – qëndronin në përkatësisht 1.7%, 2.2%, dhe 2.9%. Nga ana tjetër normat e interesit mbi depozitat me maturitet më afatgjatë – më shumë se dy vite – ishin rreth 4.0% në fund të vitit 2004.

Gjatë viteve 2001-2004, struktura e depozitave ka pësuar disa ndryshime. Në vitin 2002, depozitat e transferueshme pësuan një rënie (19.1%) në rritjen e tyre por patën një përmirësim në vitin 2003 duke arritur në 43.9% nga 31.3% të depozitave gjithsej në vitin 2002. Duke ndjekur

këtë tendencë, në vitin 2004, depozitat e transferueshme u rritën me 8.9 përqind dhe llogariteshin 52.8% të depozitave gjithsej (Figura 12).


Nga ana tjetër, depozitat e tjera (depozitat e afatizuara dhe të kursimit) ranë me 0.2% në vitin 2003 krahasuar me vitin 2002 dhe përfaqësonin 56.1% të depozitave gjithsej. Në vitin 2004, ato përjetuan një përmirësim në rritjen e tyre relative duke u rritur me 13.9% duke u llogaritur në 47.2% të depozitave gjithsej. Kjo rritje ishte kryesisht për shkak të rritjes në depozitat e korporatave jo-financiare, të cilat në fund të vitit 2004 u rritën me 116.3% ndërkohë që depozitat e ekonomive familjare u rritën me 66.7% krahasuar me vitin 2003.

Figura 12: Stuktura e maturitetit të depozitave të sektorit bankar në Kosovë, në '000 Euro



Përsa i përket llojit të strukturës depozituese të depozitave, ekonomitë familjare mbajnë pozicionin mbizotërues, ku në fund të vitit 2004 përfaqësuan një shifër të qëndrueshme prej 53.4% të depozitave gjithsej. Në vitin 2002, depozitat e ekonomive familjare pësuan një rënie në normën e tyre të rritjes me 28.3%. Megjithatë, që prej asaj kohe, ekonomia familjare shënoi një rritje relative prej 20.2% në vitin 2003 krahasuar me vitin 2002 dhe vazhdoi me të njëjtin ritëm në vitin 2004 gjithashtu, kur u llogarit në 370.9 milionë Euro (Figura 13).

Figura 13: Struktura depozituese e depozitave të sektorit bankar në Kosovë, në '000 Euro




Nga ana tjetër, pjesa kryesore e zvogëlimit të pjesës së depozitave të ekonomive familjare ndaj depozitave gjithsej ka qenë një rritje e përsheptuar e depozitave të korporatave jo-financiare, të cilat në fund të vitit 2002 u rritën me 14.8% duke arritur në 45.7% të depozitave gjithsej. Ato vazhduan me të njëjtën rritje relative në vitin 2003 gjithashtu, duke u rritur me 24.7%, për rrjedhojë duke arritur në 46.7% të depozitave gjithsej. Në vitin 2004 ato u llogaritën 46.6% të depozitave gjithsej duke përjetuar ndryshimin më të madh relativ (35.3%) gjatë periudhës së viteve 2001-2004. Në fund të vitit 2004, depozitat e marra nga ndërmarrjet publike u llogaritën në 21.9% të depozitave të marra gjithsej, ndërsa korporatat e tjera jo-financiare (ndërmarrjet në pronësi private ose shoqërore) u llogaritën në 18.4% të depozitave gjithsej.

1.2.3.4. Struktura e Kapitalit të Sektorit Bankar në Kosovë

Figura 14 paraqet zhvillimet në strukturën e kapitalit të sektorit bankar në Kosovë. Në fund të vitit 2004 kapitali gjithsej i sektorit bankar arriti në 68.1 milionë Euro, një rritje prej 51.4% krahasuar me vitin 2003 kur ai ishte në 45.0 milionë Euro. Kapitali aksioner, duke qenë përbërësi kryesor i kapitalit gjithsej të sektorit bankar, mbajti pozicionin e tij mbizotërues me rreth 90.0% të strukturës gjithsej të kapitalit për katër vite. Ndryshimi më i theksuar relativ u përjetua në vitin 2002 kur kapitali aksioner u rrit me 66.6 % duke arritur raportin më të madh ndonjëherë prej 97.9% të kapitalit gjithsej, dhe kështu kontribuoi në rritjen e kapitalit bankar me 62.7%.

U shënuan gjithashtu luhatje për rritjen relative të fitimit të mbajtur, i cili në vitin 2002 u rrit me 24.9%, ndërsa në fund të vitit 2004 u llogarit me 9.1% të kapitalit gjithsej.


Figura 14: Struktura e kapitalit të sektorit bankar në Kosovë, në '000 EUR



Duke vlerësuar kapitalizimin e bankave, Figura 15 tregon se bankat janë të kapitalizuara në mënyrë të mjaftueshme. Raporti mesatar i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullator gjithsej

kundrejt mjeteve të peshuara ndaj rrezikut) në fund të vitit 2003 ishte 17.1%, një rënie në 23.9% nga 22.5% në vitin 2002. Ky raport u ul vazhdimisht për periudhën 2000-2003 ku në vitin 2000 ishte 23.0% ndërsa në vitin 2001 arriti raportin më të lartë ndonjëherë prej 32.1%. Në fund të vitit 2004, raporti mbeti në 16.7% duke treguar rënie prej 2.3% krahasuar me vitin 2003.

Figura 15: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit



Shkaku i kësaj tendence në rënie është rritja e kredive dhënë sektorit privat në portofolin bankar të kredive, e cila ka kontribuar në rritjen më të shpejtë të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut krahasuar me rritjen e kapitalit rregullator.

1.2.3.5. Performanca e sektorit bankar

Sipas rezultateve operative të bankave, ato e përfunduan vitin financiar 2004 me fitim para-taksor në shumën 15.1 milionë Euro dhe fitim pas-taksor prej 12.9 milionë Euro (Tabela 6). Në krahasim me vitin e mëparshëm, fitimi pas-taksor u rrit me 90.5% në terma nominale ose 6.2 milionë Euro më shumë sesa fundi i vitit 2003. Megjithatë, fitimi pas-taksor pësoi një tendencë të lehtë rritjeje në vitin 2004 pasi u rrit me 150.4 % në terma nominale në vitin 2003 krahasuar me vitin 2002 ndërsa rritja e tij u ngadalësua në vitin 2004.

Tabela 6. Struktura e Pasqyrës së të Ardhurave të Sektorit Bankar në Kosovë

PASQYRA E SË ARDHURAVE	2001	2002		2003		2004	
	Shuma	Shuma	Ndryshimi në %	Shuma	Ndryshimi në %	Shuma	Ndryshimi në %
Të ardhurat e interesit	7,179	17,818	148.2	30,693	72.3	53,999	75.9
Kreditë	2,150	9,373	336.0	23,780	153.7	48,110	102.3
Plasmanet me bankat	5,029	8,257	64.2	6,090	(26.2)	2,452	(59.7)
Letrat me vlerë	-	188	-	823	337.8	3,437	317.6
Të ardhurat e jo-interesit	9,402	14,034	49.3	17,984	28.1	19,449	8.1
Tarifat dhe komisionet	9,212	13,194	43.2	16,750	27.0	17,522	4.6
Të ardhurat e tjera operative	190	840	342.8	1,234	46.9	1,927	56.2
TË ARDHURA GJITHSEJ	16,581	31,852	92.1	48,677	52.8	73,448	50.9
Shpenzimet e interesit	1,312	3,470	164.4	5,279	52.1	9,978	89.0
Depozita	855	3,102	262.9	4,782	54.2	9,237	93.2
Huamarrje	458	368	(19.6)	497	35.1	741	49.1
Shpenzimet e jo-interesit	1,507	5,792	284.4	10,223	76.5	14,939	46.1
Provizioni për humbjet në kreditë	616	3,282	433.1	7,720	135.2	11,071	43.4
Zhvlerësimi i mjeteve fikse	891	2,510	181.6	2,503	(0.3)	3,868	54.5
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	7,271	19,130	163.1	25,379	32.7	33,952	33.8
SHPENZIME GJITHSEJ	10,090	28,392	181.4	40,881	44.0	58,869	44.0
Të ardhurat operative neto përpara provizioneve për taksë	6,491	3,460	(46.7)	7,798	125.4	14,579	87.0
Të ardhurat nga veprimtaritë bankare	681	562	(17.4)	915	62.8	480	(47.5)
Taksa mbi të ardhurat	456	1,306	186.7	1,912	46.4	2,104	10.0
Fitimi/humbja pas-taksës	6,716	2,716	(59.6)	6,801	150.4	12,955	90.5

Kjo tendencë në rezultatet operative të bankave u ndikua kryesisht nga rritja e të ardhurave të interesit, të cilat në fund të vitit 2004 u llogaritën 54.0 milionë Euro ose 75.9% më shumë në terma nominale krahasuar me vitin 2003. Të ardhurat e interesit nga kreditë kontribuan me rritje relative prej 102.3% në fund të vitit 2004 ndërkohë që interesi i përfutur nga depozitat në banka kontribuoi negativisht në këtë rritje ku ra me 59.7 % në terma nominalë dhe u llogarit në 2.5 milionë Euro më pak krahasuar me fundin e vitit 2003.

Plotësuesi kryesor i rritjes në të ardhurat e interesit ishte një ngadalësim në rritjen e të ardhurave jo të interesit, të cilat në fund të vitit 2004 pësuan një rritje relative prej 8.1% krahasuar me vitin 2003 kur ato u rritën me 28.1%. Arsyeja pas kësaj rritjeje të lehtë në të ardhurat jo të interesit ishte ngadalësimi në normat e rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet dhe rritja e lehtë shoqëruese e të ardhurave të tjera operative.


Përsa u përket shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave të bankave, ndryshimet e theksuara u vërejtën nga shpenzimet e interesit, me shpenzime të interesit në depozita që u rritën me 93.2% krahasuar me vitin 2003 të cilat në fund të vitit 2004 u llogaritën në 10.0 milionë Euro. Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit në huamarrje u rritën me 49.1% ndërkohë që u llogaritën me një pjesë të papërfillshme në shpenzimet gjithsej të interesit.

Ndryshimet relative në shpenzimet e jo-interesit duken të jenë ngadalësuar, pasi në fund të vitit 2004 ato u rritën me 46.1% në terma nominale krahasuar me vitin 2003 kur ato përjetuan një rritje relative prej 76.5%. Kjo tendencë e lehtë në rritjen e normave të shpenzimeve të jo-interesit u shkaktua kryesisht nga ngadalësimi në rritjen relative të provizionit për humbje kredie (43.4%) të cilat në vitin 2003 u rritën me 135.2% krahasuar me vitin 2002. Për më tepër, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative u rritën me një normë të pandërprerë prej 33.8% në fund të vitit 2004 dhe u llogaritën në 33.9 milionë Euro.

Treguesit bazë të performancës së sektorit bankar paraqesin një tablo të favorshme për fundin e vitit 2004. Figura 16 paraqet zhvillimet e këtyre treguesve për sektorin bankar në përgjithësi gjatë periudhës 2001-2004. Raporti i kthimit në kapital mesatar të sektorit bankar (KNMM) ka ndjekur një tendencë në rritje që prej vitit 2002. Siç u përmend edhe më lart, rezultatet e favorshme në rezultatet operative të sektorit bankar kanë kontribuar në një masë të lartë në rritjen e këtij raporti. Në vitin 2002 raporti ra në 9.9% nga 22.9% në vitin 2001. Megjithatë, që prej asaj kohe, raporti ndoqi një tendencë në rritje, pasi në vitin 2003 arriti në 17.3% ndërsa në fund të vitit 2004 llogaritej në 21.7%.

Në mënyrë të ngjashme, raporti i Kthimit në Mjetet Mesatare (KNMM) shfaq pozicion të favorshëm të performancës së sektorit bankar. Duke llogaritur performancën e sektorit bankar sipas raportit KNMM, tendencat janë të njëjtat me ndryshimet në performancën e llogaritur nga KNKM. KNMM ishte më e ulët në vitin 2002 ku qëndroi në 0.6%. Që prej asaj kohe, pati vazhdimisht rritje dhe në vitin 2003 ishte gjithsej 1.3%, ndërsa në vitin 2004 shënoi nivelin më të lartë për periudhën 2001-2004 me mesatarisht 1.9%.


Figura 16: Treguesit e Kthimit dhe të Efektshmërisë



Efektshmëria e ndërmjetësimit dhe treguesit e kostos së jo-efektshmërisë kanë shfaqur gjithashtu përmirësime. Në veçanti, krahasuar me fundin e vitit 2003, treguesi i Marxhines së Interesit Neto (MIN) pasqyron një rritje nga 4.4% në 5.5% në fund të vitit 2004. Nga ana tjetër, siç tregon edhe Figura 16, treguesi i kostos së jo-efektshmërisë pësoi një rënie të lehtë në vitin 2004 në 4.7% krahasuar me vitin 2003 kur arriti në 4.8%, pas një ngadalësimi në rritjen e tij që prej vitit 2001.

Në përgjithësi, sektori bankar në Kosovë mbetet likuid. Bazuar në tablonë paraqitur në Figurën 17, pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar në Kosovë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme që prej vitit 2001. Raporti i kredive dhënë depozitave të marra është rritur në vitin 2002 në 20.2% nga 5.3% në vitin 2001. Duke ndjekur këtë tendencë në rritje, raporti u rrit përkatësisht në 47.9% nga 53.6% në vitin 2003 dhe 2004. Siç paraqitet në figurë, tendenca në rritje filloi të zbutet në vitin 2004, e cila mund të jetë ndikuar rritja më e shpejtë në normën e rritjes së depozitave krahasuar me normat e rritjes së kredive të dhëna të cilat u ngadalësuan në fund të vitit 2004.

Figura 17: Treguesit e Likuiditetit



Nga ana tjetër, raporti i mjeteve likuide ndaj mjeteve gjithsej kanë pësuar një rënie të vazhdueshme që prej vitit 2001. Në vitin 2002, raporti ra në 79.4% nga 93.5%, ndërkohë që në vitin 2003 mbeti në 57.1%. Megjithatë, që prej asaj kohe, raporti ka mbetur i qëndrueshëm dhe llogaritej gjithsej në 51.9% në fund të vitit 2004.

1.2.4. Sektori i Jashtëm

Në fund të vitit 2004 llogaria rrjedhëse përpara granteve shënonte një deficit prej 947.9 milionë Euro ose 50% të PBB-s nominale. Krahasuar me periudhat e mëparshme ka një rënie të ndjeshme të deficitit të llogarisë rrjedhëse përpara asistencës së huaj si përqindje e PBB-s. Përkatesisht, raporti korrespondon në -133.8%, -79.0%, -63.6%, -56.5%, dhe 50.0% në 2000, 2001, 2002, 2003, dhe 2004. Ndërsa bilanci i llogarisë rrjedhëse pas granteve shënoi një deficit prej 17.1% të PBB-s. Siç paraqitet në tabelën 7 të ardhurat e huaja (paratë e dërguara dhe asistenca e huaj) kanë pjesën më të madhe, edhe pse ka një tendencë në rënie. Shprehur më qartë, së bashku ato u llogaritën në 868.5 milionë Euro ose 45.8% të PBB-s në fund të vitit 2004.

Tabela 7. Bilanci i Pagesave

(Shprehur në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)


	2000	2001	2002	2003	2004
Bilanci i mallrave dhe shërbimeve	-1,829.4	-1,686.2	-1,492.8	-1,379.3	-1,298.5
(në përqindje të PBB-s)	-172.1	-103.7	-86.0	-76.8	-68.5
Bilanci tregtar	-1,178.8	-961.5	-870.6	-855.9	-845.4
Eksportet	253.4	269.0	217.4	186.1	189.5
Prej të cilave: eksporte të rregullta	2.5	23.0	27.0	36.2	50.7
Importe	1,432.2	1,230.5	1,087.9	1,042.0	1,034.9
Importe të donatorëve	380.5	212.6	124.4	98.9	85.7
Prej të cilave: të importuara drejtpërdrejtë	380.5	189.6	90.4	25.5	0.0
Importet e Asistencës humanitare	35.6	18.2	9.0	5.0	0.0
Importe të tjera	1,016.1	999.7	954.5	938.1	949.2
Importet komerciale	983.2	991.6	952.5	968.9	989.6
Shërbimet jo-faktor	-650.6	-724.7	-622.2	-523.4	-453.1
Pagesat	650.6	724.7	622.2	523.4	453.1
Donatore	601.3	675.8	575.6	477.7	406.8
Jo-donatore	49.4	48.9	46.6	45.8	46.3
Faktori i të ardhurave	407.3	402.4	390.0	363.9	350.6
Paratë e dërguara nga punëtorët jashtë	222.0	217.0	241.4	241.4	244.5
Pagat e punonjësve vendorë	185.3	185.4	148.6	122.5	106.1
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (përpara asistencës së huaj)	-1,422.1	-1,283.9	-1,102.8	-1,015.5	-947.9
(në përqindje të PBB-s)	-133.8	-79.0	-63.6	-56.5	-50.0
Asistenca e huaj	1,229.1	1,144.0	901.9	731.7	624.0
Llogaria rrjedhëse (pas asistencës së huaj)	-193.0	-139.9	-200.9	-283.8	-323.9
(në përqindje të PBB-s)	-18.16	-8.607	-11.58	-15.79	-17.1
Gabimet dhe heqjet	-226.0	-223.5	-221.8	-57.0	11.1
	419.0	363.4	422.7	340.8	312.9

Burimi: Vlerësimet e FMN-s.

Në fund të vitit 2004 bilanci tregtar arriti në -845 milionë Euro e cila është një rënie nga -1.179 milionë Euro në vitin 2000 ku llogaritej në 110.9% të PBB-s nominale të vitit 2002. Duke marrë parasysh praninë e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë dhe aktivitetin e tyre, ne mund të nënvizojmë llojet e bilancit tregtar. Kështu, duke përfshirë të gjitha importet dhe eksportet (të bëra nga të gjitha institucionet) gjatë vitit 2004, raporti i importeve ndaj eksporteve arriti në 18.3% (figura 18) ndërsa duke e përjashtuar atë, dhe llogaritur vetëm bilancin ndërmjet importeve dhe eksporteve komerciale raporti qëndronte në 5.1%. Siç paraqitet në figurën 18, ka një tendencë të kundërt të këtyre dy kategorive. Duke filluar nga viti 2001 dhe duke u llogaritur 21.9%, ka një rënie të bilancit të përgjithshëm tregtar deri në vitin 2003, me 1.9, dhe 2.1 përqind përkatësisht në vitet 2002 dhe 2003, ndjekur nga një rritje e lehtë në vitin 2004. Me kontribut 0.5% dhe 0.8% të eksporteve dhe importeve, në fund të vitit 2004 bilanci tregtar u llogarit -845 milionë Euro, 44.6% të PBB-s.

Figura 18: Raporti i Eksporteve ndaj Importeve

(Në përqindje)




Importet gjithsej në Kosovë gjatë vitit 2004 u llogaritën në 1.1 miliardë Euro, e cila është një rritje krahasuar me vitin 2003 me 9.2%, 2002 me 24.4%, dhe 2001 me 55.3%. Bashkimi Evropian ende mbetet partneri kryesor tregtar me 26.7% të importeve gjithsej në Kosovë. Në fund të vitit 2004 importet nga Bashkimi Evropian arritën në 284 milionë Euro, një rritje me 17.3% krahasuar me vitin e mëparshëm. Brenda Bashkimit Evropian gjenden Gjermania, Italia dhe Greqia me 67.3% të importeve gjithsej nga Bashkimi Evropian ose llogaritur në 191.2 milionë Euro.

Përsa u përket shteteve jashtë Bashkimit Evropian, Maqedonia është eksportuesi më i madh për Kosovën. Në fund të vitit 2004 importet nga ky vend arritën në 149.2 milionë Euro ose 14% të

importeve gjithsej, raport pothuajse i njëjtë për vitin 2003 pasuar nga Turqia, SMZ, Bullgaria, dhe Kina me përkatësisht 8.1%, 6.8%, 3.9%, 3.2%. Ndërkohë që vendet e tjera kanë një përqindje më të vogël.


Figura 19: Importet e Kosovës me Partnerët Tregtarë në vitin 2004, në miliona Euro.



Lidhur me strukturën e importeve sipas grupit të mallrave, ka patur një zhvendosje ndërmjet produkteve minerale dhe ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit. Në fund të vitit 2004 produktet minerale përbënin 173.1 milionë Euro ose 16.2% të importeve gjithsej. Ato patën një rritje në vëllim nga 138.6 milionë Euro në vitin 2003, dhe gjithashtu në raport me importet në vitin 2003 gjithsej u rritën 14.2%. Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani në fund të vitit 2004 përfaqësonin 165.4 milionë Euro të importeve krahasuar me 203.5 milionë Euro në vitin 2003. Si kategori e tretë e importeve sipas grupit të mallrave janë makineritë, veglat, pajisjet elektrike të shprehura në 116.8 milionë Euro ose 10.9% të importeve gjithsej, të cilat në krahasim me vitin 2003 tregojnë një rritje prej 10.7%.


Në fund të vitit 2004 eksportet e Kosovës shënuan 56.5 milionë Euro në krahasim me 35.6, 27.6, dhe 10.6 milionë në 2003, 2002, dhe 2001. Eksportet e Kosovës janë shuma e konsumit vendor të emigrantëve dhe eksporteve të rregullta. Pavarësisht nga tendenca në rënie, konsumi vendor i emigrantëve llogaritet në rreth 73% të eksporteve gjithsej në vitin 2004 nga rreth 98% në vitin 2000.

Figura 20: Përbërja e Eksporteve
(Në miliona Euro)



Njësoj si me importet, vendet e Bashkimit Evropian përvetësojnë rreth 16.2 milionë Euro ose 28.7% të eksporteve gjithsej, të cilat u rritën në vëllim por u ulën si pjesë e eksporteve gjithsej nga 41.2% në vitin 2003. Eksportet në Itali u llogaritën në 5.5 milionë Euro, pasuar nga Greqia me 4.3 milionë Euro dhe Gjermania me 3.3 milionë Euro. Eksportet në Maqedoni janë në shumën 9.6 milionë Euro ose 16.9% të Eksporteve të Kosovës.

Figura 21: Eksportet sipas partnerëve kryesorë tregtarë, në miliona Euro



Përsa u përket eksporteve sipas grupit të mallrave metalet bazë dhe artikujt lidhur me këtë kanë pjesëmarrje me 34.8% të eksporteve gjithsej, makineri, vegla dhe pajisje elektrike me 16.2%, dhe gëzofet, lëkurat dhe artikujt e tyre u llogaritën në 10.4%.



FUNKSIONET E BPK-S


Hyrje

Aktivitetet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) ndahen në dy fusha kryesore:

- BPK-ja vepron si Autoriteti Financiar i Kosovës.
- BPK-ja kryen funksionet e zakonshme të një banke qendrore (operacionet bankare dhe shërbimet e përgjithshme të interesit).

Në vigjilje të vitit 2004, lindi nevoja për një strukturë organizative të re dhe më 1 Janar 2004 u vu në zbatim një skemë e re organizative (paraqitur më poshtë). Kjo strukturë formale ka për qëllim sigurimin e zbatimit të "Praktikave më të Mira" në qeverisjen e BPK-s si një bankë qendrore.

SKEMA E ORGANIZIMIT TË BPK-së 2005



2.1. BPK – Autoriteti Financiar i Kosovës

Hyrje

BPK-ja ka autoritet rregullator dhe përforcues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë dhe merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, i cili aktualisht mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve dhe fondet pensionale dhe institucionet e tjera financiare.

Synimi i BPK-s është që të ketë një mbikqyrje financiare dhe një proces rregullator, që të jetë i frytshëm, i ndryshueshëm dhe i cili përkrah një sektor financiar konkurrues i bazuar në treg, dhe i cili zbaton parimet më të mira të standarteve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Metoda mbikqyrëse përvetësuar nga BPK-ja bazohet në një sistem të bazuar në rrezik. Kjo metodë ka për qëllim mundësimin e BPK-s që të shpërndajë siç duhet burimet e saj mbikqyrëse në ato fusha me rrezik më të madh, brenda institucioneve individuale financiare dhe sektorit financiar në përgjithësi. Mbikqyrja sipas rrezikut përqëndrohet në aftësinë e menaxhimit për të identifikuar, vlerësuar, vëzhguar dhe kontrolluar rrezikun.

Në përputhje me legjislacionin i cili drejton funksionet e saj statutore (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/21 dhe 2001/24), BPK-ja ka vendosur standarte dhe kërkesa të hollësishme mbikqyrëse në mënyrë që të arrijë një sektor bankar të mirë-rregulluar. Përveç kësaj, këto Rregullore i japin Bordit Drejtues të BPK-s autoritet për të miratuar rregulla të arsyeshme të mbikqyrjes, të cilat vendosin kufijtë, japin rregulla, procedura dhe kërkesa raportuese për institucionet financiare bankare dhe jo-bankare, dhe detyrojnë veprime për mos-përputhshmërinë me kërkesa ligjore ose për praktika të pasigurta dhe të paqëndrueshme.

Në përputhje me legjislacionin i cili drejton funksionin e saj statutor (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25), BPK-ja ka vendosur standarte dhe kërkesa të hollësishme mbikqyrëse me qëllim arnitjen e një **sektori sigurimi** të mirë-rregulluar.

Një **ligj pensioni** gjithëpërfshirës (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/35) u miratua në Dhjetor të vitit 2001. Kjo Rregullore e krijoi Departamentin e Mbikqyrjes së Pensioneve brenda BPK-s. Ky Departament ka funksione rregullatore dhe mbikqyrëse mbi aktivitetet e biznesit të Pensioneve Shtesë të Punonjësit (Fondet Pensionale) dhe siguruesve të Pensioneve Individuale Shtesë.

Këto funksione aplikohen gjithashtu për dhënësit e shërbimeve të entiteve pensionale, duke përfshirë TKPK⁹-n, menaxherët e mjeteve dhe siguruesit e mjeteve pensionale.

Rregulloret e institucionit financiar dhe rregullat e arsyeshme rishikohen dhe azhurnohen vazhdimisht për të siguruar që ato janë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe që vendosin ekuilibrin e duhur në krijimin e një mjedisi të mirë-rregulluar dhe në të njëjtën kohë duke mos vendosur barra të tepërta ndaj shfrytëzuesve të fundit të shërbimeve financiare.

2.1.1. Aktiviteti i Rregulloreve të Sektorit Financiar të BPK-s

Si një rregullator, BPK-ja merr pjesë në përpilimin e Rregulloreve të caktuara të UNMIK-ut. Seria e plotë e rregullave të cilat përfaqësojnë kornizën ligjore për drejtimin e këtyre aktiviteteve, sipas standarteve të BE-s, janë përshtatur me nivelin aktual të zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë. Kjo kornizë ligjore është përshtatur rregullisht me zhvillimin e ri të institucioneve financiare dhe është plotësuar nga rregullat dhe vendimet e BPK-s.

Gjatë vitit 2004, BPK miratoi Rregullin e ri mbi Auditorët e Jashtëm. Qëllimi i këtij rregulli është fuqizimi i kornizës rregullatore lidhur me auditorët e jashtëm të institucioneve financiare dhe përmirësimi i cilësisë së sektorit financiar në Kosovë.

Me qëllim fuqizimin e kornizës rregullatore dhe përmirësimin e **funksioneve të mbikqyrjes bankare**, Rregullat e mëposhtme u përmirësuan ose u vendosën nga Bordi Drejtues gjatë vitit 2004:

- Rregulli I i përmirësuar mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Ky Rregull u përmirësua për të pasqyruar rrezikun e kundërpalës në mjetet e peshuara të rrezikut për depozitat dhe plasmanet me bankat e tjera.
- Rregulli X i përmirësuar mbi Pastrimin e Parave. Ky Rregull u përmirësua mbi raportimin e transaksioneve të valutave në sasi të mëdha, si në formën e parave të gatshme ashtu edhe në formë elektronike ose përmes transfertave elektronike, me shumë më tepër se 10,000 Euro.
- Rregulli XI i përmirësuar mbi Raportimin e Bankave dhe Degëve Kosovare të Bankave të Huaja. Ky Rregull u përmirësua për qëllime statistikore, për të përmirësuar cilësinë dhe mbulimin e sektorit financiar në përputhje me standartet e FMN-s.

⁹ TKPK – Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës

- Rregulli XX i përmirësuar mbi Kufizimet e Kreditimit. Ky Rregull u përmirësua mbi kreditë dhënë punonjësve; shuma gjithsej e kreditit dhënë punonjësve të një banke nuk do ta tejkalojë 25% të kapitalit të bankës. Shuma maksimale e kreditit nuk do ta tejkalojë shumën 50,000 Euro për kredi individuale të punonjësit.
- Rregulli XXI i përmirësuar mbi Rritjen e Kapitalit Minimal të Bankave. Ky Rregull u përmirësua me qëllim rregullimin dhe qartësimin që çdo investim i bërë në institucionet e tjera financiare duhet të llogaritet kundrejt kapitalit rregullator të bankës.
- Rregulli XXVI i miratuar mbi Informacionet e Normës së Interesit dhe Publikimit. Qëllimi i këtij Rregulli është dhënia e kërkesave për bankat për të siguruar informacione dhe publikime të plota dhe të sakta mbi normat e interesit, kështu që publiku mund të bëjë krahasime kuptimplota ndërmjet bankave lidhur me normat e interesit mbi kreditë dhe depozitat, dhe klientët mund të dinë koston reale të kreditit dhe normën vjetore të kthimit në depozita.
- Rregulli XXVII i Miratuar mbi Pajisjet dhe Proçedurat e Sigurisë Minimale. Ky rregull jep kërkesat e BPK-s për pajisjet e sigurimit minimal, programet e sigurimit dhe proçedurat në vend. Gjithashtu, për bankat të cilat nuk i përmbushin standartet e sigurisë minimale, ky Rregull shpreh që BPK-ja do të kërkojë nivele më të larta të kapitalit për të kompensuar rrezikun e rritur operacional.
- Rregulli XXVIII i miratuar mbi Raportimin e Kredive. Qëllimi i këtij rregulli është rregullimi i raportimit të kredive dhe dhënia e mundësisë siguruesve të kredive për marrjen e raporteve të kredive mbi huamarrësit e mundshëm në përputhje me kushtet e lëshuara nga BPK-ja mbi raportimin e kredive.

Me qëllim përforcimin e kornizës rregullatore për **kompanitë e sigurimit**, u përmirësuan Rregullat e mëposhtme nga Bordi Drejtues gjatë vitit 2004:

- Rregulli 3 i përmirësuar mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Përgjegjësisë së Sigurimit të Automjeteve (TPL). Qëllimi i këtij përmirësimi ishte për të mundësuar lëshimin e kontratave mbi sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së automjeteve në rast transferimi të pronësisë së automjetit për një periudhë më pak se një vit, në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me datën e mbarimit të afatit të regjistrimit të automjetit. Gjithashtu, u përmirësua neni 3.2 i Rregullit 3 i cili shpreh që automjetet e regjistruara jashtë Kosovës duhet të kenë mbulim sigurimi të vlefshëm TPL kur hynë në Kosovë.
- Rregulli 4 i përmirësuar mbi Liçensimin e Kompanive të Sigurimit të Përgjithshme dhe të Jetës. Ky Rregull u përmirësua me qëllim për t'u kërkuar kompanive të sigurimit të cilat

janë të liçensuara për të operuar si një degë në Kosovë, për të dhënë në BPK një garanci bankare në shumën prej 2.5 milionë Euro dhe për të mbajtur raporte financiare të konsoliduara në nivelin e kompanisë qendër.

Në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë janë përpiluar shtatë Rregulla të cilat drejtojnë liçensimin dhe operacionet e **kompanive të sigurimit** të jetës, dhe këto do t'i rekomandohen Bordit Drejtues të BPK-s për miratim gjatë vitit 2005.

Është vendosur një kornizë ligjore e shëndoshë për liçensimin dhe planet e **mbikqyrjes së pensionit shtesë**, dhe për kontrollin e TKPK-s mbi kërkesat për kontributet e detyrueshme të kursimeve pensionale dhe raportimin e tyre. Përveç Rregullores të Pensioneve, janë miratuar dhe lëshuar nga BPK-ja 26 Rregulla mbi Pensionet si legjislacion dytësor. Këto Rregulla drejtojnë kërkesat për liçensim të planeve të pensioneve shtesë, kërkesat për raportim të TKPK-s, mbikqyrjet mbrojtëse, si edhe kërkesat e menaxhimit të investimit së bashku me shkallën e dytë të sistemit të përcaktuar të kontributit, sipas Rregullosës së Pensioneve. Gjatë vitit 2004, Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut iu paraqit një Amendament draft për Rregulloren e Pensioneve, i cili do të sigurojë përforcimin e vendimeve të BPK-s lidhur me TKPK-n dhe skemat shtesë të pensioneve.

2.1.2. Aktiviteti Mbikqyrës dhe Detyrues

2.1.2.1. Liçensimi dhe Struktura

Sipas Rregullosës së UNMIK 1999/21, BPK-ja ka autoritet që të vendosë kritere për një liçensim banke dhe për të refuzuar kërkesat për krijimin e bankave të reja, të cilat nuk i përmbushin këto standarte.

Strategjia e BPK-s në fushën e **liçensimit të bankave** përqëndrohet në tërheqjen e investitorëve, të cilët, duke patur një pozitë të fortë financiare, aksionerë dhe menaxhim të duhur, janë të aftë që të zhvillojnë një qasje të matur bankare për të mbrojtur interesat e klientëve, kështu duke ndihmuar në përforcimin e sistemit bankar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Bankat Komerciale. Aktiviteti i liçensimit të BPK-s gjatë vitit 2004 kishte të bënte kryesisht me hapjen e degëve të reja, dhe ndryshimet në strukturat e pronësisë së bankave.

Që nga shpallja e Rregullosës së UNMIK-ut 1999/20 [përmirësuar sipas Rregullosës 2001/24] mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Nëntor 1999, BPK-ja ka refuzuar 11 aplikime për liçensë bankare.

Gjatë vitit 2003, kërkesa ligjore e BPK-s për kapital minimal për një license bankare u rrit në 4 milionë Euro. Deri në 31 Dhjetor 2003, të gjitha bankat kishin përmbushur me sukses kërkesën për kapital minimal. Gjatë vitit 2004 nuk janë bërë ndryshime mbi kërkesat ligjore për kapital minimal të bankave.

Numri i bankave gjatë vitit 2004 mbeti i njëjtë me atë të vitit 2003 me 7 banka komerciale. Rrjeti bankar i punës me degë dhe nën-degë u rrit me 66 degë dhe nën-degë duke përfshirë zyrat në pikat e doganës, pikat e regjistrimit të automjeteve dhe qendrat e kontrollit teknik të automjeteve. Në fund të vitit 2004, rrjeti i punës së 7 bankave operonte me 217 degë dhe nën-degë në mbarë Kosovën.

Këmbimoret dhe Agjensitë e Dërgimit të Parave. Në fund të vitit 2004 katër këmbimore dhe dy agjensi të dërgimit të parave drejtonin aktivitetet e tyre. Një agjensi tjetër e dërgimit të parave - Money Gram, u liçensua nga BPK-ja përmes agentit të saj në Kosovë në fund të vitit 2004.

Institucionet Mikro Financiare. Gjatë vitit 2004, u regjistrua nga BPK-ja një institucion i ri financiar jo-bankar, dhe u miratuan pesë shoqëri kreditimi të cilat i përkasin një institucioni mikro financiar të caktuar. Në fund të vitit 2004, në mbarë Kosovën operonin 18 institucione mikro financiare.

Në bazë të autoritetit të dhënë nga Rregullorja 2001/25 mbi Liçensimin, Mbikqyrjen dhe Rregulloren e **Kompanive të Sigurimit** dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, aktiviteti i liçensimit të kompanive të sigurimit nga BPK-ja tregohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 9: Aktiviteti i Liçensimit të Kompanive të Sigurimit në vitin 2004

Përshkrimi	2004	Aktivitetet e Liçensimit në vitin 2004			
		Aplikimet	Liçensuar	Në proces	Refuzuar
Kompani të Sigurimit	8	5	2	1	2
Kompani të Sigurimit të Jetës	0	0	0	0	0
Brokerët e Kategorive Shtesë	3	3	2	1	0
Agjentët e Liçensuar	582	108	89	19	147
Rregulluesit e Dëmeve	2	2	2	0	0
Rregulluesit e Pavarur të Ankesave	2	2	1	1	0
Sigurimet e Klasave Vullnetare	41	14	3	6	0

Gjatë vitit 2004, BPK-ja miratoi licënsën e një kompanie sigurimi dhe licënsën e një dege për një kompani të huaj sigurimi e cila operon në Kosovë. Gjithashtu, BPK-ja vazhdoi miratimin paraprak për licënsën e një kompanie sigurimi.

Gjatë vitit 2004, BPK-ja hoqi licënsën e dy degëve të kompanive të sigurimit të cilat operojnë në Kosovë.

Gjatë vitit 2004, BPK-ja nuk licënsoi asnjë fond **Pensional Shtesë të Punonjësve**; kështu, numri i planeve të licënsuar të pensioneve mbetet gjashtë, i njëjti numër i cili ekzistonte në fund të vitit 2003.

2.1.2.2. Kontrollet Financiare

Për të përmbushur përgjegjësinë e saj për licënsimin dhe mbikqyrjen e institucioneve financiare, Departamentet e Mbikqyrjes së BPK-s (Mbikqyrja Bankare, Mbikqyrja e Sigurimeve, dhe Mbikqyrja e Fondeve Pensionale) janë duke ndjekur një metodë mbikqyrëse të vazhdueshme përmes kontrolleve on-site dhe monitorimit off-site.

Kontrollet On-Site

Puna e kontrollit on-site kryer nga kontrollorët është e ndërtuar në një mënyrë që të sigurojë verifikim të pavarur dhe që informacioni i dhënë nga institucionet financiare të jetë i besueshëm. Kontrollet on-site drejtohen në përputhje me planin vjetor të kontrollit, i cili përshtatet sipas nevojës, për shkak të rrethanave të paparashikuara. Janë zhvilluar roçedura të standartizuara të mbikqyrjes on-site, të cilat për sistemin bankar bazohen në një sistem CAMEL me pesë-shkallë (Mjaftueshmëria e Kapitalit, Cilësia e Mjeteve, Menaxhimi, Fitimet dhe Likuiditeti) për përcaktimin e vlerësimeve bankare.

Dapartamenti i Mbikqyrjes së Sigurimeve në drejtimin e kontrolleve on-site të kompanive të sigurimit është duke zbatuar një sistem të ri vlerësimi i cili bazohet në vlerësimin e rrezikut të kompanive të sigurimit në fushat e mëposhtme: (1) fuqia financiare, (2) teste të saktësisë dhe të përshtatshmërisë, (3) sisteme dhe kontrolle – 10 fusha, (4) raportet e auditimit dhe, (5) drejtësia me mbajtësit e policave. Cikli i parë i kontrolleve on-site me këtë model ka përfunduar dhe ka ndihmuar në identifikimin e një numri dobësish në këtë industri.

Për fondet pensionale, sistemi i vlerësimit bazohet në vlerësimin CAMERA (Kontribut, Mjete, Menaxhim, Punonjës, Përputhje me Rregulloren, dhe Shqyrtimet e Aktuarit).

Gjatë vitit 2004, në secilën prej shtatë **bankave** u zhvillua një kontroll i plotë on-site. Përveç kësaj, gjatë vitit u zhvilluan 10 kontrolle të kufizuara (me synim), të cilat u përqëndruan në shqetësime të veçanta të mbikqyrjes. Kontrollat me synim gjatë vitit 2004 u përqëndruan kryesisht në fushat e mëposhtme: (1) rreziku i kreditimit; (2) kredi-dhënia mbitërheqje; (3) ndryshimet në strukturën e aksionerëve dhe kapitalit të bankave; dhe (4) rreziqet operacionale.

Kërkesat për hapjen e degëve ose nën-degëve të reja u pasuan nga 66 kontrolle shtesë të para-hapjes. Gjithashtu, gjatë vitit u zhvilluan gjashtë kontrolle on-site në institucionet financiare jo-bankare, tri kontrolle on-site në këmbimore dhe, një kontroll on-site në agjensitë e dërgimit të parave.

Tabela 10. Sektori Financiar: Kontrollat on-site të zhvilluara gjatë vitit 2004

	Lloji i kontrollit	Numri i kontrolleve
Industria Bankare	1. Kontrollat të plota - banka	7
	2. Kontrollat të kufizuara - banka	10
	3. Kontrollat e para-hapjes - degë	66
	4. Kontrollat - kontrolle të plota	6
	5. Dërguesi i Parave - kontrolle të plota	1
	6. Këmbimore - kontrolle të plota	3
Industria e Sigurimeve	6. Kontrollat të plota në kompanitë e sigurimeve	16
	7. Kompanitë e sigurimeve - degë	18
	8. Kompanitë e sigurimeve - zyrat e agjentëve	158
	9. Linjat Shtesë të Brokerave	4

Gjatë vitit 2004, Departamenti i Mbikqyrjes së Pensioneve zhvilloi 20 kontrolle on-site në fondet pensionale vullnetare, ndërsa vëzhgimi off-site u krye në baza mujore. Kontrollat on-site u përqëndruan në drejtimin e fondeve pensionale, saktësinë e kontributeve, mbajtjen e të dhënave, investimet pensionale, dhe kontrollet e brendshme.

Kontrollet Off-Site

Është zhvilluar një proces për identifikimin dhe monitorimin e problemeve të mundshme në banka, veçanërisht në intervalet ndërmjet kontrollet on-site. Mbikqyrja off-site dhe analizimi i bankave përfshijnë si vijon: (1) analizë mujore e vazhdueshme e bankave individuale bazuar në raportet e standartizuara rregullatore të bankave; dhe (2) një analizë e përgjithshme e sektorit bankar për të zbuluar rrezikun e sistemit. Gjatë vitit 2004, Departamenti i Mbikqyrjes Bankare përfundoi 28

analiza off-site për shtatë bankat komerciale. Bazuar në kontrollet off-site janë ndërmarrë disa masa korrigjuese ndaj bankave.

Monitorimi off-site përfaqëson një formë vazhdimi të procesit të monitorimit dhe mbikqyrjes së aktiviteteve të kompanive të sigurimit. Përmes kontrolleve të tilla, mblidhen informacione mbi kompanitë e sigurimeve, mbi aktivitetet e tyre, dhe nivelin e përputhshmërisë me rregullat e sigurimit. Kompanive të sigurimit iu kërkohet që të dorëzojnë në BPK të dhëna financiare dhe statistikore në baza të rregullta. Raportime të tilla mbulojnë të dhënat mujore dhe tremujore mbi premiumet, shpenzimet, investimet, lëvizjet e parave të gatshme, dhe kërkesat. Bazuar në këto raporte, Departamenti i Mbikqyrjes së Sigurimeve harton raporte të përmbledhura statistikore mujore të sigurimeve, të cilat mbulojnë zhvillimet më kryesore brenda industrisë së sigurimeve.

Kontrollet off-site të zhvilluara nga Departamenti i Mbikqyrjes së Pensioneve gjatë vitit 2004 u përqëndruan në gjendjen financiare të fondeve pensionale, kualifikimet e pjesëmarrësve të rinj, dhe bashkërendimin e kontribuesve dhe pagesave të pensioneve.

2.1.2.3. Autoritetet Formale të Mbikqyrësve (Masat Detyruese)

Bankat Komerciale. Pavarësisht nga përpjekjet e mbikqyrësve, ka patur situata kur bankat kanë dështuar në përmbushjen e kërkesave mbikqyrëse më të arsyeshme ose kanë përdorur praktika bankare të pasigurta dhe jo të shëndosha. Për shkak të shkeljeve rregullative ose të praktikave bankare të pasigurta dhe jo të shëndosha, në vitin 2004 BPK-ja ka ndërmarrë 25 masa detyruese.

Në bazë të Rregullores 1999/21 masat detyruese variojnë nga paralajmërimet me shkrim deri në heqjen e licenses. Gjatë vitit 2004 janë ndërmarrë një shumëllojshmëri masash detyruese, bazuar në rëndësinë e shkeljeve, shfaqjes së rrezikut, shkeljeve të përsëritura etj. Llojet e masave detyruese të ndërmarra përfshinin komunikimin me gojë ose me shkrim, kufizimin e aktiviteteve të caktuara, marrëveshje zyrtare ndërmjet BPK-s dhe bankave, kërkesa për rritjen e kapitalit, dhe gjobitje monetare.

Masat detyruese të ndërmarra kundra bankave kanë patur si rezultat një gjendje më të fortë financiare të institucioneve financiare dhe uljen e rrezikut.

Kompanitë e Sigurimeve. Gjatë kontrolleve të kompanive të sigurimit të zhvilluara gjatë vitit 2004, u zbuluan shkelje të rregullave të sigurimeve, të cilat rezultuan në paralajmërimet me shkrim dhe gjobitje monetare. Masat e mëposhtme disiplinore u ndërmorën kundra kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve gjatë vitit 2004:

- shtatë urdhra kundra kompanive të sigurimeve,
- dy urdhra kundra Brokerëve të Kategorive Shtesë

Shuma gjithsej e të ardhurave që shkuan në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si pasojë e masave disiplinore për sektorin e mbikqyrjes financiare për vitin 2004 ishte 69,500 Euro.

2.1.3. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Mbikqyrja bankare ndërkufitare. Në përputhje me Parimet Bazë për Mbikqyrjen Efektive Bankare, synimi i BPK-s është që të praktikojë mbikqyrje bankare globale të konsoliduar. Një përbërës kyç i mbikqyrjes së konsoliduar është vendosja e kontaktit dhe shkëmbimi i informacionit me autoritetet e tjera mbikqyrëse. Në vitin 2002 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi (MM) mbi mbikqyrjen bankare të kalimit të kufirit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet BPK-s dhe Bankës së Shqipërisë. Në fund të vitit 2003, filluan bisedimet me Bankën Kombëtare të Serbisë mbi nënshkrimin e një MM mbi bashkëpunimin reciprok lidhur me çështjet e mbikqyrjes bankare dhe shkëmbimit të informacionit. Gjithashtu, në Mars 2005 pritet të nënshkruhet një MM ndërmjet BPK-s dhe Bankës së Sllovenisë.

Mbikqyrja e sigurimeve ndërkufitare. Gjatë vitit 2004, u nënshkrua një MM ndërmjet Komisionit Shqiptar të Mbikqyrjes së Sigurimeve me Bashkëpunim në Fushën e Mbikqyrjes së Sigurimeve.

MM Ndërkombëtare të Sigurimeve. Kosova nuk është pjesë e sistemit ndërkombëtar të Kartës së Gjelbërt; prandaj, në bashkëpunim me UNMIK-un, BPK-ja ka punuar shumë në përmirësimin e lirisë së lëvizjes për qytetarët Kosovarë në mënyrë që të udhëtojnë në vendet fqinje.

MM-t e nënshkuara me Byrotë Kombëtare të Maqedonisë dhe Shqipërisë janë duke u zbatuar me sukses. Është nënshkruar një MM mbi Njohjen Reciproke të Sigurimit TPL si edhe rregullimin e kërkesave për zhdëmtim (mbulimi i kërkesave) me Byronë Kombëtare të Kroacisë. Zbatimi i tij do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të protokollit ndërmjet Qeverisë Kroate dhe UNMIK-ut. Gjithashtu, negociatat me Bullgarinë dhe Turqinë mbi njohjen reciproke të Sigurimit TPL janë në fazat e tyre përfundimtare.

2.1.4. Zhvillimet Kryesore të Sektorit Financiar

Zhvillimet në Industrinë Bankare. Zhvillimi i industrisë bankare ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2004. Ndonëse numri i bankave mbeti i njëjtë me atë të vitit të mëparshëm, pjesa më e madhe e bankave vazhdoi të jetë dinamike në zgjerimin e rrjetit të tyre të punëve në mbarë Kosovën. Siç u përmend edhe më lart, numri i zyrave degë (degë, nën-degë dhe shërbimeve në distancë) në fund të vitit

2004 arrinte në 217, duke i bërë shërbimet bankare më të arritshme për qytetarët dhe ndërmarrjet e Kosovës. Në fund të vitit 2004, një zyrë degë mbulonte 8,756 banorë.

Deri më 31 Dhjetor 2004, numri gjithsej i mjeteve të grumbulluara në sistemin bankar ishte 795.4 milionë euro krahasuar me 581.0 milionë euro nga viti i mëparshëm, ose 214.4 milionë euro më shumë. Rritja e kredive ishte veçanërisht e fortë gjatë vitit 2004 me kredi gjithsej të lejuara për sektorin bankar duke u rritur nga 233.1 milionë euro në fund të vitit 2003 në 374.2 milionë euro në fund të vitit 2004, një rritje prej 60.5%. Në të njëjtën kohë, depozitat gjithsej në sistemin bankar në fund të vitit 2004 ishin 694.8 milionë euro, ose 36.0% më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm. Depozitat kanë arritur nivelin e tyre më të lartë që prej ri-vendosjes së sistemit bankar në vitin 2000, gjë e cila reflekton një rritje të besimit të publikut ndaj sistemit bankar në Kosovë. Deri në fund të vitit 2004, kishte një llogari të hapur për çdo katër banorë.

Përgjithësisht, sistemi bankar është i mirë-kapitalizuar. Në vitin 2002 dhe pastaj sërish në vitin 2003, BPK-ja i rriti kërkesat minimale të kapitalit për bankat, për t'i sjellë standartet e kapitalit sipas direktivave të BE-s. Siç u përmend edhe më lart, të gjitha bankat kanë rritur me sukses kapitalin e tyre në ose më shumë se minimumi i kërkuar prej 4 milionë euro deri në fund të vitit 2003. Megjithatë, në fund të vitit 2004, një bankë nuk përmbushi kërkesën minimale për kapital. Bazuar në standartet e mjaftueshmërisë të kapitalit, kapitali gjithsej për sistemin bankar më 31 Dhjetor 2004 ishte i barabartë me 16.6% të mjeteve të peshuara kundra rrezikut.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar më 31 Dhjetor, në bazë të kapitalit ishte 54.23% kapital i huaj dhe 45.77% kapital i brendshëm. Nuk ka banka me pronësi shtetërore në Kosovë, dhe një përqindje shumë e vogël e kapitalit në sistemin bankar mbahet nga ndërmarrjet me pronësi shoqërore.

Zhvillimet e tjera në sistemin bankar gjatë vitit 2004 përfshinin përhapjen e bankomateve të dy bankave: Banka ProCredit dhe Banka Raiffeisen e Kosovës, të cilat janë të lidhura me karta ndërkombëtare si: MasterCard, Maestro Card, dhe Visa Card. Në fund të vitit, këto dy banka operonin gjithsej 43 bankomate. Përveç kësaj, gjatë vitit 2004 Banka ProCredit instaloi një numër terminalesh të Pikave të Shitjes (PSH).

Produktet e reja të kreditimit të prezantuara nga bankat gjatë këtij viti përfshinin kreditë e biznesit me afate më të gjata; kreditë konsumatore për blerjen e automjeteve, rinovimin e shtëpive, dhe blerjen e të mirave shtëpiake; si edhe shërbimet elektronike bankare.

Aktualisht tri banka kanë marrëveshje huamarrjeje me Kreditanstalt für Wiederaufbau's (KfW) për periudha më të gjata kohore (3-5 vite), e cila siguron një burim fondesh për kredi me afate më të gjata.

Zhvillimet në industrinë e sigurimeve. Gjatë vitit 2004, tetë kompani të licensuara të sigurimeve operonin në Kosovë. Katër prej këtyre kompanive janë me origjinë Kosovare, ndërsa katër të tjera operojnë si degë të kompanive të sigurimit të licensuara nën një juridiksion tjetër (tri nga Shqipëria dhe një nga Serbia). Gjithashtu, në fund të vitit 2004, tri ndërmjetësues të licensuar të sigurimeve operonin si brokera të linjave shtesë të sigurimit shëndetësor për udhëtim jashtë vendit, dhe një organizatë për shlyerjen e kërkesave ndërkombëtare.

Premiumet e Regjistruara dhe Shlyerja e Kërkesave. Në vitin 2004, tetë kompanitë e sigurimit regjistruan gjithsej 230,198 polica, ose 7.3% rritje krahasuar me vitin 2003. Të ardhurat gjithsej prej premiumeve në vitin 2004 ishin 35.6 milionë euro, 19.2% më e lartë sesa në vitin 2003. Gjatë vitit 2004, u shlyen 9,065 kërkesa me gjithsej 7.4 milionë euro, ose 21.9% më shumë sesa në vitin 2003.

Është themeluar një Fond Garancie në përputhje me Rregullin 3 të Sigurimeve të BPK-s, neni 4. Kompanitë e Sigurimeve të cilat sigurojnë sigurim TPL e krijuan këtë Fond nga kontributet e paguara. Një Këshill Drejtues, përbërë nga një përfaqësues nga çdo kompani sigurimi, e drejton Fondin e Garancive. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të ketë miratimin paraprak të BPK-s.

Fitimet bruto në Fondin e Garancive gjatë vitit 2004 arritën shumën prej 1.5 milionë euro, e cila përfaqëson një rritje prej 50.0% krahasuar me vitin 2003.

Një sukses i veçantë gjatë këtij viti në industrinë e sigurimeve ishte zbatimi i një sistemi komunikimi on-line dhe pagesat e premiumeve përmes bankave.

Platforma e sistemit të komunikimit on-line dhe software-i klient-server IRIS filloi zbatimin e saj në fillim të Qershorit 2004. Kjo platformë përfshin të gjitha kompanitë e sigurimeve, degët dhe agjentët e tyre, SHSK-n, qendrat e regjistrimit të automjeteve dhe BPK-n.

Në këtë sistem është zvogëluar mundësia e abuzimit në sigurime dhe është lehtësuar një menaxhim efikas i procesit të shitjes së policave të sigurimit nga ana e kompanive të sigurimit. Platforma e sistemit të komunikimit on-line ka mundësuar gjithashtu një mbikqyrje më cilësore nga ana e BPK-s.

Ndërsa prezantimi në industrinë e sigurimeve të sistemit të pagesave të premiumeve të policave të sigurimit përmes bankave, një risi në industrinë e sigurimeve në Kosovë, ka mundësuar një kontroll dhe menaxhim efikas të qarkullimit të pagesave në sistemin bankar dhe ka eliminuar vështirësitë që hasen zakonisht në përdorimin e parave të gatshme.

Zhvillimi i Fondeve Pensionale. Në fund të vitit 2004, gjashtë fondet pensionale shtesë të liçensuara kishin gjithsej 4,197 pjesëmarrës, një rritje prej 19.2% krahasuar me fundin e vitit 2003. Pritet që më tepër ndërmarrje të krijojnë fonde pensionale për punonjësit e tyre si një shtesë për pensionet e detyrueshme individuale të kursimeve.

Kontributet gjithsej deri më 31 Dhjetor 2004 ishin 7.6 milionë euro, krahasuar me vitin 2003, një rritje prej 104.1%, ndërsa mjetet e mbetura në fund të vitit 2004 ishin në shumën 5.8 milionë euro, duke përfaqësuar një rritje prej 159.1% krahasuar me fundin e vitit 2003.

Në fund të vitit 2004, kontributet gjithsej të grumbulluara për TKPK-n ishin në shumën prej 82.9 milionë Euro, duke përfaqësuar një rritje prej 45.1 milionë euro nga fundi i vitit 2003, ndërsa numri i pjesëmarrësve në fund të vitit 2004 ishte 145,000, një rritje kjo prej 19.4% krahasuar me fundin e vitit 2003.

2.2. Operacionet Bankare

Në vitin 1999, Marka Gjermane u bë monedha e lejuar për përdorim në Kosovë. Rregullorja 1999/04 dhe Udhëzimi Administrativ pasues 1999/02, të dyja të nxjerra në vitin 1999, e miratuan Markën Gjermane si denominimin për llogaritë dhe pagesat zyrtare. Sipas Udhëzimit Administrativ 2001/24, nxjerrë në vitin 2001, dhe me ndërrimin në euro në vitin 2002, euro zëvendësoi Markën Gjermane si monedhën e lejuar për përdorim në Kosovë.

BPK-ja nuk emëton ndonjë monedhë dhe nuk jep kredi. Megjithatë, ajo kryen funksione të tjera të cilat zakonisht lidhen me operacionet e bankës . Këto përfshijnë:

- Të sigurojë furnizimin e mjaftueshëm me kartmonedha dhe monedha
- Të promovojë një sistem të pagesave
- Të veprojë si një bankier për IPVQ-t dhe agjensitë në fjalë
- Të menaxhojë mjetet financiare
- Të veprojë si një këshilltar mbi çështjet financiare për vendim-marrësit publik
- Të kryejë shërbime të tjera të interesit të përgjithshëm

2.2.1. Furnizimi me Kartmonedha dhe Monedha Euro

Për shkak të përdorimit të euros si monedhë në Kosovë, funksioni i BPK-s për të siguruar furnizimin me kartmonedha dhe monedha lidhet me paratë e gatshme euro. BPK-ja është përgjegjëse për të siguruar një furnizim të mjaftueshëm me kartmonedha dhe monedha euro për shlyerjen e transaksioneve në para të gatshme në ekonomi.

Figura 22: Furnizimi me kartmonedha euro (numri i copëve)





Figura 23: Furnizimi me monedha euro (numri i copëve)




Sic paraqitet në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2004, BPKja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me 4,540,000 kartmonedha euro duke arritur në shumën prej 246,330,500 euro dhe 1,518,000 monedha euro në shumën 542,710 euro. Llogaritur sipas vlerës, paratë e gatshme të furnizuara në vitin 2004 u ulën në afërsisht pesë përqind krahasuar me vitin 2003, dhe struktura e furnizimit me para të gatshme sipas denominimeve ndryshoi në mënyrë të dukshme. Ndërkohë që furnizimi me kartmonedha të denominimit të vogël (kartmonedha 5, 10, dhe 20 euro) u rrit në mënyrë të konsiderueshme dhe furnizimi me kartmonedha 50 euro u rrit lehtë, furnizimi me kartmonedha të denominimit të madh (kartmonedha 100, 200, dhe 500 euro) pësoi një ulje të lehtë. Më pas, furnizimi me monedhat e denominimit më të vogël (1 dhe 2-monedha eurocent) dhe monedhat e denominimit më të madh (1 dhe 2-monedha euro) u ul, ndërsa furnizimi me monedha të denominimeve të tjera u rrit.

Nga ana tjetër, në vitin 2004 BPK-ja proçesoi më shumë se 7.3 milionë euro kartmonedha dhe më shumë se 2.8 milionë euro monedha të cilat u depozituan nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Shprehur në vlera, këto depozita arritën përkatësisht në afërsisht në 422 milionë euro dhe afërsisht 2 milionë euro. Në mënyrë të ngjashme me ndryshimin vjetor të parave të gatshme të furnizuara, vlera gjithsej e parave të gatshme të depozituara në BPK tregon një rënie të lehtë (3%) krahasuar me vitin e mëparshëm.

Të njëjtat lëvizje vjetore të vëllimeve të furnizimit me para të gatshme dhe operacionet e depozitimit rezultuan në një zhvillim pothuajse të njëjtë të tepricës së parave të gatshme në thesarin e BPK-s në vitin 2004 krahasuar me vitin e mëparshëm. Në vitin 2004, paratë e gatshme të depozituara në BPK ishin më shumë se paratë e gatshme të furnizuara nga BPK-ja për afërsisht 177 milionë euro, dhe në vitin 2003 kjo shifër ishte vetëm mbi 176 milionë euro. Megjithatë, një përmirësim i proçesit të menaxhimit të parave të gatshme rezultoi në një rritje të parave të gatshme të eksportuara gjatë vitit 2004. Ndërkohë që eksporti neto i parave të

gatshme në vitin 2003 arriti në 167 milionë euro, eksporti neto i parave të gatshme në vitin 2004 ishte 191 milionë euro. Duke patur parasysh që paratë e gatshme të eksportuara transformohen në mjete me interes fitimi, rritja e tyre pati një kontribut pozitiv në performancën financiare të BPK-s.

Figura 24: Kartmonedhat e njollosura të hequra nga qarkullimi dhe kartmonedhat e reja të vëna në qarkullim




Proçesimi i kartmonedhave dhe monedhave të depozituara në BPK vazhdoi të kryhet me pajisje moderne të proçesimit dhe sipas rregullave standarte. Gjatë vitit 2004, 1,106,200 kartmonedha euro (15% të kartmonedhave euro të depozituara në BPK) u klasifikuan si të njollosura dhe u hoqën nga qarkullimi. Megjithatë, përmirësimi i cilësisë së parave të gatshme në qarkullim është ende në vazhdim.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2004, BPK-ja bëri furnizimin me 284,800 kartmonedha të reja (6% e kartmonedhave euro të furnizuara). Pjesa më e madhe e kartmonedhave të reja të furnizuara ishin kartmonedha të denominimit të vogël: kartmonedha 5-euro (240,800), kartmonedha 10-euro (26,000), dhe kartmonedha 50-euro (13,000).

Përsa u përket masave kundër-falsifikimit, BPK-ja vazhdoi të kontrollojë rastet e monedhave të falsifikuara gjatë gjithë vitit 2004. Gjatë vitit, 130 kartmonedha euro të identifikuar si të falsifikuara u sollën në BPK. Me konfirmimin se këto monedha ishin të falsifikuara, BPK-ja dorëzoi ato në NJHFM¹⁰. Pjesa më e madhe e kartmonedhave të identifikuar si të falsifikuara ishin kartmonedha 50-euro (55), kartmonedha 200-euro (42), dhe kartmonedha 100-euro (25).

¹⁰ Njësia Hetuese për Falsifikimin e Monedhave

Figura 25: Numri I kartmonedhave të identifikuara si të falsifikuara



Me qëllim përmirësimin e qarkullimit të parave të gatshme në ekonomi, në vitin 2004, BPK-ja përgatiti tri udhëzime dhe një rekomandim:

- Udhëzimi Nr. 2 Mbi Shmangien e Kartmonedhave të Falsifikuara nga Qarkullimi,
- Udhëzimi Nr. 3 Mbi Standartet Minimale për Klasifikimin e Gjendjes së kartmonedhave Euro nga Palët Tregtare,
- Udhëzimi Nr. 4 Mbi Paketimin e Kartmonedhave dhe Monedhave Euro për Depozitimin e Sasisë në BPK, dhe
- Rekomandimi Nr.1 Mbi Kontrollin e Standarteve për Riciklimin e Kartmonedhave nga Palët Tregtare.

Të tri udhëzimet dhe rekomandimi u përgatitën në përputhje me dispozitat përkatëse të BQE-s. Ato do të lëshohen në fillim të vitit 2005.

Deri në tremujorin e parë të vitit 2005, BPK-ja do të rrisë gjithashtu shpërndarjen e kartmonedhave të reja dhe do të furnizojë sektorin financiar me monedha euro shtesë të denominimit të vogël.


2.2.2. Sistemi i Pagesave

Një nga synimet kryesore të BPK-s është për të siguruar një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme. Që prej themelimit të saj, BPK-ja e ka vazhduar këtë synim në mënyrë aktive, dhe një arritje e madhe u shënuar në Maj 2001, kur, me kontributin e USAID-it, u krijua Sistemi Ndërbankar i Pagesave (SNP) me qëllim lehtësimin e operacioneve të brendshme bankare përmes sistemit bankar. SNP-ja ka operuar në BPK që prej themelimit të saj, dhe infrastruktura e saj iu dha zyrtarisht BPK-s nga USAID-i në Shtator të vitit 2004.

BPKja jo vetëm menaxhon dhe monitoron SNP-n, por gjithashtu merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionet e saj së bashku me shtatë bankat komerciale. Proçedurat e pagesave dhe të shlyerjeve kryhen sipas Rregullores Nr. 2001/26 Mbi Transaksionet e Pagesave dhe Rregulli Bankar Nr. XVIII Mbi Pagesat dhe Operacioni i Barazimit të Llogarive..

Që prej Majit 2001, numri dhe vlera e transaksioneve të kaluara përmes SNP-s është rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar rritjen e besimit në sistemin e brendshëm bankar. Ndërkohë, SNP-ja ka pësuar zhvillime teknologjike të vazhdueshme ndërsa mënyrat e transaksioneve janë modernizuar dhe përmirësuar.


Figura 26: Zhvillimi i Operacioneve të SNP-s (numri i transaksioneve)



Gjatë vitit 2004, përmes SNP-s janë kryer 266,744 transaksione me një vlerë gjithsej prej 1,714,649,837 euro. Krahasuar me operacionet e SNP-s në vitin 2003 dhe 2002, numri i transaksioneve në vitin 2004 u rrit në mbi përkatësisht 60% dhe 250%. Vlera gjithsej e transaksioneve të SNP-s, në vitin 2004, tregon rritje në më shumë se 20% krahasuar me vitin 2003 dhe më shumë se 100% krahasuar me vitin 2002.

Rritja e ndjeshme e transaksioneve të SNP-s mund të vërehet gjithashtu nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SNP-s në vitin 2004 ishte rreth 6.7 milionë euro, krahasuar me rreth 5.5 milionë euro në vitin 2003 dhe rreth 3.3 milionë euro në vitin 2002. Më pas, numri ditor i transaksioneve në vitin 2004 ishte mbi 1000, krahasuar me 650 transaksione në vitin 2003 dhe 300 transaksione në vitin 2002.

Figura 27: Zhvillimi i operacioneve të SNP-s (vlera e transaksioneve në '000 euro)



Përveç pagesave të rregullta (tranferta bankë më bankë), operacionet e SNP-s gjithashtu përfshijnë një numër pagesash me parësi (pagesa individuale në kohë reale) dhe një numër të pagesave në masë (pagesa të vetme për llogarinë e përfituesve të shumtë). Pagesat e rregullta dhe me parësi janë kryer si pagesa të plota elektronike që prej krijimit të SNP-s, ndërsa pagesat në masë, të cilat u prezantuan në vitin 2002, u kryen si pagesa gjysmë-elektronike deri në Shkurt 2004. Që prej asaj kohe, për shkak të një përmirësimi të SNP-s, pagesat në masë mund të kryhen gjithashtu si transferta të plota elektronike.

Përmirësimi i mëtejshëm teknologjik i SNP-s është duke ndodhur me zhvillimin e një sistemi pagesash giro - "Kos-giro", si një projekt i përbashkët i KEK-ut, PTK-s, shtatë bankave komerciale dhe BPK-s si koordinatore. Ky sistem është përcaktuar për të siguruar një metodë jo në para të gatshme të mbledhjes së faturave nga shërbimet publike si p.sh. KEK-u dhe PTK-ja, por mund të përdoret nga entitetet e tjera, gjithashtu. Faza para-pilot filloi në Dhjetor 2004, dhe ky sistem pritet që të bëhet tërësisht funksional gjatë vitit 2005.

Si pjesëmarrëse në sistemin e pagesave të brendshme, BPK-ja kryen urdhra të brendshme pagesë/transfertë nga ana e ose për llogarinë e klientëve të saj. Gjatë vitit 2004, BPK-ja kreu 93,687 urdhra të brendshme dalëse (pagesa/transferta nga ana e klientëve të saj) dhe 44,710 urdhra të brendshëm hyrëse (pagesa/transferta për llogarinë e klientëve të saj). Shprehur në vlera, shuma e urdhrave dalëse në vitin 2004 ishte 738 milionë euro, ndërsa shuma e urdhrave hyrëse ishte 725 milionë euro.


BPK-ja gjithashtu drejton operacionet e pagesave ndërkombëtare nga ana e ose për llogari të klientëve të saj. Këto operacione drejtohen përmes bankave të zgjedhura të huaja. Gjatë vitit 2004, BPK kreu 556 pagesa/transferta ndërkombëtare dalëse me gjithsej 381 milionë euro dhe 127 pagesa/transferta ndërkombëtare hyrëse me gjithsej 93 milionë euro. Megjithatë, mungesa e një

kodi të duhur SWIFT e kufizon zhvillimin e operacioneve të pagesave ndërkombëtare. BPK-ja në bashkëpunim me UNMIK-un po bën përpjekjet e saj më të mira për të siguruar një kod SWIFT të përdorshëm në Kosovë. Janë bërë disa kërkesa ndaj organeve kompetente, por deri tani pa sukses. Në fillim të vitit 2005 do të iniciohet një përpjekje e re.

2.2.3. Bankier për IPVQ-t¹¹ dhe Agjensitë në fjalë

Funksioni i bankierit ndaj institucioneve të pushtetit qendror iu dha BPK-s bazuar në Rregulloren Nr. 1999/20, brenda nenit mbi autoritetet e veçanta të BPK-s. BPK-ja siguron shërbime bankare nga ana e dhe për llogarinë e IPVQ-ve dhe agjensive në fjalë, si edhe për UNMIK-un. Ajo gjithashtu ofron shërbime bankare për institucionet e sektorit publik, duke përfshirë një numër të kompanive publike. Në vitin 2004, njësoj si në vitin e mëparshëm, këto shërbime kishin të bënin kryesisht me mirëmbajtjen e llogarive dhe kryerjen e operacioneve të pagesave përjashtuar mundësinë e dhënies së kredive.

Figura 28: Zhvillimi i depozitave të IPVQ-ve dhe agjensive në fjalë dhe UNMIK-ut, shumat në '000 EUR



Depozitat e IPVQ-ve dhe të agjensive në fjalë përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave gjithsej në llogaritë e BPK-s. Më 31 Dhjetor 2004, depozitat e IPVQ-ve dhe agjensive në fjalë në llogaritë e BPK-s arritën në 212.4 milionë euro. Në të njëjtën kohë, depozitat e UNMIK-ut arritën në 5.2 milionë euro. Zhvillimi i niveleve të depozitave të IPVQ-ve dhe agjensive në fjalë dhe UNMIK-ut të mbajtura në llogaritë e BPK-s, si edhe të raporteve të tyre reciproke, paraqitet në figurën më lart.

¹¹ Institucionet e Përkohshme Vetë-Geverisëse të Kosovës

Përveç kësaj, pjesa më e madhe e operacioneve të brendshme të pagesave kryhen nga ana e dhe për llogarinë e IPVQ-ve dhe agjensive në fjalë. Të dyja operacionet bankare dhe aktivitetet e mirëmbajtjes së llogarive janë përgjegjësi e Departamentit të Shërbimeve Bankare.

Cilësia e shërbimeve bankare u përmirësua ndjeshëm gjatë vitit. Në veçanti, në Nëntor 2004, shkëmbimi i informacionit me Departamentin e Thesarit nga MEF u përmirësua me një paraqitje elektronike të urdhrave të pagesave nga MEF-ja në BPK. Një marrëveshje e tillë bëri që procesimi i pagesave të Thesarit nga BPK-ja të jetë më efikas, dhe gjithashtu përmirësoi aktivitetet e pagesave dhe kontrollit të Departamentit të Thesarit të MEF-s.

2.2.4. Menaxhimi i Mjeteve

Operacionet e investimit të BPK-s kryhen përmes Departamentit të Menaxhimit të Mjeteve (DMM). Në të gjitha operacionet e saj DMM-ja udhëhiqet nga dispozitat e Politikës së Investimit të BPK-s. Kjo Politikë merr në konsideratë kufizimet e matura të rrezikut, duke i dhënë përparësi sigurisë së kapitalit dhe likuiditetit të mjaftueshëm mbi të ardhurat. Investimet individuale brenda portofolit klasifikohen sipas llojit, të tyre, kohëzgjatjes, dhe rrezikut të palës me qëllim që të mbajë një portofol të balancuar.

Për këtë qëllim, synimet kryesore të investimit të BPK-s, sipas radhitjes së përparësisë, janë:


Siguria – është objektivi kryesor i programit të investimit. Investimet në BPK ndërmerren në një mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e kapitalit në portofolin e përgjithshëm dhe të garantojë që siguria e kapitalit të portofolit nuk do të dëmtohet apo rrezikohet në asnjë moment.

Likuiditeti – portofoli i investimit mbetet në të gjitha kohërat mjaftueshmërisht likuid me qëllim që ta mundësojë BPK-n që t'i përmbushë kërkesat e saj të lëvizjes së parave të gatshme. Një shumëllojshmëri instrumentesh financiare dhe maturitetesh, të balancuara si duhet, ndihmojnë për të siguruar likuiditet të përshtatshëm.

Kthimi në Investime – portofoli i investimit është i ndërtuar me synimin e rritjes së kthimit në investime, por vetëm pasi të jenë arritur siguria dhe likuiditeti.


Burimet financiare të cilat ndodhen nën menaxhimin e BPK-s, përbëhen fillimisht nga depozita e IPVQ/MEF (70% të burimeve gjithsej) dhe, në një shkallë më të vogël, Institucionet e Sektorit Financiar (20%) dhe kapitali i vetë BPK-s (5%).

Figura 29: Struktura e burimeve financiare



Rregullorja e BPK-s dhe Politika e Investimit përcaktojnë se përveç 'kartmonedhave dhe monedhave të mbajtura në Kosovë', gjithashtu 'ari', 'bilancet e bankës jashtë', dhe 'letrat me vlerë të borxhit të lëshuara ose të garantuara nga Shtetet ose bankat qendrore të Bashkimit Evropian' janë kategori të përshtatshme mjetesh për investim të burimeve financiare të BPK-s. Shpërndarja aktuale e burimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Figura 30: Struktura e mjeteve financiare




BPK-ja i mban depozitat e llogarive rrjedhëse në një bankë qendrore dhe gjithashtu vendos depozita të tregut të parave në disa banka komerciale Evropiane detyrimet afatshkurtra të të cilave klasifikohen në një prej dy kategorive më të larta nga agjensi klasifikimi të gjendjes të njohura në mbarë botën. Llogaritë e depozituara në bankat qendrore dhe komerciale mbahen me qëllimin

për të siguruar likuiditet, shërbime kliringu dhe pagesash të përditshme. Depozitat gjithsej në secilën prej bankave komerciale nuk i tejkalojnë 15% të portofolit të investimeve të BPK-s dhe të gjitha kufijtë individuale të investimit vendosen dhe rishikohen herë pas here në përputhje me rregullat e Politikës së Investimit.

BPK-ja gjithashtu investon në bonot e thesarit, me maturitet brenda 180 ditësh të cilat denominohen dhe paguhen në euro, dhe lëshuar nga disa Qeveri të Bashkimit Evropian. Të gjitha letrat me vlerë të cilat aktualisht përfshihen në portofolin e investimit të BPK-s karakterizohen nga një treg riblerjeje i thellë, likuid dhe i zhvilluar mirë. Investimet në letra të tilla me vlerë kufizohen në 70% të portofolit të investimit gjithsej dhe jo më shumë se 25% e portofolit të investimit gjithsej investohet në letra me vlerë të ndonjë shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose Banke të saj Qëndrore.

Figura 31: Cilësia e kredisë së portofolit të investimit.



Cilësia e mjeteve të Portofolit të investimit të BPK-s u përmirësua më tej në vitin 2004. Për shkak të politikës, BPK-ja vazhdoi të zhvillojë marrëdhënies e saj të biznesit me një nga bankat qëndrore Evropiane dhe disa banka komerciale të vlerësuar lart. Kjo dëshmohet nga cilësia e lartë e kredisë të portofolit të investimit, vlerësuar e gjitha me një A ose më lart, prej së cilës 43% u vlerësua me AAA ose rrezik sundues bartës, dhe 42% u vlerësua me AA.

2.2.5. Këshilltar për Vendim-Marrësit Publik

Sipas Rregullores Nr. 2001/24, përmirësimi i Rregullores Nr. 1999/20, ndër funksionet e veçanta të BPK-s është që "të mbledhë të dhëna statistikore", "të drejtojë analiza të rregullta

ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë rezultatet publike", dhe "të rekomandojë udhëzime të plota të politikave". BPK-ja është përpjekur që të zhvillojë një kapacitet të kërkimit dhe statistikave dhe ka bërë përparime të dukshme në përmirësimin e statistikave të sektorit financiar dhe gjithashtu pjesën e mbetur të sektorit financiar me qëllim që të ketë një tablo të konsoliduar mbi zhvillimet financiare në Kosovë. Për rrjedhojë, në vitin 2004 u hartuan dy projekte statistikore, Raporti Bankar Statistikor dhe Raporti i Normës së Interesit. Përveç kësaj, u zgjeruan statistikave financiare për të mbuluar pothuajse të gjithë sistemin financiar dhe rezultati i drejtëpërdrejtë i këtij procesi ishte versioni i ri i Buletinit Mujor Statistikor duke filluar që nga botimi i Nëntorit 2004. Të dhënat e botuara janë sipas standardeve të FMN-s, veçanërisht të dhënat që kanë të bëjnë me statistikave monetare dhe financiare. Janë bërë përparime në drejtimin e strukturimit të statistikave financiare të qeverisë bazuar në standartet e FMN-s të cilat kërkojnë një bashkëpunim më të ngushtë me MEF-n.

Në baza tremujore, Departamenti për Kërkime dhe Statistika, në Buletinin e tij Mujor, jep një vlerësim të zhvillimeve kryesore në ekonominë e Kosovës dhe i kushtohet një vëmendje të madhe zhvillimeve të sektorit financiar për shkak të mbulimit më të mirë statistikor dhe dinamikave që e karakterizuan këtë sektor në vitin 2004. Më tej, në vitin 2005 Departamenti për Kërkime dhe Statistika do të nxjerrë botimin e ri i cili do të japë një pamje më të afërt mbi zhvillimet në sektorin bankar.

Ashtu si në vitet e mëparshme, në vitin 2004, FMN-ja vazhdoi të sigurojë asistencë teknike ndaj funksioneve të statistikave dhe kërkimeve të BPK-s. Misionet e FMN-s u përkushtuan në përmirësimin e funksionit statistikor lidhur me statistikave monetare dhe financiare si edhe me funksionin e kërkimeve. Gjithashtu, është siguruar asistencë e vazhdueshme në përpilimin e statistikave të bilancit të pagesave (asistenca multi-sektorale e FMN-s në SOK dhe BPK). Janë vendosur bazat për përpilimin e bilancit të pagesave dhe në vitin 2005 do të zbatohet raportimi i ri i bankave lidhur me Sistemin e Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare.

2.2.6. Aktivitete të Tjera të Interesit të Përgjithshëm

Për shkak të ekspertizës së saj të njohur, neutralitetit, dhe pavarësisë, BPK-ja nuk siguron vetëm shërbimet që zakonisht kryhen nga një bankë qëndore, por gjithashtu angazhohet në aktivitete të tjera të interesit të përgjithshëm. Në vitin 2004, BPK-ja ndërmori zhvillimin e SIKK¹²-ut, një regjistër krediti, dhe vazhdoi të angazhohet në ndërtimin e kapaciteteve të sektorit financiar në përgjithësi.

SIKK-u është një OJQ e cila mbledh të dhëna nga dhënësit e kredive rreth të dhënave kreditore të huamarrësve me qëllim përmirësimin e vlerësimit të kërkesave për kredi. Kjo është një nismë

¹² Sistemi Informativ i Kreditit në Kosovë

vullnetare nga insitucionet e dhënies së kredive dhe transmetimi i të dhënave bëhet në baza vullnetare gjithashtu. Insitucionet e dhënies së kredive shprehën dëshirën për ta patur këtë regjistër të kredive të kontrolluar dhe të mbikqyrur nga BPK-ja dhe që ta bëjë atë të detyrueshëm për të gjitha insitucionet e dhënies së kredive.

BPK-ja i ka mirëpritur nismat e kredi-dhënësve. Më specifikisht, Rregulli Bankar Nr. XXVII Mbi Raportimin e Kredive u miratua nga BPK-ja në Nëntor 2004 për ta bërë raportimin e informacionit mbi kreditë nga insitucionet e kreditimit të detyrueshëm, ndërkohë që sistemi përkatës IT është duke u zhvilluar nga BPK-ja. Pritet që në gjysmën e dytë të vitit 2005, regjistri i zhvilluar i kredive të bëhet funksional si një departament brenda BPK-s, dhe Rregulli Bankar do të hyjë në fuqi.

BPK-ja vazhdon të mbështesë Shoqatën e Bankierëve të Kosovës (SHBK) në zhvillimin e saj të mëtejshëm, i cili po merr mbështetje zhvillimi institucionale nga project AER filluar kohët e fundit. SHBK-ja i bashkon të shtatë bankat komerciale në Kosovë. Përveç ngritjes së çështjeve me interes të përbashkët, SHBK-ja synon që të promovojë një imazh pozitiv të sektorit bankar drejt të djave autoriteteve dhe publikut të gjerë. Me mbështetjen e Projektit AER kjo Shoqatë themeloi Qendrën e Trajnimit Bankar të Kosovës, e cila pritët që të mbulojë trajnimin bankar gjithëpërfshirës të punonjësve të anëtarëve të SHBK-s. Si një organ mbikqyrës, BPK-ja nuk mund të jetë një anëtar zyrtar i kësaj shoqate. Megjithatë, BPK-ja jep mbështetjen e saj drejt zhvillimit të mëtejshëm të SHBK-s me një funksion këshillues.

Gjithashtu, BPK-ja është e angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e praktikave të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. BPK-ja ka një përfaqësues në Bordin e Kosovës për Raportim Financiar (BKRF). Ky Bord është përgjegjës për miratimin e standarteve të kontabilitetit dhe auditimit, si edhe për licensimin e auditorëve të jashtëm. Megjithatë, BPK-ja i licenson auditorët e jashtëm për insitucionet e sektorit financiar në mënyrë të pavarur.



AKTIVITETET E BRENDSHME

3.1 Konferenca Ndërkombëtare e Pesë-Vjetorit të BPK-s

Në Nëntor të vitit 2004 BPK-ja festoi përvjetorin e saj të pestë. Për ta përkujtuar këtë rast, u organizua një konferencë ndërkombëtare. Përveç përfaqësuesve të komunitetit rajonal dhe ndërkombëtar, në këtë konferencë morën pjesë një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish nga sektori financiar në Kosovë. Synimi i kësaj konference ishte rritja e ndërgjegjësimit ndërmjet institucioneve dhe rreth arritjeve dhe sfidave në rrugën drejt ndërtimit të një sektori të forte financiar.

Promovimi i Mënyrave Moderne të Pagesave, Skemat e Sigurimit të Depozitave, Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve, Shmangia e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Krimin, u trajtuan në dritën e një vizioni afatgjatë i cili do ta sjellë Kosovën në një hap më afër qëndrueshmërisë në këtë fushë. Prezantimet dhe diskutimet në panel mbi këto çështje përfshinin ekspertë nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Fonds de Garantie des Dépôts (Paris, Francë), banka qendrore nga rajoni, Qendra Informativ Financiare (FIC) dhe Aksioni Financiar Task Force mbi Pastrimin e Parave (FAFT) si edhe Enti Statistikor i Kosovës (ZSK), Instituti i Riinvest-it dhe Shoqata e Sigurimeve të Kosovës (SHSK). Ia vlen të përmendet që, për here të pare, përfaqësues nga autoritetet financiare nga I gjithë rajoni – Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, Bosnia dhe Hercegovina erdhën në Prishtinë me këtë rast, diskutuan dhe krahasuan përvojat e tyre.

3.2 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Përveç funksioneve të saj administrative brenda BPK-s, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka përgjegjësinë e organizimit të aktiviteteve trajnuese me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të BPK-s. Trajnimi dhe zhvillimi i stafit bëhet në përputhje me udhëzimet dhe kriteret e Politikës së Trajnimit të BPK-s. Departamenti i Burimeve Njerëzore ka përcaktuar plane trajnimi të përgjithshme afatgjata dhe gjithashtu është i mirë-pajisur për t'u përgjigjur sa më shpejt nevojave më të papritura. Në bashkëpunim me menaxherët e gjithë departamenteve, nevojat e trajnimit dhe zhvillimit profesional i stafit vlerësohen vazhdimisht me synimin e përgjithshëm për të ndërtuar një organizatë me cilësi të lartë e cila është efiçase në kosto dhe e frytshme përmes përgatitjes së trajnimit të posaçëm në çdo nivel përvoja pune.

Përveç një trajnimi të strukturuar dhe të mbikqyrrur, BPK-ja organizon kurse të brendshme të temave të ndryshme për grupe të punonjësve në pozicione të ngjashme. Për nevoja trajnimi më të specializuara ose individuale, Punonjësit e BPK-s ndjekin seminare në institucione të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Gjatë vitit 2004, BPK-ja organizoi katër programe trajnimi. Në bashkëpunim me Qendrën Trajnuese Ndërkombëtare të Maltës (MITC), u organizuan dy programe trajnuese. Njëra ishte një Diplomë MITC në Programin Bankar dhe të Financave, i cili zgjati 45 ditë dhe u ndoq nga dy punonjës të BPK-s, dhe tjetra një kurs mbi industrinë e sigurimeve, i cili zgjati nëntë ditë dhe u ndoq nga 11 punonjës të BPK-s. Më pas, në bashkëpunim me Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), u organizua një kurs një-mujor mbi aftësimin e shkrimit të letrave të biznesit për 26 punonjës. Më së fundi, u organizua një seminar dy-ditor mbi aspektet e IT-s të sistemit ndërbankar të pagesave. Ky seminar u ndoq nga stafi i IT-s dhe i SNP-s.

Përsa u përket programeve të trajnimit të organizuara nga institucionet e tjera, punonjësit e BPK-s ndoqën 25 kurse/seminare. Nëntë prej tyre u zhvilluan në Kosovë dhe 16 jashtë saj. Programet e trajnimit të ndjekura në Kosovë ishin kryesisht kurse përgatitore për të fituar tituj profesionalë. Dy pjesëtarë të stafit të IT-s fituan Titullin Profesional të Çertifikuar të Microsoft-it. Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorët e Kosovës (SHKÇAK) shpërblyen katër anëtarë të stafit me tituj profesionalë të kontabilitetit.

Programet e trajnimit jashtë të cilat u ndoqën nga stafi i BPK-s u organizuan kryesisht nga autoritetet përkatëse kombëtare të vendeve organizatore. Përveç kësaj, anëtarët e stafit ndoqën katër programe trajnimi organizuar nga FMN-ja në selitë e saj qendrore në Washington DC, dhe tri programe trajnimi organizuar nga Instituti i FMN-s në Vjenë. Anëtarët e stafit gjithashtu kanë përfituar nga ndjekja e programeve të trajnimit të organizuara nga institucionet e tjera, si p.sh. Banka Dresdner, Frankfurt, dhe Qendra për Përsosmëri në Financë, Ljubljana.

Tabela 11: Programet e Trajnimit Jashtë BPK-s në vitin 2004

Institucioni	Programi / Lëmia	Kohëzgjatja	Nr. i pjesëmarrësve
Në Kosovë			
Cactus	MCDBA	200 orë	1
	MCSE, MCDBA, CCN, Bazat e Teknologjisë Informatike II	618 orë	6
Shoqata e sigurimeve në Kosovë	Diploma e Studimeve të Aplikuara të Sigurimeve	6 muaj	2
MEF	Zhvillimi i Auditimit të Brendshëm dhe Sistemit të Kontrollave Publike Financiare	15 ditë	1
Instituti Riinvest	Metodat Kërkimore në Ekonomiks dhe Ekonomiksi i Zhvillimit	12 ditë	1
Shoqata e Kontabilitetëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës	Kontabiliteti I	4 muaj	3
	Auditimi	5 javë	1
LUNMIK	Aftësitë Ndërpersonale	2 ditë	4
	Marrëdhëniet me publikun	2 ditë	1
Jashtë vendit			
Banka Qëndrore e Sllovenisë	Parandalimi dhe Zbulimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	2 ditë	1
Banka Qëndrore e Francës	Aspektet Juridike të Punëve të Bankës Qëndrore	5 ditë	1
Gendra për Përsosmëri në Financa - Slloveni	Auditimi i Brendshëm për Banka Qëndrore	2 ditë	1
Byroja Kombëtare e Kroacisë	Shlyerja e Kërkesave Ndërkombëtare të Sigurimeve të Automjeteve	2 ditë	1
Banka Qëndrore e Gjermanisë	Menaxhimi Valutor	5 ditë	1
Dresdner Bank	Trajnim Intensiv në Menaxhimin e Thesarit dhe Riskut	5 ditë	1
Banka Qëndrore Europiane	Sistemi i Pagesave në Eurozonë	5 ditë	1
FMN Instituti i Vjenës	Kontabiliteti i Bankës Qëndrore	5 ditë	2
	Satistikat Monetare dhe Financiare	15 ditë	1
	Satistikat Monetare dhe Financiare (Çeshtjet e Përpilimit dhe Raportimit)	5 ditë	1
FMN Uashington DC	Programimi dhe Politikat Financiare	2 muaj	1
	Programimi dhe Politikat Financiare (metoda e mësimin në distancë)	10 ditë	1
	Satistikat Monetare dhe Financiare	1 muaj	1
	Vlerësimi i Mbrojtjes nga Risqet në Bankën Qëndrore	5 ditë	1
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i Maltës - Gendra Ndërkombëtar i Trajnimit i Maltës	Trajnim Intensiv në Industrinë e Sigurimeve	1 muaj	1
Banka Qëndrore e Austrisë	Garkullimi i Parave të Gatshme dhe Sistemet e Pagesave	5 ditë	3

BPK-ja vazhdoi të mbështesë studimet përkatëse akademike të përparuara të punonjësve. Në vitin 2004, dy punonjës u diplomuan me gradën master në fushën e financave. Një u diplomua si Master në Banka dhe Financa nga Universiteti i Prishtinës dhe tjetri si MBA në Financa nga Universiteti Qëndror Evropian në Budapest. Përveç kësaj, një punonjës u regjistrua në programin PhD të mësimin në distancë mbi temën e zhvillimeve financiare në Universitetin Staffordshire, MB.

3.3 Qeverisja e BPK-s dhe Kontrolli i Brendshëm

Struktura e re organizative e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës miratuar në Dhjetor 2003 nga Bordi Drejtues i BPK-s u zbatua duke filluar nga Janari 2004. Kjo strukturë e re iu dha menaxherëve vendorë kompetenca shtesë dhe kishte për synim rritjen e efikasitetit në procesin e vendim-marrjes.

Praktika e emërimit të Menaxherëve të BPK-s vazhdoi gjatë gjithë vitit duke l mundësuar individët e emëruar që të marrën përgjegjësi dhe të përballojnë sfidat e operacioneve të përditshme në fushat kyçe të BPK-s.

Qëllimi i zbatimit të structures së re organizative në vitin 2004 kishte dy objektiva kryesorë:

- Përparimi në procesin e ndërtimit të kapaciteteve në BPK, dhe
- Sigurimi i zbatimit të “praktikave më të mira” në menaxhimin e BPK-s

Këto objektiva janë arritur në mënyrë të ndjeshme, ndërsa nevojat e identifikuar dhe të shfaqura për zhvillim profesional janë duke u zgjidhur përmes politikës së trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të personelit.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është një autoritet i rezervuar dhe operon si një Bankë Qëndrore e Kosovës. Postet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe të dy Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm për operacionet dhe mbikqyrjen e institucioneve financiare vazhdojnë të përmbushen nga ekspertë ndërkombëtarë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/24 Neni 29 deri sa të arrihen kompetencat e nevojshme të menaxherëve vendorë për t'i marrë përgjegjësitë në mënyrë efikase.

Me qëllim për të përfituar nga përvoja e ekspertëve ndërkombëtarë të cilët mbulojnë këto fusha, dhe rritur pjesëmarrjen e Kosovarëve në funksionet e larta të menaxhimit, janë krijuar dy pozita të reja:

Zyrtari Kryesor i Operacioneve; dhe Zyrtari Kryesor i Mbikqyrjes. Këta zyrtarë janë duke përfituar nga bashkëpunimi i ngushtë me ekspertët ndërkombëtarë (ZDP-t), të cilët u mundësojnë atyre fitimin e njohurive të nevojshme për t'i marrë përgjegjësitë në mënyrë sa më efikase.

Një objektiv tjetër i strukturës së re organizative zbatuar në vitin 2004, ishte garantimi i zbatimit të “praktikës më të mirë” në qeverisjen e BPK-s si një Bankë Qëndrore.

Për të garantuar zbatimin e “praktikës më të mirë” në qeverisjen e BPK-s, si edhe, për një politikë më të mirë qeverisëse e cila do të zhvillohet bazuar në transparencën dhe kontrollin e duhur të brendshëm, kjo përgjegjësi iu caktua Inspektorit Gjeneral, detyrat e të cilit janë të përsëritura dhe përcaktuara sipas Rregullores 2001/24. Gjithashtu, me strukturën e re organizative u krijua edhe Komiteti i Auditimit.

Zyra e Inspektorit Gjeneral përbëhet nga si vijon:

- Departamenti i Auditimit të Brendshëm
- Kontrolli Operacional dhe i Analizave si edhe Zbatimi i buxhetit, dhe
- Kontabiliteti i Shpenzimeve

Auditimi i Brendshëm i BPK-s është i pavarur dhe siguron besim të vërtetë, si edhe kryen aktivitete këshilluese; është i përcaktuar për të kontribuar në përmirësimin e operacioneve të institucionit.

Në zbatimin e Buxhetit BPK-ja kishte për synim realizimin e një buxheti të balancuar. Gjithashtu, lidhur me këtë fushë, BPK-ja arriti një progres të dukshëm në kontrollimin dhe zbatimin e buxhetit në mënyrë efikase, duke përdorur metodën e "lëvizjes së parave të gatshme", e cila tregon një lehtësim për menaxhmentin e BPK-s për të kontrolluar në mënyrë të suksesshme zbatimin dhe realizimin e buxhetit.

Sistemi i Kontabilitetit të Shpenzimeve mundëson një kontroll më të saktë të shpenzimeve për çdo qendër shpenzimi dhe më pas kjo i shërben menaxhmentit si një bazë për një planifikim dhe kontroll më të suksesshëm të aktiviteteve të BPK-s si edhe si një bazë për të marrë vendime më efikase.

Komiteti të Auditimit i është dhënë një pavarësi e plotë ndaj Menaxhmentit Ekzekutiv të BPK-s. Ai është një organ me të cilin auditorët e jashtëm kanë marrëdhënie të veçantë dhe shërben si një urë ndërmjet auditorëve të jashtëm dhe kontrollit të brendshëm drejtuar nga Inspektori Gjeneral i BPK-s. Ai synon në përfshirjen më të madhe të anëtarëve të Bordit Drejtues në kontrollin e llogarive. Ky Komitet i raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të pavarur Bordit Drejtues.

Ka shumë rreziqe të ndryshme në aktivitetet e BPK-s, dhe në përgjithësi në Bankat Qëndrore. Këto rreziqe ndahen zakonisht në tri kategori kryesore: Rreziku i Tregut, Rreziku Kreditor dhe Rreziku Operacional.

Secili prej këtyre rreziqeve ka nëndarjet dhe përbërësit e tij. Në rastin e Rrezikut të Tregut është e zakonshme që të dallosh ndërmjet rrezikut të normës së interesit dhe normës së Rrezikut të këmbimit.

Kur flasim për Rrezikun Kreditor ka një numër përbërësish si rreziku i shlyerjes së kërkesave, rreziku i kundërpalës, etj., dhe në rastin e Rrezikut Operacional ai zakonisht përkufizohet si pjesa tjetër e rreziqeve që kanë të bëjnë me aktivitetin, duke përfshirë, në rastin e bankave Qëndrore rrezikun e reputacionit.

Roli i auditimit nuk ishte për të përcaktuar rrezikun maksimal të parashikuar nga Menaxhmenti i BPK-s, por për të monitoruar sesi departamentet, që kanë detyrën e drejtimit të operacioneve, janë duke i vlerësuar dhe monitoruar këto rreziqe, dhe për të siguruar Menaxhmentin që këto operacione kryhen sipas rregullave dhe rregulloreve.

Në këtë aspekt auditimi i përqëndron aktivitetet e saj kryesore në fushat më të rrezikuara të BPK-s, dhe këto fusha janë gjithmonë të lidhura me menaxhimin e mjeteve, dhe përveç kësaj, në rastin e një banke qëndrore, përdorimi i kartmonedhave dhe monedhave është shumë i rëndësishëm.

Ka fusha të tjera të interesit për të rishikuar, të cilat janë të lidhura me funksionet e BPK-s ndaj komunitetit, si p.sh. pagesat, mbikqyrja, etj, dhe në këto fusha do të ishte e volitshme që të përcaktohej roli ekzakt që duhet të luajë Departamenti i Auditimit të Brendshëm, i cili do të dallohej

nga puna që kryejnë Departamentet e tjera të cilat kryejnë operacione ose drejtojnë hulumtimet dhe mbikqyrjen.

Duke qenë se Rreziku i Tregut dhe Rreziku Kreditor nuk konsiderohen si shumë të rëndësishme për BPK-n, aktivitetet e Rrezikut Operacional janë vlerësuar dhe kontrolluar.

Rreziqe që kanë të bëjnë me:

- Menaxhimin e Humbjes së parave/mjeteve
- Imazhi i institucionit/përdorimi i parave të gatshme dhe ruajtja
- Besueshmëria në institucion/ Pasqyrat financiare
- Një nga shërbimet kryesore për komunitetin/Sistemi ndërbankar i pagesave
- Një nga shpenzimet më të mëdhaja për institucionin/Pagesa e interesit në depozita

Me synimin për të arritur një pamje të qartë të të gjitha rekomandimeve të FMN-s mbi përmirësimin e cilësisë së punës së auditimit të brendshëm, u ndërmor një auditim praktik i drejtpërdrejtë në departamentin e identifikuar të BPK-s.

Përsa i përket zbatimit të Buxhetit, BPK-ja duhet të synojë në realizimin e një buxheti të balancuar. Lidhur me këtë fushë BPK-ja ka arritur një progres të dukshëm në kontrollimin dhe zbatimin e buxhetit në mënyrë të frytshme, duke përdorur metodën e "rrjedhës së parasë", e cila tregon një lehtësim për menaxhmentin e BPK-s për të kontrolluar në mënyrë të suksesshme zbatimin dhe realizimin e buxhetit.

Duke vërejtur arritjet e BPK-s, një nga rekomandimet e grupit të ekspertëve të FMN-s ishte fillimi i zbatimit të projektit për sistemin e kontabilitetit të shpenzimeve.

Sistemi i Kontabilitetit të Shpenzimeve mundëson një kontroll më të saktë të shpenzimeve për çdo qendër shpenzimesh dhe më pas kjo i shërben menaxhmentit si një bazë për një planifikim dhe kontroll më të suksesshëm të aktiviteteve të BPK-s si edhe si një bazë për të marrë vendime më efikase.

Lidhur me projektin e zbatimit të Kontabilitetit të Shpenzimeve gjatë vitit 2004 kanë përfunduar detyra që kanë të bëjnë me:

- Shpenzimet gjithsej (përcaktimi i shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta).
- Përcaktimi i aktiviteteve kryesore dhe dytësore të BPK-s.
- Identifikimi i qendrave të shpenzimeve.
- Përcaktimi i pikave kryesore të shpërndarjes së shpenzimeve.
- Raportimi i parë i Kontabilitetit të Shpenzimeve bazuar në Bilancin e BPK-s për vitin 2003.
- Përgatitja e draftit të parë të raportit të Kontabilitetit të Shpenzimeve bazuar në dokumentet dhe shpenzimet burimore të ndodhura gjatë vitit 2004.

Të gjitha këto detyra që kanë të bëjnë me kontabilitetin e shpenzimeve, dhe në fund si një projekt, do të përdoren për automatizimin e përsosmërinë e mëtejshme të kontrollit të shpenzimeve. Pas përfundimit të projektit, do të bëhet propozimi për zbatimin e tij në sistemin software të BPK-s.



**AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)
PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2004
PËRGATITUR NË PËRPTHJE ME STANDARTET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR**

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)
PASQYRAT FINANCIARE
31 DHJETOR 2004

PËRMBAJTJA

Informacione të përgjithshme	
Raporti i pavarur i auditorëve	
Bilanci i gjendjes.....	1
Pasqyra e të ardhurave.....	2
Pasqyra e rrjedhës së parasë.....	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva	4
Shënime për pasqyrat financiare	5
1. Bazat e përgatitjes dhe formati i prezantimit.....	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit	6
3. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	9
4. Llogaritë rrjedhëse me bankat jo-rezidente	13
5. Bonot e thesarit	13
6. Llogaritë depozituese me bankat jo-rezidente	14
7. Prona, godina dhe pajisjet.....	15
8. Bankat vendore.....	16
9. Institucionet e pushtetit vendor	17
10. Entitetet publike dhe komerciale.....	17
11. Detyrimet e tjera të brendshme.....	17
12. Fondi Statutor	18
13. Fondi i rezervave.....	18
14. Të ardhura të tjera operative.....	19
15. Shpenzimet për personelin	19
16. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	19
17. Transaksionet me palët e afërta.....	20
18. Zotimet dhe pasiguritë	20

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ("BPK-ja") është një entitet publik i veçantë me autoritetin për të licencuar, mbikqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në territorin e Kosovës. BPK-ja u krijua në përputhje me dispozitat e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK-u") rregullorja nr. 1999/20 nxjerrë më 15 Nëntor 1999 (dhe përmirësuar më 1 Tetor 2001 me Rregulloren 2001/24) "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës". Sipas kësaj rregulloreje objektivat kryesore të BPK-s janë për të:

- Siguruar një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme, dhe
- Siguruar likuiditetin, aftësinë për të paguar dhe funksionimin e frytshëm të një tregu të qëndrueshëm bazuar në sistemin financiar, duke përfshirë bankat, kompanitë e sigurimeve dhe institucionet e tjera financiare.

BPK-ka ka autoritetet specifike të mëposhtme për të:

- Rekomanduar udhëzime të politikave të gjera për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në fushat që janë nën përgjegjësinë e saj, nën drejtimin e Zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik;
- Formuluar dhe zbatuar masa, dhe mbikqyrur dhe rregulluar, pagesat dhe sistemin e pagesave për transaksione në monedhën e brendshme dhe të huaj në Kosovë;
- Zotëruar dhe operuar një ose më shumë sisteme të pagesave;
- Vepruar si një bankier për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe për të siguruar këshillim financiar sipas kërkesës së saj;
- Vepruar si një agjent fiskal për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave;
- Mbajtur depozita në monedhë të huaj të bankave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe entiteteve të tjera;
- Siguruar furnizimin e mjaftueshëm me kartmonedha dhe monedha për pagesat e transaksioneve të parave të gatshme;
- Mirëmbajtur një thesar për ruajtjen e sigurtë të valutave dhe letrave me vlerë;
- Licencuar, mbikqyrur dhe rregulluar institucionet financiare;
- Mbikqyrur dhe rregulluar agjentët e valutave të huaja, dhe
- Drejtuar analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë rezultatet publike, dhe t'i paraqesë Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë propozime dhe masat që duhen ndërmarrë në bazë të këtyre analizave.

BPK-ja operon nga selia e saj vendosur në Prishtinë.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

BORDI DREJTUES

Bordi Drejtues përcakton politikat për operacionet e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe mbikqyr zbatimin e tyre. Sipas rregullores së UNMIK-ut, Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Më 31 Dhjetor 2004 Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

- Z. Ajri Begu, Kryetar i Bordit Drejtues
- Z. Donat Branger, Drejtor I Përgjithshëm i BPK-s
- Z. David Weatherman, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikqyrjen e Sektorit Financiar
- Z. Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave
- Z. Nikolaus Graf Lambsdorff
- Z. Gazmend Luboteni
- Z. Petraq Milo

Duke filluar nga 1 Janari 2005 Michel Svetchine u emërua Drejtor i Përgjithshëm.

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORËVE PËR BORDIN DREJTUES TË AUTORITETIT BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS

Ne kemi audituar bilancin e bashkangjitur të gjendjes të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës ("BPK-ja") deri më 31 Dhjetor 2004 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave, ndryshimet në kapital dhe rezerva dhe lëvizjet e parave të gatshme për vitin që përfundoi. Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e menaxhmentit të BPK-s. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne e kemi kryer auditimin tone në përputhje me Standartet Ndërkombëtare mbi Auditimin. Këto Standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të patur bindje të arsyeshme që këto pasqyra financiare nuk paraqesin pasqyra të gabuara dhe jo të sakta. Një auditim përfshin kontrollin, mbi baza testimi, evidenca që mbështesin shumat dhe zbulimin në pasqyrat financiare. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe llogaritje të rëndësishme të kryera nga menaxhmenti, si edhe vlerësimi i prezantimit të pasqyrave të përgjithshme financiare. Ne besojmë se auditimi ynë jep një bazë të arsyeshme për mendimin tonë.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat bashkangjitore financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës deri më 31 Dhjetor 2004 dhe rezultatet e operacioneve të saj dhe rrjedha e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Pa e kualifikuar mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se në të tashmen në Kosovë ka pasiguri lidhur me drejtimin e mundshëm në të ardhmen të politikës së brendshme ekonomike, politikës rregullatore dhe zhvillimeve politike. Ne nuk mund të parashikojmë se çfarë ndryshimesh do të ndodhin dhe çfarë ndikimi mund të kenë ato në gjendjen financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

BILANCI I GJENDJES

DERI MË 31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

	<u>Shënime</u>	<u>31 Dhjetor 2004</u>	<u>31 Dhjetor 2003</u>
Mjetet			
Paraja e gatshme		12,064	26,590
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo-rezidente	4	8,929	23,784
Bonot e thesarit	5	124,418	-
Llogaritë depozituese me bankat jo-rezidente	6	204,480	404,213
Prona, ndërtesa dhe pajisjet, neto	7	665	895
Mjete të tjera		<u>111</u>	<u>75</u>
Mjetet Gjithsej		<u>350,667</u>	<u>455,557</u>
Detyrimet			
Ndaj bankave vendore	8	72,899	59,618
Ndaj institucioneve të qeverisë vendore	9	225,209	351,453
Ndaj entiteteve publike dhe komerciale	10	32,826	27,911
Detyrimet e tjera të brendshme	11	<u>2,220</u>	<u>2,107</u>
Detyrimet Gjithsej		<u>333,154</u>	<u>441,089</u>
Kapitali dhe rezervat			
Fondi Statutor	12	10,000	2,556
Fondi Rezervë	13	<u>7,513</u>	<u>11,912</u>
Kapitali dhe rezervat gjithsej		<u>17,513</u>	<u>14,468</u>
Detyrimet, kapitali dhe rezervat gjithsej		<u>350,667</u>	<u>455,557</u>

Miratuar me 31 Mars 2005 nga ana e Bordit Drejtues të BPK-s nga:

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm

Benoit Waelkens
Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

PASQYRA E TË ARDHURAVE

DERI MË 31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

	<u>Shënime</u>	<u>31 Dhjetor 2004</u>	<u>31 Dhjetor 2003</u>
Të ardhurat nga interesi		8,307	8,110
Shpenzimet e interesit		<u>(4,049)</u>	<u>(2,832)</u>
Të ardhurat neto nga interesi		4,258	5,278
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		570	684
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve		<u>(107)</u>	<u>(121)</u>
Të hyrat neto nga ngarkesat dhe komisionet		436	563
Të ardhurat nga grantet	11	250	347
Humbjet nga rivlerësimi i Bonovo të thesarit		(113)	-
Të ardhurat e tjera operative	14	<u>380</u>	<u>552</u>
Të ardhurat neto operative		5,238	6,740
Shpenzimet operative			
Shpenzimet e personelit	15	1,015	837
Zhvlerësimi		371	512
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	16	<u>807</u>	<u>859</u>
Shpenzimet operative gjithsej		<u>2,193</u>	<u>2,208</u>
Fitimi neto për periudhën		<u>3,045</u>	<u>4,532</u>

Miratuar me 31 Mars 2005 nga ana e Bordit Drejtues të BPK-s nga:

Michel Svetchine
Drejtor i Përgjithshëm



Benoit Waelkens
Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm



Shënimet në faqet prej 5 deri 20 përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

[2]

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

<u>Shënime</u>	<u>31 Dhjetor 2004</u>	<u>31 Dhjetor 2003</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitet operative		
Interesi i fituar	8,585	8,110
Interesi i paguar	(4,071)	(2,832)
Tarifat dhe komisionet e pranuar	570	684
Tarifat dhe komisionet e paguara	(107)	(121)
Pranimet e tjera	380	552
Pagesat me para të gatshme ndaj punonjësve dhe furnizuesve	(1,922)	(1,696)
Ndryshimi në mjetet operative		
Zvogëlimi/ (Rritja) e kërkesave nga bankat	199,733	(141,517)
Rritja në mjetet e tjera të brendshme	(15)	(39)
Ndryshimi në detyrimet operative		
Rritja në detyrimet ndaj bankave vendore	13,287	13,383
Rritja/ (Zvogëlimi) në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare	(126,244)	82,585
Rritja në detyrimet ndaj entiteteve publike dhe komerciale	4,887	8,585
Rritja në detyrimet e tjera të brendshme	95	205
Paraja neto nga aktivitetet operative	95,178	(32,102)
Rrjedha e parasë nga aktivitet investuese		
Blerja e pronës dhe pajisjeve	(141)	(785)
Paraja neto nga aktivitetet investuese	(141)	(785)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Fondet Grant të pranuar	-	467
Paraja neto nga aktivitetet financuese	-	467
Rritja/(Zvogëlimi) neto në para dhe ekuivalentët e parasë	95,037	32,420
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	50,374	82,795
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	145,411	50,374

Shënimet në faqet prej 5 deri 20 përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

(3)

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL DHE REZERVA

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

	<u>Fondi Statutor</u>	<u>Fondi Rezervë</u>	<u>Fitimet e Mbaitura</u>	<u>Gjithsej</u>
Bilanci deri më 31 Dhjetor 2002	2,556	7,380	-	9,936
Fitimi neto për vitin	-	-	4,532	4,532
Transferta në fondin rezervë	<u>-</u>	<u>4,532</u>	<u>(4,532)</u>	<u>-</u>
Bilanci deri më 31 Dhjetor 2003	2,556	11,912	-	14,468
Transferta në kapital	7,444	(7,444)	-	-
Fitimi neto për vitin	-	-	3,045	3,045
Transferta në fondin rezervë	<u>-</u>	<u>3,045</u>	<u>(3,045)</u>	<u>-</u>
Bilanci deri më 31 Dhjetor 2004	<u>10,000</u>	<u>7,513</u>	<u>-</u>	<u>17,513</u>

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

1 BAZAT E PËRGATITJES DHE FORMATI I PREZANTIMIT

Këto pasqyra financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës ("BPK") janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Këto pasqyra financiare të Bankës janë të përgatitura sipas marrëveshjes historike të shpenzimeve.

1.1 Valuta e prezantimit

Deri më 31 Dhjetor 2001, pasqyrat financiare të BPK-s ishin të dhëna në valutën e territorit të Kosovës, Marka Gjermane ("DEM") e cila atëherë ishte valuta e njësisë matëse dhe raportuese në territorin e Kosovës. Në përputhje me rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/4 Euro ("EUR") u miratua si një nga valutat zyrtare në Kosovë duke filluar nga 1 Janari, 2002 dhe për rrjedhojë vlerat e denominuara të DEM u këmbyen në Euro që nga 1 Janari, 2002 duke përdorur normën fikse të këmbimit prej 1 EUR = 1,95583 DEM. Duke filluar nga 1 Janari, 2002 regjistrat dhe të dhënat e BPK-s mbahen në Euro, e cila është njësia matëse valutore e BPK-s. Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në mijëra Euro, vetëm nëse shprehet ndryshe.

1.2 Bazat e kontabilitetit

BPK-ja i mban të dhënat e saj të kontabilitetit në përputhje me praktikat e pranuarra gjerësisht të kontabilitetit në territorin e Kosovës administruar nga Kombet e Bashkuara dhe ajo i përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

1.3 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon menaxhim për të bërë vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në vlerat e raportuara të mjeteve të detyrimeve dhe zbulimin e mjeteve dhe detyrimeve të mundshme në datën e pasqyrave financiare dhe vlerave të raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato vlerësime.

1.4 Riklasifikimi i vlerave krahasuese

Aty ku është e nevojshme, janë përshtatur shifra krahasuese për t'u përputhur me ndryshimet në paraqitjen e vitit aktual.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1 Të ardhurat e interesit dhe shpenzimet

Të ardhurat e interesit dhe shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet bartës të interesit në baza akruale, duke përdorur metodën e të ardhurave efektive bazuar në çmimin real të blerjes. Të ardhurat e interesit përfshijnë zbritjen dhe premiumin e shtuar ndaj bonove të thesarit dhe instrumenteve të tjera të zbritura.

Kur një mjet financiar ose një grup mjeteve financiare është shënuar si rrjedhojë e një humbjeje dëmtimi, atëherë të ardhurat e interesit njihen duke përdorur normën e interesit të përdorur për të zbritur rrjedhjen e parasë në të ardhmen për qëllimin e matjes së humbjes së dëmtimit.

2.2 Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përbëhen nga tarifat e transaksionit për llogaritë operative dhe transfertat e fondeve.

Tarifat dhe komisionet përgjithësisht njihen në baza akruale atëherë kur sigurohet shërbimi.

2.3 Këmbimi i valutës së huaj

Transaksionet e valutës së huaj këmbehen në valutën e matjes duke përdorur normat mbizotëruese të këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet e këmbimit të huaj të cilat vijnë si rezultat i pagesës së transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi në fund të vitit të normave të këmbimit të mjeteve dhe detyrimeve monetare të denominuara në valuta të huaja janë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave.

2.4 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për shkak të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paranë e gatshme, llogaritë rrjedhëse në bankat jo-rezidente dhe bonot e thesarit.

2.5 Bonot e thesarit

Banka i klasifikon bonot e saj të thesarit si të gatshme për shitje. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare. Të gatshme për investimet e shitjes janë ato të caktuara për t'u mbajtur për një periudhë të pacaktuar kohore, të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet ose ndryshimeve në normat e interesit, normat e këmbimit ose çmimet e kapitalit. Të gjitha të ardhurat e interesit dhe çdo fitim/humbje si rezultat i tregtimit të bonove të thesarit përfshihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndryshimet në vlerën reale konsiderohen gjithashtu në pasqyrën e të ardhurave.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.6 Prona, godina dhe pajisjet

Prona, godina dhe pajisjet paraqiten në shpenzimet historike minus zhverësimi i akumuluar dhe provizioni për dëmtim kur është e nevojshme.

Nëse vlera reale e një artikulli të pronës, godinës dhe pajisjeve është më e ulët sesa shuma e saj bartëse, për shkak se rrethanat konsiderohen [it] të përkohshme, atëherë artikulli i pronës, godinës dhe pajisjeve paraqitet në vlerën e saj reale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e pronës, godinës dhe pajisjeve paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në vitin e shitjes.

Zhverësimi jepet në të gjitha pronën, godinën dhe pajisjet bazuar në shpenzimet historike. Detyrimi vjetor për zhverësim llogaritet duke përdorur metodën lineare duke përdorur normat e specifikuara për çdo mjet të zhverësuar bazuar në kohëzgjatjen e caktuar të përdorshmërisë. Kohëzgjatjet e caktuara të përdorshmërisë aplikuar gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2003 dhe periudhës së përfunduar më 31 Dhjetor 2002 janë:

	Norma e zhvlerësimit gjatë një viti	Kohëzgjatja e përdorshmërisë
Automjetet	20%	5 vite
Godina, zyrat dhe pajisjet e tjera	20%	5 vite
Pajisjet kompjuterike	33.3%	3 vite

2.7 Të ardhurat nga grantet

Grantet e pranuar me qëllim blerjen e një prone, godine apo pajisjeje, ose pronë, godinë dhe pajisje e dhënë si grant, paraqiten në bilancin e gjendjes si grant i shtyrë dhe njihen si të ardhura nga grantet gjatë së njëjtës periudhë së kohëzgjatjes së përdorshmërisë së pronës, godinës dhe pajisjeve. Grantet e pranuar për të financuar shpenzimet e BPK-s i kreditohen drejtëpërdrejtë të ardhurave nga grantet në pasqyrën e të ardhurave në periudhën kur ndodhën këto shpenzime.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.8 Pagat e financuara nga donatorët

Anëtarë të caktuar të menaxhmentit të BPK-s janë ekspertë ndërkombëtarë emëruar nga organizata ndërkombëtare të cilët sigurojnë mbështetje financiare për BPK-n. Gjithashtu, këto organizata ndërkombëtare emërojnë ekspertë dhe konsulentë afatshkurtër sipas nevojave. Mbështetja financiare e këtyre organizatave ndërkombëtare përfshin, por nuk është e kufizuar, pagesën e pagave të emërimeve të menaxhmentit dhe konsulentëve. Duke qenë se kjo asistencë i paguhet drejtpërdrejtë të emëruarit, nivelet e pagave nuk njihen dhe as nuk përfshihen në këto pasqyra financiare. Kohëzgjatja e emërimit të personelit të menaxhmentit nuk është tërësisht e qartë, edhe pse synimi i organizatave ndërkombëtare është që së fundmi këta të emëruar të zëvendësohen nga stafi vendor.

2.9 Aktivitetet fiduciare

Në disa raste të caktuara të veçanta Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron si agjent fiskal dhe agjent pagues për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Mjetet dhe të ardhurat të cilat dalin nga këto aktivitete përjashtohen nga këto pasqyra financiare ku Autoriteti Bankar dhe i Pagesave vepron si kapacitet fiduciar si p.sh. i emëruar ose agjent.

2.10 Vlera reale e instrumenteve financiarë

Vlera reale është shuma në të cilën instrumenti financiar mund të këmbëhet në një transaksion rrjedhës ndërmjet palëve të gatshme, ndryshe nga një shitje apo likuidim i detyruar, dhe dëshkohet më mirë nga çmimi i kuotuar i tregut.

Mjetet afat-shkurtra të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës paraqiten në pasqyrat financiare në koston e cila i afrohet vlerës së tyre reale sepse këto instrumente kanë afate të shkurtra maturiteti dhe janë të këmbyeshme në para të gatshme dhe janë të paguara pa kosto domethënëse të transaksionit.

Bonot e thesarit klasifikohen si të gatshme për shitje dhe jepen në vlerën reale. Vlera reale e vlerësuar përcaktohet duke përdorur çmimet e tregut ose kuotimet e agjentëve. Në ato raste kur ky informacion nuk është i dhënë, vlera reale llogaritet duke përdorur rrjedhën e parave me interes të zbritur me norma interesi sunduese për instrumentet me rrezik të njëjtë krediti dhe maturitet të mbetur.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.11 Taksimi dhe vendosja e fitimit

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/20 nxjerrë më 15 Nëntor 1999 [përmirësuar më 1 Tetor 2001] "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës", Banka është e shkarkuar nga taksa mbi të ardhurat dhe i kërkohet me ligj që të paguajë çdo bilanc të të ardhurave të saj neto drejtpërdrejtë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pas vendosjes për të plotësuar nivelet e fondeve rezervë drejtuar nga Bordi Drejtues.

2.12 Rezerva e përgjithshme

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/20 (siç është përmirësuar) çdo vit BPK-ja do të dërgojë të ardhurat neto në llogarinë e rezervës së përgjithshme deri sa kapitali dhe llogaritë e rezervës së përgjithshme të arrijnë në 5% të shumës gjithsej, shumë e bilancit të kredisë të të gjitha llogarive të mbajtura në regjistrat e BPK-s nga mbajtësit e llogarive paraqitur në bilancin e gjendjes të BPK-s në fund të çdo viti financiar.

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Përmes operacioneve të saj normale, BPK-ja është e ekspozuar ndaj një numri rreziqesh, ku më të rëndësishmet janë rreziqet valutore, operative, kreditore, të normave të interesit dhe të likuiditetit. Struktura e mjeteve dhe detyrimeve të BPK-s përcaktohet fillimisht nga natyra e funksioneve statutorë të BPK-s, sesa nga faktorët komercialë. Menaxhimi i rrezikut të BPK-s rregullohet përmes udhëzimeve të saj të brendshme dhe monitorohet nga afër nga Bordi Drejtues dhe Komitetet e BPK-s.

Rreziku operativ është rreziku i humbjes i cili del nga klasifikimi i kontrolleve të brendshme. BPK-ja e menaxhon këtë rrezik përmes Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BPK-s, i cili ushtron kontroll mbi politikat dhe procedurat e kontabilitetit dhe funksionimit efikas të sistemit të kontrolleve të brendshme të BPK-s.

Ndarja e detyrave ndërmjet departamenteve të ndryshme të BPK-s, konsiderohet gjithashtu si një nga mekanizmat e menaxhimit të rrezikut operativ.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.1 Rreziku kreditor

BPK-ja merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut kreditor, i cili është rreziku që një kundërpalë nuk do të jetë e aftë që t'i paguajë shumat e plota në kohën e duhur.

Rreziku kreditor menaxhohet normës miratimit të transaksioneve dhe fondeve plasmane, vendosjen e kufijve të cilat kufizojnë rrezikun dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjeve.

Kundërpalët pranohen vetëm nëse ato kanë shkallë të lartë kreditimi dhe nëse iu nënshtrohen rishikimeve të rregullta kreditore.

3.2 Rreziku i normës së këmbimit

BPK-ja është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit si pasojë e investimeve në norma fikse në vlera dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave nga qeveria dhe klientët e tjerë.

Rivendosja kontraktuale e mjeteve dhe detyrimeve nga bilanci i gjendjes së BPK-s korrespondon me datat e maturitetit pasi normat e interesit janë fikse. Një përmbledhje e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit mund të gjendet në tabelat brenda rrezikut të likuiditetit.

Tabela e mëposhtme përmbledh normat efektive të interesit për instrumentet monetare financiare:

	<u>31 Dhjetor 2004</u>	<u>31 Dhjetor 2003</u>
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo-rezidente	1.14%	1.02%
Depozitat e afatizuara me bankat jo-rezidente	1.99%	2.04%
Bonot e thesarit	2.07%	n/a
Ndaj bankave vendore	1%	0.5%
Ndaj institucioneve qeveritare	1%	0.5%
Ndaj entiteteve publike dhe komerciale	1%	0.5%
Depozitat e afatizuara të entiteteve publike dhe komerciale	1.87%	1.62%

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3 Rreziku i likuiditetit

BPK-ja është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme ndaj burimeve të parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse. BPK-ja nuk mban burime të parave të gatshme për të plotësuar të gjitha nevojat e mundshme, pasi përvoja tregon se një nivel minimal i riinvestimeve të fondeve të maturuara mund të parashikohet me një nivel të lartë pasigurie. Bordi vendos kufinj mbi nivelin minimal të fondeve maturuese të disponueshme për të plotësuar kërkesa të tilla dhe mbi nivelin minimal të parave të gatshme të cilat duhet të jenë për të mbuluar tërheqjet në nivele të papritura të kërkesës.

Tabela e mëposhtme analizon mjetet dhe detyrimet e BPK-s në grupe të caktuara maturuese bazuar në periudhën e mbetur të datës së bilancit të gjendjes ndaj datës së maturitetit kontraktual:

31 Dhjetor 2004	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vite	Gjithsej
Mjetet					
Paraja e gatshme	12,064	-	-	-	12,064
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo-rezidente	8,929	-	-	-	8,929
Llogaritë depozituese me bankat jo-rezidente	27,121	174,859	2,500	-	204,480
Bonot e thesarit	24,974	44,846	54,598	-	124,418
Prona dhe pajisjet	-	-	-	665	665
Mjetet e tjera	111	-	-	-	111
Gjithsej mjetet	73,199	219,705	57,098	665	350,667
Detyrimet					
Ndaj bankave vendore	72,899	-	-	-	72,899
Ndaj institucioneve qeveritare	225,209	-	-	-	225,209
Ndaj entiteteve publike dhe komerciale	27,704	3,005	2,117	-	32826
Detyrimet e tjera	2,220	-	-	-	2,220
Gjithsej detyrimet	328,032	3,005	2,117	-	333,154
Gepi neto i likuiditetit	(254,833)	216,700	54,981	665	17,513

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

31 Dhjetor 2003	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vite	Gjithsej
Mjetet					
Paraja e gatshme	26,590	-	-	-	26,590
Llogarite rrjedhese me bankat jo-rezidente	23,784	-	-	-	23,784
Llogaritë depozituese me bankat jo-rezidente	357,074	46,131	1,008	-	404,213
Prona dhe pajisjet	-	-	-	895	895
Mjetet e tjera	75	-	-	-	75
Gjithsej mjetet	407,523	46,131	1,008	895	455,557
Detyrimet					
Ndaj bankave vendore	59,618	-	-	-	59,618
Ndaj institucioneve qeveritare	351,453	-	-	-	351,453
Ndaj entiteteve publike dhe komerciale	19,224	5,480	1,006	2,201	27,911
Detyrimet e tjera	2,107	-	-	-	2,107
Gjithsej detyrimet	432,402	5,480	1,006	2,201	441,089
Gepi neto i likuiditetit	(24,879)	40,651	2	(1,306)	14,468

3.4 Rreziku valutor

Rreziku valutor është rreziku se vlera e instrumenteve financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimit të huaj.

Përveç vlerave të papërfillshme, mjetet dhe detyrimet e BPK-s janë të denominuara në Euro, për këtë arsye BPK-ja nuk ka ekspozim të madh ndaj rrezikut valutor.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Për shkak të pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëjnë bilancet e mëposhtme me më pak se 90 ditë maturiteti:

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Paraja	12,094	26,590
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo-rezidente	8,929	23,784
Bonot e thesarit	124,418	-
	145,411	50,374

4. LLOGARITË RRJEDHËSE ME BANKAT JO-REZIDENTE

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Deutsche Bundesbank	8,597	23,573
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	90	22
Commerzbank AG	10	84
Svenska Handelsbanken	162	64
Dresdner Bank	70	41
Gjithsej	8,929	23,784

Deri më 31 Dhjetor 2004 llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja denominohen në Euro dhe bartin interes nga 1% deri në 1.06% (31 Dhjetor 2003: ndërmjet 1% dhe 1.04%).

5. BONOT E THESARIT

Bonot e thesarit janë letra me vlerë të borxhit të lëshuara nga vendet e BE-s për një periudhë tre-mujore, gjashtë-mujore dhe një-vjeçare. Të gjitha bonot iu nënshtrohen normave të ndryshme të interesit, të denominuara në Euro dhe nëse mbahen në maturitet kanë një të ardhur prej 2.04% deri në 2.14%.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

6. LLOGARITË DEPOZITARE ME BANKAT JO-REZIDENTE

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	8,703	51,326
Commerzbank AG	1,100	3,400
Dresdner Bank	25,219	60,087
Deutsche Bundesbank	10,010	70,115
ING Bank	34,360	62,639
KBC	32,391	62,865
Rabobank	13,181	28,033
Svenska Handelsbanken	39,420	65,748
HBOS Treasury Services Plc	27,908	-
Danske Bank	12,188	-
Gjithsej	204,480	404,213

Deri më 31 Dhjetor 2004 depozitat në bankat e huaja denominohen në Euro dhe bartin interes nga 1.92% në 2.20% (31 Dhjetor 2003: ndërmjet 1.87% dhe 2.21%).

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

7. PRONA, GODINA DHE PAJISJET

	Pajisjet	Kompjuterat dhe Software-i	Automjetet	Mjetet ne ndërtim	Gjithsej
Më 1 Janar 2003	513	697	72	-	1,282
Zhvlerësimi i akumuluar	(160)	(483)	(18)	-	(661)
Shuma neto e regjistruar	353	214	54	-	621
Fundi i vitit 31 Dhjetor 2003					
Shuma fillestare neto e regjistruar	353	214	54	-	621
Shtesat	157	601	27	-	785
Shitjet	(123)	(4)	-	-	(127)
Tarifa e zhvlerësimit	(90)	(278)	(16)	-	(384)
Shuma neto e mbyllur e regjistruar	297	533	65	-	895
Më 31 Dhjetor 2003					
Kostoja	457	1,016	83	-	1,556
Zhvlerësimi i akumuluar	(160)	(483)	(18)	-	(661)
Shuma neto e regjistruar	297	533	65	-	895
Fundi i vitit 31 Dhjetor 2004					
Shuma fillestare neto e regjistruar	297	533	65	-	895
Shtesat	12	17	-	112	141
Shitjet	-	-	-	-	-
Tarifa e zhvlerësimit	(93)	(260)	(18)	-	(371)
Shuma neto e mbyllur e regjistruar	216	290	47	112	665
Më 31 Dhjetor 2004					
Kostoja	469	1,033	83	112	1,697
Zhvlerësimi i akumuluar	(253)	(743)	(36)	-	(1,032)
Shuma neto e regjistruar	216	290	47	112	665

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

8. NDAJ BANKAVE VENDORE

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Banka Procredit	14,916	12,470
Banka e Re e Kosovës	2,486	2,060
Banka Për Biznes	2,022	1,494
Banka Raiffeisen e Kosovës (ish BAK)	6,370	4,428
Banka Ekonomike e Kosovës	1,451	1,074
Banka Kreditore e Prishtinës	2,456	1,111
Kasabank	3,590	2,295

Gjithsej rezervat e likuiditetit të kërkuara	33,291	24,932
---	---------------	---------------

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Banka Procredit	9,238	8,344
Banka e Re e Kosovës	9,119	5,978
Banka Për Biznes	5,872	3,781
Banka Raiffeisen e Kosovës (ish BAK)	4,279	5,869
Banka Ekonomike e Kosovës	3,484	3,869
Banka Kreditore e Prishtinës	3,238	2,717
Kasabank	4,378	4,128

Gjithsej llogaritë rrjedhëse	39,608	34,686
-------------------------------------	---------------	---------------

Gjithsej	72,899	59,618
-----------------	---------------	---------------

Sipas rregullores XVII të mbikqyrjes së BPK-s bankave komerciale në Kosovë iu kërkohet që të mbajnë rezerva likuiditeti në vlerën 10% të depozitave gjithsej të klientëve të tyre. Të paktën gjysma e këtyre bilanceve të rezervave duhet të mbahen në llogaritë e BPK-s.

Bilancet e rezervave më shumë se 5%, deri në 10% të depozitave gjithsej të klientëve bartin interes prej 1% më 31 Dhjetor 2004 (0.5% më 31 Dhjetor 2003). Vlerat nën 5% dhe mbi 10% nuk janë interes-bartëse.

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS (BPK)

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2004

(Të gjitha vlerat janë të paraqitura në mijëra euro, nëse nuk ceket ndryshe)

9. NDAJ INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT VENDOR

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
UNMIK	5,179	298
MEF, thesari, dogana dhe taksat	172,606	325,200
Ndaj komunave të pushtetit vendor	674	639
Ndaj institucioneve të tjera qeveritare	14,000	53
Ndaj Agjencionit të Mirëbesimit Kosovar	32,750	25,263
Gjithsej	225,209	351,453

10. NDAJ ENTITETEVE PUBLIKE DHE KOMERCIALE

	31 Dhjetor 2004	31 Dhjetor 2003
Kompanitë e Sigurimeve	17,529	20,410
Korporatat e shërbimeve publike	12,055	4,949
Fondet pensionale të entiteteve komerciale duke përfshirë edhe fondet pensionale të BPK-s	3,232	2,202
Të tjera	10	350
Gjithsej	32,826	27,911

